



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES**

**V E N D I M**

**Nr.11, datë 22.02.2018**

**Për**

**“Miratimin e Dokumentit “Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare - Dokumenti Përfundimtar””**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

|                |          |         |
|----------------|----------|---------|
| 1. Z. Ilir     | Zela     | Kryetar |
| 2. Z. Alban    | Karapici | Anëtar  |
| 3. Zj. Anila   | Denaj    | Anëtar  |
| 4. Zj. Ketrin  | Topçiu   | Anëtar  |
| 5. Zj. Klarina | Allushi  | Anëtar  |

dhe sekretare Znj. Ina Nuellari, në mbledhjen e datës 22.02.2018, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“Miratimin e Dokumentit “Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare - Dokumenti Përfundimtar ”**

**BAZA LIGJORE:**

- 1) Shkronja ç) e nenit 8, neni 31 e vijues, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 te ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
- 2) “Rregullore per analizen e tregut”, miratuar me vendimin nr. 747, date 17.07.2009, ndryshuar me Vendimin nr. 2342, date 31.07.2013, të Keshillit Drejtues të AKEP (**Rregullorja**).

## KËSHILLI DREJTUES

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Dokumenti: *Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare - Dokumenti Përfundimtar (Dokumentit)*;
2. Projekt-akti miratues për “Miratimin e Dokumentit “Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare - Dokumenti Përfundimtar ” (*Projektvendimi*)
3. Relacioni shpjegues për Projektvendimin (*Relacioni*).

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar:

### V E R E N:

1. Këshilli Drejtus i AKEP me Vendimin Nr.2699, datë 1.12.2016, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare: Tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare – Këshillim Publik*” dhe me Vendimin nr. 2700, datë 22. 12. 2016, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit “*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – Këshillim Publik*”.
2. Këshillim publik për dokumentin e Analizës së tregut u krye ne periudhen 7.12.2016-7.02.2017, ndërsa për rregullimin e tarifave më 23.12.2016-7.02.2017. Në përfundim të këshillimit publik (7.02.2017) për dokumentin “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare: Tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare – Këshillim Publik*” në AKEP depozituan komente palët e mëposhtëme të interesuara:
  - a. Autoriteti i Konkurrencës nëpërmjet shkresës Nr.406/1 Prot., datë 7.02.2017 (referenca e AKEP Nr.1907/7 prot., datë 9.02.2017);
  - b. Telekom Albania sh.a nëpërmjet shkresës me Nr. Prot. 687, datë 1.02.2017 (referenca e AKEP Nr.1907/3 prot., datë 3.02.2017);
  - c. Albtelecom sh.a nëpërmjet shkresës me Nr. 893 Prot., datë 7.02.2017 (referenca e AKEP Nr.1907/4 prot., datë 7.02.2017);
  - d. Plus Communication sh.a. nëpërmjet shkresave me Nr.Prot. 132, datë 7.02.2017 (referenca e AKEP Nr.1907/5 prot., datë 7.02.2017);
  - e. Vodafone Albania sh.a me shkresën Ref. CEO/OO6/SK, date 6.02.2017 (referenca e AKEP: Nr.1907/6, date 8.02.2017) (Jo komente, kërkesë për shtyrje këshillimi).
3. Vodafone Albania nuk dërgoi komente për dy dokumentat e nxjerrë në këshillim publik por me shkresën Ref. CEO/OO6/SK, date 6.02.2017 (referenca e AKEP: Nr.1907/6, date 8.02.2017), “*Në lidhje me konsultimin publik të analizës së tregut të telefonisë celulare*”, drejtuar AKEP dhe për dijeni tre operatorëve të tjerë celulare, kërkonte nga AKEP zgjatjen e procesit të këshillimit publik të dy dokumentave për shkak se në kushtet kur tregu po përjetonte zhvillime dinamike (*negociatat midis operatorëve celularë për transferimin e radio-frekuencave të operatorit Plus Communication*), çka pritej të sillte dhe një ndryshim në strukturën e tregut celular. Shtyrja e procesit të këshillimit sipas Vodafone, do të ndihmojë AKEP si dhe palët e interesuara, përfshirë Vodafone, të rivlerësojnë qëndrimin e

tyre mbi tregjet me shumicë dhe pakicë, në rast se këto ndryshime do të konkretizohen, pa qenë nevoja për të rihapur analizën e tregut në një tjetër moment të afërt.

4. Këshilli Drejtues i AKEP në mbledhjen e datës 16.02.2017, sipas rendit të ditës mori në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga sipërmarrësi Vodafone Albania Sh.a. “Në lidhje me konsultimin publik të analizës së tregut të telefonisë celulare” dhe përcaktoi se procesi i këshillimit publik për dy dokumentat e nxjerrë në këshillim publik miratuar të jetë deri në një njoftim të dytë të AKEP, i cili në çdo rast nuk do të jetë më i gjatë se 60 (gjashtëdhjetë ditë) duke filluar nga data 16.02.2017. Ky njoftim i’u dërgua katër operatorëve celularë si dhe u publikua në faqen e internetit të AKEP në seksionin [Njoftime](#).
5. AKEP me shkresën Nr.1907/9 Prot., datë 8.05.2017, kërkoi që operatorët deri më 15.05.2017 të depozitonin pozicionin final të tyre për dy dokumentat e nxjerrë në këshillim publik në Dhjetor 2016 për analizën e tregut celular. Pas njoftimit për shtyrje të këshillimit publik dhe shkresës së cituar, në AKEP kanë depozituar komente/pozicionet finale për të dy dokumentat e nxjerrë në këshillim publik palët e mëposhtme të interesuara:
  - a. Neofone nëpërmjet shkresës me Nr.305 Prot., datë 4.03.2017 (referenca e AKEP Nr.1050 prot., datë 5.04.2017);
  - b. Telekom Albania sh.a nëpërmjet shkresës me Nr. Prot. 688, datë 15.05.2017 (referenca e AKEP Nr.1907/12 prot., datë 17.05.2017);
  - c. Albtelecom sh.a nëpërmjet shkresës me Nr. 3402 Prot., datë 18.05.2017 (referenca e AKEP Nr.1907/13 prot., datë 19.05.2017);
  - d. Plus Communication sh.a. nëpërmjet shkresës me Nr.Prot 517, datë 15.05.2017 (referenca e AKEP Nr.1907/10 prot., datë 16.05.2017);
  - e. Vodafone Albania sh.a nëpërmjet shkresës me Ref. LEA 045/0X, datë 15.05.2017 (referenca e AKEP Nr.1907/11 prot., datë 17.05.2017).
6. AKEP me shkresën nr.2285 prot., datë 16.12.2017 i kërkoi operatorëve celularë Vodafone Albania, Albtelecom dhe Telekom Albania që në vijim të përfundimit të procesit të konsolidimit të tregut celular, brenda datës 15.01.2018, të depozitojnë komentet finale në lidhje me dy dokumentat e nxjerrë në këshillim publik në Dhjetor 2016. Tre operatorët celularë kanë depozituar qëndrimet finale të depozituara në AKEP me shkresat e mëposhtme:
  - a. Telekom Albania me shkresën nr.8237/1 Prot, datë 11.01.2018 (referenca e AKEP Nr.2285/1, datë 12.01.2018);
  - b. Albtelecom me shkresën nr.263 Prot, datë 12.01.2018 (referenca e AKEP Nr.2285/2, datë 12.01.2018);
  - c. Vodafone Albania me shkresën Ref. LEA/003/0X, datë 15.01.2018 (referenca e AKEP Nr.2285/3, datë 16.01.2018).
7. AKEP në vijim prioritetit strategjik nr.2.3 dhe veprimeve specifike 17 dhe 18 të dokumentit “Strategjia dhe Plani i Veprimit të AKEP për vitin 2018”, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.29, datë 29.12.2017, me shkresën Nr. 69 Prot., datë 09.01.2018, u kërkoi tre operatorëve celularë dhe Albtelecom (fiks) informacion në lidhje me terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetet celulare/fikse. Tre operatorët celularë depozituan informacion me shkresat e mëposhtme:
  - a. Telekom Albania me shkresën nr.147/1 Prot, datë 26.01.2018 (referenca e AKEP Nr.69/1, datë 26.01.2018);

- b. Albtelecom me shkresën nr.217/1 Prot, datë 26.01.2018 (referenca e AKEP Nr.69/2, datë 26.01.2018);
  - c. Vodafone Albania me shkresën Ref.LEA/006/EK, datë 25.01.2018 (referenca e AKEP Nr.69/3, datë 29.01.2018).
8. AKEP me shkresën Nr.69/4, datë 1.02.2018, kërkoi nga Vodafone Albania plotësimin e informacionit të dërguar me shkresën cituar më sipër. Vodafone Albania plotësoi informacionin me shkresën Ref.LEA/013/EK, datë 9.02.2018 (referenca e AKEP Nr.69/5, datë 14.02.2018).
9. AKEP me VKD Nr.\_\_\_\_, datë \_\_.\_\_.2018, ka miratuar dokumentin “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare - Dokumenti Përfundimtar*”, dokument i cili:
- a. është përgatitur pas kryerjes së këshillimit publik të zhvilluar më 7.12.2016-7.02.2017 dhe më pas të zgjatuar sipas përkrahimit më sipër, dhe në përputhje me nenin 35 të Ligjit 9918 përmban komentet e të gjitha palëve të interesuara, dhe qëndrimin e AKEP për komentet (Aneks 1 i dokumentit);
  - b. përbën një dokument të rëndësishëm rregullator në bazë së të cilit merren vendimet për FNT në tregjet e analizuar dhe masat rregulluese respektive, të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillimet rregullatore dhe tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri;
  - c. nga pikpamja e rregullsisë, është në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligjin 9918 dhe Rregulloren për Analizën e tregut;
  - d. nga pikpamja e ligjshmërisë është në konformitet me përcaktimet ligjore të parashikuara për analizen e tregut në nenin 31 e në vijim të Kreut VI të Ligjit 9918, dhe Rregullores, përfshirë përkufizimin e detajuar të tregjeve përkates, kriteret e përcaktimit FNT, dhe detyrimet e parashikuara për FNT;
  - e. ka marrë në konsideratë rekomandimet dhe direktivat e Komisionit Europian dhe praktikatat më të mira rregullatore në vendet e Bashkimit Europian, parimet e ligjit të konkurrencës dhe kushtet aktuale të tregut Shqiptar celular;
  - f. vendosja, ndryshimi, mbajtja dhe heqja e detyrimeve për FNT është në përputhje, me përcaktimet e nenit 36 e në vijim të Kreut VI të Ligjit 9918, me pikën 5 të nenit 3 të Rregullores dhe me objektivat rregullatore të AKEP, të përcaktuara në nenin 7 të ligjit 9918;
  - g. përmban arsyetimin dhe përfundimin se tre operatorët celularë përmbushin kriteret për FNT në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare si dhe përmban arsyetimin për masat rregulluese për FNT për terminimin e thirrjeve (kombëtare) në rrjetet celulare;
  - h. përmban detyrimet e vendosura për FNT, të cilat janë në përputhje me përcaktimet e nenit 36 të ligjit 9918 dhe bazohen në natyrën e problemit të identifikuar dhe janë proporcionale e të justifikuara nga pikpamja e objektivave rregullatore të vendosura në nenin 7 të ligjit 9918.
10. Dokumenti “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare - Dokumenti Përfundimtar*” shërben si bazë për marrjen e vendimeve për statusin me FNT në tregjet e analizuar për terminimin e thirrjeve, dhe masat rregulluese për sipërmarrësit e përcaktuar me status me FNT.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të këtij vendimi për konkurrencën në treg, sipërmarrësin dhe realizimin e objektivave rregullatore, në mbështetje të pikës 1 të nenit 114, pikës 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe në zbatim të kompetencës ligjore të përcaktuar në shkronjën ç) të nenit 8 të ligjit nr. 9918,

## **V E N D O S I:**

1. Të miratojë dokumentin “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare - Dokumenti Përfundimtar*”, sipas dokumentit bashkëlidhur;
2. Ky Vendim dhe Dokumenti “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare - Dokumenti Përfundimtar*”, të publikohen në faqen e internetit [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**KRYETARI**

**Ilir ZELA**

## **ANËTARË:**

1. **Alban KARAPICI**
2. **Anila DENAJ**
3. **Ketrin TOPÇIU**
4. **Klarina ALLUSHI**



**ANALIZË**

**E**

**TREGUT**

**TË SHËRBIMEVE CELULARE**

**Tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjete publike  
telefonike individuale të lëvizshme**

**Dokumenti Përfundimtar**

**Shkurt 2018**

**(MIRATUAR ME VKD NR.11, DATE 22.02.2018)**

## Tabela e Përmbajtjes

|   |           |
|---|-----------|
| <b>I. PERMBLEDHJE .....</b>   | <b>4</b>  |
| <b>II.HYRJE .....</b>   | <b>8</b>  |
| II.1 STRUKTURA E DOKUMENTIT .....   | 8         |
| II.2 KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR PER PERCAKTIMIN E SIPERMARRESVE ME FNT DHE MASAT RREGULLUESE ..... | 8         |
| II.3 PROCESI I KËSHILLIMIT PUBLIK DHE KONSOLIDIMI I TREGUT CELULAR.....                               | 14        |
| II.4 OFRUESIT E RRJETEVE/SHËRBIMEVE DHE TERMINIMIT TË THIRRJEVE NË RRJETET CELULARE.....              | 16        |
| <b>III. ZHVILLIMET E TREGUT DHE IMPAKTI I MASAVE RREGULLUESE TË ANALIZËS SË TREGUT 2014 .....</b>     | <b>19</b> |
| III.1 ANALIZA E TREGUT CELULAR 2014.....  | 20        |
| III.2 NDRYSHMET NE TARIFAT CELULARE ME PAKICË ON-NET DHE OFF-NET .....                                | 22        |
| III.3 NDRYSHIMET NË NIVELIN DHE STRUKTURËN E THIRRJEVE .....  | 25        |
| III.4 TREGUES FINANCIARE TE KOMPANIVE CELULARE.....   | 27        |
| III.5 PJESET E TREGUT .....   | 32        |
| III.6 TERMINIMI I THIRRJEVE HYRËSE NDËRKOMBËTARE .....  | 34        |
| <b>IV. ANALIZA PËR FNT PËR TERMINIMIN E THIRRJEVE NË RRJETET CELULARE.....</b>                        | <b>38</b> |
| IV.1. PERKUFIZIMI I TREGUT TE TERMINIMIT TE THIRRJEVE NE RRJETET CELULARE.....                        | 38        |
| IV.2. ANALIZA PER FUQI TE NDJESHME NE TREG .....  | 43        |
| IV.3. PERFUNDIM PER FNT PER TERMINIMIN E THIRRJEVE .....  | 46        |
| <b>V. MASAT RREGULLUESE PËR FNT .....</b>   | <b>48</b> |
| V.1. IDENTIFIKIMI I PROBLEMEVE NGA FNT NË TERMINIMIN E THIRRJEVE .....                                | 48        |
| V.2 MASAT RREGULLUESE PËR FNT SIPAS KËTIJ DOKUMENTI.....  | 54        |
| <b>ANEKS 1. KOMENTET E KESHILLIMIT PUBLIK PËR ANALIZËN E TREGUT DHE QENDRIMI I AKEP .....</b>         | <b>58</b> |

## INDEKSI I TABELAVE DHE FIGURAVE

|   |    |
|---|----|
| TABELA III.1: ECURIA E ARPM DHE ARPU 2010-2016 .....  | 23 |
| FIGURA III.1. ARPU NË VENDET E BE DHE SHQIPËRI (2014/2015).....   | 24 |
| FIGURA III.2: STRUKTURA E THIRRJEVE DALESE CELULARE SIPAS DESTINACIONIT .....   | 25 |
| FIGURA III.3 STRUKTURA E THIRRJEVE CELULARE (JANAR 2014-QERSHOR 2017).....  | 26 |
| FIGURA III.4: ECURIA E SASISË SË TRAFIKUT ON-NET DHE OFF-NET JANAR 2014-QERSHOR 2017.....   | 27 |
| FIGURA III.5: TE ARDHURAT TOTALE TE OPERATOREVE CELULARE 2004-2016 .....  | 28 |
| FIGURA III.6: TE ARDHURAT NGA SHERBIMET ME PAKICE 2010-2016 .....   | 28 |
| FIGURA III.7: TE ARDHURAT NGA SHERBIMET ME SHUMICE 2010-2016.....   | 29 |
| FIGURA III.8: ECURIA E FITIMEVE NETO TE SIPERMARRESVE TE RRJETEVE CELULARE (2010-2015).....   | 30 |
| FIGURA III.9: ECURIA E INVESTIMEVE TE SIPERMARRESVE NE RRJETE CELULARE (2010-2016) .....  | 31 |
| TABELA III.2. PJESET E TREGUT TE OPERATOREVE CELULARE 2014-2017 .....   | 32 |
| FIGURA III.10: TERMINIMI I THIRRJEVE KOMBETARE DHE NDËRKOMBËTARE 2014-2016.....   | 35 |
| TABELA III.3: PESHA E TERMINIMIT NDËRKOMBËTAR NË TOTALIN E TERMINIMIT 2014-2016 .....   | 36 |
| TABELA III.4: TË ARDHURA NGA MTR NDËRKOMBËTARE DREJT NURMAVE TË PORTUAR (2017) .....  | 37 |
| FIGURA IV.1: TARIFAT Ë TERMINIMIT CELULAR NË SHQIPËRI DHE VENDET E BEREK (2008-2017) .....  | 45 |
| TABELA V.1: RAPORTI I THIRRJEVE ON-NET DHE OFF-NET SIPAS OPERATORËVË JANAR 2014-DHJETOR<br>2017 .....                               | 50 |
| FIGURA V.1: ECURIA E TRAFIKUT DHE TË ARDHURAVE NETO MIDIS TRE OPERATORËVE CELULARE 2014-<br>17 .....                                | 51 |
| FIGURA V.2: PAGESAT NETO TE TERMINIMIT TE ALBTELECOM PER TRAFIKUN E SHKEMBYER ME TRE<br>OPERATORET E TJERE CELULARE 2014-2017 ..... | 52 |



# I. Permbledhje

---

Ky dokument përbën versionin final të Analizës së tregut për tregun përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare dhe është përgatitur pas këshillimit publik të dokumentit “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare: Tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare – Këshillim Publik*”<sup>1</sup>. Dokumenti përmban një rishikim të perfundimeve të analizës së fundit të tregut celular të kryer në vitin 2014 dhe masave rregulluese përkatëse për FNT. Dokumenti i analizës së tregut trajton zhvillimet historike në treg dhe pritshmeritë e AKEP për të ardhmen e afert dhe të mesme dhe masat rregulluese përkatëse për FNT në tregjet përkatës të analizuar.

Në bazë të përcaktimeve të Ligjit 9918, AKEP publikoi në faqen e Internetit [www.akep.al](http://www.akep.al) dokumentin “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare – Këshillim Publik*” për këshillim publik me palet e interesuara në periudhën 7.12.2016-7.02.2017. Dokumenti i nxjerre për këshillim publik përmbante:

- përkufizimin e tregjeve përkatëse të analizuar
- analize të konkurrencës në tregjet përkatës dhe vlerësimin nëse ka operatore me fuqi të ndjeshme në treg (FNT)
- masat rregulluese të propozuara për sipërmarrësit e propozuar me FNT

Në lidhje me masën rregulluese të kontrollit të tarifave të sipërmarrësve të propozuar për status me FNT, AKEP zhvilloi një proces të vecantë këshillimi publik, në përputhje me përcaktimet e nenit 57 e në vijim të Ligjit 9918, për të përcaktuar metodën e kontrollit të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare të sipërmarrësve të propozuara me FNT në këto tregje përkatës. Procesi i këshillimit publik për dokumentin “*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – Këshillim Publik*” u krye në periudhën 22.12.2016-7.02.2017.

Këshillimi publik për të dy dokumentat perfundonte më 7.02.2017 dhe kjo periudhë u zgjat pas pranimit të kërkesës së Vodafone Albania (dhe dakortësisë së operatorëve të tjerë) për shtyrje të procesit për shkak të negociatave midis operatorëve celularë për transferimin e radio-frekuencave të operatorit Plus Communication, cka pritej të sillte dhe një ndryshim në strukturën e tregut celular si dhe në qëndrimet e operatorëve celularë për dokumentat e nxjerrë në këshillim publik nga AKEP.

Procesi i transferimit të frekuencave të sipërmarrësit Plus Communication përfundoi me miratimin nga AKEP dhe Autoriteti i Konkurrencës (AK) të kërkesës së këtij sipërmarrësi dhe sipërmarrësve të tjerë të përfshirë në proces në muajt Nëntor-Dhjetor 2017, dhe prej datës 1.01.2018 Plus Communication nuk ofron më shërbime dhe rrjete celulare. Tre operatorët celularë në vijim të komenteve të dërguara në Shkurt 2017 dhe Prill 2017, më datë 15.01.2018 depozituan në AKEP komentete/qëndrimet finale në lidhje me dy dokumentat e nxjerrë në këshillim publik. Komentet (finale) të të gjitha palëve të interesuara (përfshirë të Autoritetit të Konkurrencës) për dokumentin

---

<sup>1</sup> Miratuar me Vendimin Nr.2699, datë 1.12.2016, për “*Miratimin për Këshillim Publik të Dokumentit: Analizë e tregut të shërbimeve celulare: Tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare – Këshillim Publik*”.

e analizës së tregut të nxjerrë në këshillim publik dhe qëndrimet e AKEP për komentet janë përfshirë në Aneks 1 të këtij dokumenti.

Bazuar në përcaktimet e Ligjit 9918 dhe Rregullores së Analizës së Tregut, AKEP në përgatitjen e dokumentit ka marrë në konsideratë dhe rekomandimet dhe Udhezimet e Komisionit Europian (KE) dhe BEREC (Grupi i Rregullatoreve Europiane), si dhe ka bërë krahasime të zhvillimeve të tregut celular në Shqipëri me zhvillimet dhe tregues të tregut në vendet e BE. Ky version final i analizës së tregut celularë për terminim e thirrjeve përbën përfundimin e rrethit nr.6 të analizës së këtij tregu përkatës nga viti 2006.

### **Zhvillimet e tregut dhe impakti i masave rregulluese pas analizës 2014**

Analiza e fundit e tregut celular u krye në vitin 2014, dhe AKEP në përfundim të procedurës me Vendimet nr.2522-2526, miratoi dokumentin final të analizës së tregut dhe përcaktoi katër sipërmarresit e rrjeteve celulare me FNT (Fuqi e Ndjeshme në Treg) për terminimin e thirrjeve në rrjetet individuale celulare si dhe masat rregulluese përkatëse për statusin e FNT. Bazuar në rekomandimet e Autoritetit të Konkurrencës dhe problematiken e evidentuar të diskriminimit në tarifën e thirrjeve brenda dhe jashtë rrjetit celular (on-net/off-net), AKEP në masat rregulluese për FNT përfshiu dhe detyrimin për mos-diskriminim në tarifën e thirrjeve on-net dhe off-net.

Me daljen nga tregu të Plus Communication nga data 1.01.2018, tregu ka përjetuar një ndryshim të rëndësishëm strukturor, reduktim të numrit të operatorëve celularë nga 4 në 3, i cili ka ndikim në pritshmëritë e AKEP për ecurinë e tregut me pakicë celularë në të ardhmen. AKEP gjykon se për të vlerësuar më mirë efektet e daljes nga tregu të Plus në strukturën e tregut me pakicë celularë si dhe në konkurrencën e pritshme në këtë treg, duhet të priten rezultatet e ndryshimit të numrit të pajtimtarëve dhe pjesëve të tregut të tre operatorëve të tjerë celularë si dhe ka nevojë për një analizë të vecantë të tregut me pakicë dhe/ose tregjeve të tjera të tjera të justifikueshme për ndërhyrje eksante. Për këto tregje AKEP do të kryejë një proces të vecantë këshillimi publik në muajt në vijim.

Megjithatë ndryshimet e ndjeshme në tarifën dhe trafikun off-net dhe on-net, si dhe reduktimet e ndjeshme të tarifave të terminimit, të imponuara nga masat rregulluese të AKEP, pjesët e tregut të operatorëve nuk kanë pësuar ndryshime të ndjeshme në këto tre vite duke mos rezultuar në reduktim të nivelit të përqendrimit të tregut me pakicë. Vodafone vazhdon të ketë pjesën më të madhe të tregut për shumicën e treguesve (50-60% për shumë tregues), dhe me daljen nga tregu të Plus, duke filluar nga 1.01.2018 në treg janë vetëm 3 operatorë aktivë që ofrojnë rrjete dhe shërbime celulare.

### **Analiza e tregut të terminimit për 2-3 vitet në vijim**

Bazuar në përfundimet e Analizës së tregut, përfshirë vlerësimin e ndryshimeve në strukturën e tregut celular me daljen nga tregu të Plus, AKEP gjykon se përfundimet e analizës së tregut për FNT për tregun përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare nuk ndikohen nga ndryshimi i strukturës së tregut me pakicë, pasi sipas përkufizimit të këtij tregu secili operator celularë që është aktiv në treg është ofrues i vetëm i terminimit të thirrjeve në rrjetin e tij. Dalja nga tregu e Plus Communication nuk ndikon në përfundimet për FNT të tre operatorëve të tjerë celularë për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale.

Duke marrë në konsideratë faktorët (argumentat) për FNT në tregun përkatës të terminimit të thirrjeve, AKEP vlerëson se tre operatorët celularë përmbushin kriteret për fuqi të ndjeshme në tregjet përkatëse të terminimit të thirrjeve zanore në rrjetet e tyre celulare:

- **Sipermarresi Telekom Albania sh.a permbush kriteret per FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjetin celular Telekom Albania.**
- **Sipermarresi Vodafone Albania sh.a permbush kriteret per FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjetin celular Vodafone Albania.**
- **Sipermarresi Albtelecom sh.a permbush kriteret per FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjetin celular Albtelecom.**

Kriteret e marra ne shqyrtim per FNT për terminimin e thirrjeve nuk kane ndryshuar dhe nuk pritet te ndryshojne te pakten ne nje periudhe afatmesme 2-3 vjecare, ne menyre qe te eliminojne aftesine ndikuese te operatoreve ne tregjet perkates te terminimit te thirrjeve ne rrjetet e tyre individuale.

Në lidhje me masat rregulluese, AKEP bazuar në përfundimet e këtij version final të analizës së tregut gjykon që tre operatorët celularë të kenë detyrimet e mëposhtme për FNT për terminimin e thirrjeve:

- Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39)
- Detyrimi i transparencës (Neni 40)
- Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42)
- Detyrimi për kontroll të tarifave dhe orientim në kosto (Neni 45)

Detyrimi i mos-diskriminimit per FNT ne terminimin e thirrjeve, do te vijojte te zbatohet sipas percaktimeve te kryera ne analizen e meparshme dhe perfshin edhe detyrimin e mos-diskriminimit ne tarifat me pakice te thirrjeve on-net/off-net për të tre operatorët celularë.

AKEP vlerëson se ekzistojnë kushtet që zbatimi i mases rregulluese të mos-diskriminimit ne tarifat me pakice te thirrjeve on-net/off-net të përfshihet në një diskutim më të gjerë, për shkak të lidhjes indirekte të kësaj mase me detyrimet për FNT në tregun me pakicë celular, ku ky detyrim mund të vendoset vetëm për operatorët që kanë dominancë apo FNT edhe në tregun përkatës me pakicë celular. AKEP gjykon që tre operatorët të vijojnë zbatimin e kësaj mase, ndërsa rishikimi i proporcionalitetit të saj për secilin operator do të kryhet në kuadër të analizës së tregut me pakicë celular dhe tregjeve të tjera të justifikuar për ndërhyrje ex-ante që do kryejë AKEP me këshillim publik në muajt në vijim.

AKEP gjykon se masa e rregullimit (kontrollit) te tarifave te terminimit te kater operatoreve me FNT eshte e nevojshme, pasi ne mungese te saj secili operator, qe eshte monopolist ne ofrimin e terminimit te thirrjeve ne rrjetin e vet, do kishte stimujt per te aplikuar tarifa te larta terminimi ne dem te konkurrences dhe interesave te konsumatoreve.

### **MTR për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, përfshirë drejt numrave të portuar**

Bazuar në vlerësimin e kryer në këtë dokument final të analizës së tregut, përfshirë një vlerësim më të detajuar të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, AKEP gjykon të lërë të pandryshuar përkufizimin e tregut përkatës për terminimin e thirrjeve, pra që ai të përfshijë vetëm thirrjet kombëtare. Ndërkohë terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, nëse ai përbën një treg të vecantë përkatës (të ndryshëm apo të njëjtë me terminimin e thirrjeve kombëtare), si dhe për nevojën ose jo të rregullimit të tij, do të vlerësohet nga AKEP në procesin e ri të analizës së tregut celular, me pakicë dhe tregjet e tjera të justifikueshme për ndërhyrje ex-ante.

AKEP gjykon të heqë rregullin për barazimin e MTR të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare drejt numrave të portuar (kur këto përcillen nga operatori dhurues tek operatori marrës) me MTR kombëtare. Ky de-rregullim është në linjë me trajtimin rregullator të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, ku operatorët nuk kanë FNT që prej vitit 2012, si dhe me praktikën ndërkombëtare.

Rregullimi aktual i MTR të thirrjeve të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare drejt numrave të portuar (kur këto përcillen nga operatori dhurues tek operatori marrës) është kryer me vendimet për miratimin e ofertave referencë të operatorëve celularë (dhe fiks për analogji), dhe që ndryshimi të hyjë në fuqi do të duhet të ndryshohen oferta referencë të operatorëve për këto thirrje (përcaktimi barazimit të MTR të këtyre thirrjeve me MTR të thirrjeve kombëtare) sipas sipas përcaktimeve në ligjin 9918 dhe Rregullores së Akses dhe Interkoneksionit. AKEP njëkohësisht do të përforcojë detyrimet e operatorëve në Rregulloren e Portabilitetit për të përcjellë thirrjet hyrëse ndërkombëtare drejt numrave të portuar, kur këto thirrje shkojnë fillimisht tek operatori dhënës.

AKEP gjykon që masat rregulluese për FNT të përcaktuara në këtë dokument janë të arsyetuara, proporcionale me problemet e identifikuar dhe i shërbejnë objektivit rregullator të rritjes së konkurrencës në treg dhe përfitimeve të përdoruesve.

### **Hapa të tjerë**

Duke reflektuar zhvillimet në treg gjatë vitit 2017, si konsolidimi i regut celular nga 4 në 3 operatorë, impakti i masave rregulluese dhe proporcionaliteti i tyre etj, AKEP me miratimin e këtij dokumenti do të nisë dy procese të reja këshillimi publik:

- *“Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – Këshillim Publik nr.2.*  
Ky dokument i miratuar për këshillim publik me Vendim nr. 2700, datë 22. 12. 2016 të AKEP së bashku me përditësimet dhe ndryshimet e kryera pas këshillimit publik, do të hidhet përsëri në këshillim publik me afat 30 ditë (sipas nenit 57);
- *“Analizë e tregut celular: tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit, tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare-Këshillim Publik”*  
Ky dokument do të përfshijë ri-vlerësimin e AKEP për tregun me pakicë celulare dhe gjithë tregjet e tjera justifikueshme për ndërhyrje ex-ante pas ndryshimeve të strukturës së tregut celular dhe rekomandimeve të AK, përfshirë një diskutim më të gjerë për rishikimin ose jo të masës rregulluese të mos-diskriminimit në tarifën me pakicë on-net/of-net dhe terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare. Procesi i këshillimit publik do jetë 2 muaj sipas nenit 34 të ligjit 9918.

# II. Hyrje

---

## II.1 Struktura e dokumentit

Struktura e dokumentit në pjesën në vijim është sa më poshtë:

- Kapitulli I, vijon me një pershkrim të bazes ligjore dhe nen-ligjore për analizen e tregut, të procesit të këshillimit publik të dy dokumentave të cituar si dhe konsolidimi i tregut celular në fund të vitit 2017;
- Kapitulli III përmban një zhvillimet kryesore të tregut celular pas analizës 2014 duke u fokusuar në impaktin e masave rregulluese të analizës 2014 dhe ceshtje të tjerë të lidhura me terminimin e thirrjeve;
- Kapitulli IV përmban Analizën e tregjeve përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, në lidhje me përkufizimin e tregjeve përkatëse dhe FNT për këto tregje për 2-3 vitet në vijim dhe cilët operatorë përcaktohen me FNT;
- Kapitulli V përmban masat rregulluese që AKEP për sipërmarresit me FNT për terminimin e thirrjeve (sipas përfundimit në kapitullin IV), përfshirë vendosjen e detyrimit për rregullimin e tarifave të këtyre thirrjeve (MTR);
- Aneks 1 përmban përmbledhje të komenteve të palëve të interesuara dhe qëndrimin e AKEP për këto komente për dokumentin “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare: Tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare – Këshillim Publik*”, publikuar për këshillim publik më 7.12.2016

## II.2 Kuadri ligjor dhe rregullator për përcaktimin e sipërmarresve me FNT dhe masat rregulluese

Ky seksion përmban informacion në lidhje me kuadrin ligjor dhe nen-ligjor për analizen e tregut, rolin e analizës së tregut dhe masave rregulluese, konceptin e dominancës/FNT dhe lidhjet midis rregullimit ex-ante nga rregullatori sektorial dhe atij ex-post nga autoriteti i konkurrencës.

### **Objektivat e Ligjit dhe kuadri rregullator**

Ligji nr.9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, (në vijim Ligji 9918), në nenin 1 të tij, përcakton se qëllimi i ligjit është që nëpërmjet parimit të asnjësisë teknologjike të promovojë konkurrencën dhe infrastrukturë eficiente në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 7 i Ligjit 9918, Objektivat Rregullatore, përcakton midis të tjerave se AKEP nxit konkurrencën eficiente për sigurimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, facilitetet shoqëruese dhe shërbimet e tjera për t’u krijuar mundësinë çdo kategorie përdoruesish të shërbimeve të komunikimeve elektronike, përfshirë edhe përdoruesit me aftësi të kufizuara, të

kenë përfitime maksimale nga aksesit në shërbimet e komunikimeve elektronike, në kuptimin e zgjedhjes së çmimit dhe cilësisë.

Kapitulli VI, Rregullimi i Konkurrencës, përmban përcaktimet për rregullimin e konkurrencës në tregun e komunikimeve elektronike, dhe përfshin ndërmjet të tjerave detyrimin e AKEP për kryerjen e analizës së tregut për vlerësimin e konkurrencës efektive dhe përcaktimin e sipërmarresve me fuqi të ndjeshme në treg. Kreu VI, përmban gjithashtu kriteret e përdorura nga AKEP për vlerësimin e fuqisë së ndjeshme në treg, detyrimet/masat rregulluese në rast të gjetjes së FNT.

Pika 4 e nenit 31, parashikon detyrimin për një rregullore për analizën e tregjeve dhe përcaktimin e FNT. AKEP me vendimin Nr.747, datë 17.07.2009, ka miratuar Rregulloren për Analizën e Tregjeve (në vijim referuara si Rregullorja), dhe me Vendimin nr.2342, datë 31.07.2013 ka miratuar amendime të kësaj Rregulloreje. Rregullorja përcakton midis të tjerave një listë prej 7 tregjeve për t'u analizuar nga AKEP për FNT, si dhe detyrimin për të kryer testin e tre kriterëve për tregjet që nuk janë pjesë e listës së tregjeve të rregullores ose e Rekomandimit në fuqi të Komisionit Europian për tregjet përkatëse të dyshuara për nderhyrje ex-ante në sektorin e komunikimeve elektronike. Lista e tregjeve të përfshira në rregullore është sipas rekomandimit të KE të vitit 2007, ndërsa rekomandimi i fundit në fuqi i KE është Rekomandimi 2014/710/EC i datës 9 Tetor 2014.

Ligji 9918 është në linjë me direktivat e KE të vitit 2003 dhe 2009 dhe metodologjia e analizës së tregjeve e përcaktuar në Ligj dhe në Rregullore, përcakton se AKEP duhet të marrë në konsideratë rekomandimet e Komisionit Europian dhe BEREC. Disa nga Rekomandimet dhe udhëzimet e KE dhe BEREC (me parë ERG) të marra në konsideratë nga AKEP në përgatitjen e këtij dokumenti janë si më poshtë:

- Udhëzimi i komisionit (europian) për analizën e tregut dhe vlerësimin e FNT (2002/C 165/03) sipas kuadrit rregullator për komunikimet elektronike, rrjetet dhe shërbimet të komunikimit elektronik (në vijim referuar si Udhëzimi i KE)<sup>2</sup>
- Dokumenti i rishikuar i ERG<sup>3</sup> për Qendrim të përbashkët në qasjen ndaj masave rregullatore të duhura në kuadrin rregullator të komunikimeve elektronike.
- Rekomandimi i Komisionit, datë 9 Tetor 2014 për produktet dhe shërbimet përkatëse brenda sektorit të komunikimeve elektronike të rregulluara ex ante në përputhje me Direktivën 2002/21/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit në një kuadër të përgjithshëm rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik (2014/710/EC)
- Rekomandimi i Komisionit, datë 7 Maj 2009 për trajtimin rregullator të tarifave të terminimit në rrjete celulare dhe fikse në BE.
- Dokumenta të tjera të KE dhe BEREC sipas shënimeve përkatëse.

---

<sup>2</sup> Official Journal of the European Communities C 165/7: "Commission guidelines on market analysis and the assessment of significant market power under the Community regulatory framework for electronic communications networks and services (2002/C 165/03)"

<sup>3</sup>ERG (06) 33 "Revised ERG Common Position on the approach to appropriate remedies in the ECNS regulatory framework" Final Version May 2006.

## **Analiza e tregut nga autoriteti rregullator dhe bashkepunimi me Autoritetin e Konkurrences**

Sipas Nenit 38 të Ligjit Nr.9918, AKEP-i duhet të bashkëpunojë me Autoritetin e Konkurrencës. Gjithashtu AKEP dhe Autoriteti i Konkurrencës (AK) kanë nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me datë 29.08.2007, ku midis të tjerave “Neni 6”, parashikon bashkëpunimin midis dy autoriteteve per perkufizimin e tregut, përcaktimin e dominancës/FNT, masave rregulluese etj. Ky dokument paralelisht i’u dergua edhe AK per dhenien e komenteve perkatese. Komentet e AK jane perfshire ne Aneks 1 te ketij dokumenti.

Sic percaktohet ne aktet ligjore dhe nen-ligjore te komunikimeve elektronike ne Shqiperi dhe dokumentat e KE dhe BEREC, roli i analizes se tregut eshte te percaktoje nese tregu/tregjet perkates te analizuar jane apo tentojne te shkojne drejt konkurrences efektive dhe ne rast se jo percaktimin e operatorit/operatorëve me FNT dhe masat rregulluese ne tregun/tregjet perkatese qe cojne ne konkurrence efektive. Analiza e tregut bazohet fillimisht ne nje liste te tregjeve perkatese qe jane te justifikueshem/dyshuar per nderhyrje ex-ante, dhe bazuar ne parimet/kriteret e percaktuara per gjetjen e dominances sipas parimeve te legjislacionit per konkurrencen percaktohet operatori/operatoret me FNT ne treg. Megjithese analiza e tregut rregullatori sektorial bazohet ne parimet e konkurrences, roli i saj eshte i ndryshem nga analizat e AK per dominace dhe abuzim me dominacen. Analiza e tregut e rregullatorit sektorial bazohet ne te kaluaren, por vlereson dhe perspektiven e tregut dhe mundesise per FNT ne te ardhmen dhe merr masa ne rast se vlersohet se do kete dominace ne te ardhmen, pra nderhyrje ex-ante per te eliminuar problemet qe mund te ndodhin ne treg nga dominanca. Ndersa, AK ne rastet e vlersimit te abuzimit me dominancen merr ne konsiderate sjelljen dhe demin qe mund te kete shkaktuar dominanca e nje operatori ne treg ne te kaluaren. Pra problemet qe mund te kene ndodhur nga sjellja abuzive ne nje treg te caktuar ne te kaluaren, adresohen nga ligji dhe nderhyrjet e AK.

Udhezimi i KE per analizen e tregjeve paraqet ne menyre me te detajuar ngjashmerite dhe ndryshimet midis analizave te kryera nga rregullatori i komunikimeve elektronike ne lidhje me perkufizimin e tregut perkates dhe dominances dhe ato te kryera nga autoriteti i konkurrences per abuzim me dominace apo vleresime te bashkimeve te kompanive. Ne paragrafet 30<sup>4</sup> dhe 31<sup>5</sup> te ketij udhezimi KE citon nder te tjera se percaktimi me FNT i nje sipermarresi ne rregullimin ex-ante nuk nenkupton automatikisht se ai eshte me pozite dominuese apo qe ka abuzuar me poziten

---

<sup>4</sup> *The designation of an undertaking as having SMP in a market identified for the purpose of ex-ante regulation does not automatically imply that this undertaking is also dominant for the purpose of Article 82 EC Treaty or similar national provisions. Moreover, the SMP designation has no bearing on whether that undertaking has committed an abuse of a dominant position within the meaning of Article 82 of the EC Treaty or national competition law. It merely implies that, from a structural perspective, and in the short to medium term, the operator has and will have, on the relevant market identified, sufficient market power to behave to an appreciable extent independently of competitors, customers, and ultimately consumers, and this, solely for purposes of Article 14 of the framework Directive.*

<sup>5</sup> *In practice, it cannot be excluded that parallel procedures under ex-ante regulation and competition law may arise with respect to different kinds of problems in relevant markets (15). Competition authorities may therefore carry out their own market analysis and impose appropriate competition law remedies alongside any sector specific measures applied by NRAs. However, it must be noted that such simultaneous application of remedies by different regulators would address different problems in such markets. Ex-ante obligations imposed by NRAs on undertakings with SMP aim to fulfil the specific objectives set out in the relevant directives, whereas competition law remedies aim to sanction agreements or abusive behaviour which restrict or distort competition in the relevant market.*

dominuense sipas legjislacionit te konkurrences, si dhe ne praktike mund te ndodhe qe dy autoritetet (rregullatore dhe i konkurrences) te kryejne procedura paralele per te adresuar probleme te ndryshme ne tregjet perkates. Megjithate, KE thekson se ne te tilla raste detyrimet ex-ante te rregullatorit per FNT synojne te permbushin objektivat e direktivave (ligjit) ndersa masat e autoritetit te konkurrences synojne te sanksionojne marreveshje ose sjellje abuzive te cilat kufizojne ose shtremberojne konkurrencen.

### **Perkufizimi i tregut perkates**

Ne kuader te analizave te kryera nga nje rregullator per qellime te analizes se konkurrences efektive dhe percaktimit te sipermarresit/sipermarresve me FNT, analiza e nje tregu perkates fillon me shqyrtimin e produkteve dhe sherbimeve qe konsiderohen te jene pjese e te njejtit treg.

Sic eshte cituar ne Analizat e tregut te meparshme AKEP ne lidhje me perkufizimin e tregut perkates, perdor perkufizimin e dhene ne nenin 3, pika 7 te Ligjit nr.9121, date 28.7.2003 “Per Mbrojtjen e Konkurrences” i ndryshuar:

*Treg perkates - jane produktet qe vleresohen si te zevendesueshme nga konsumatorët ose klientët e tyre, per sa u perket karakteristikave, çmimit dhe funksionit te tyre dhe qe ofrohen ose kerkohen nga ndermarrjet ne nje zone gjeografike me kushte te njejta konkurrence, zone kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese.*

Ky perkufizim i Ligjit nr.9121, date 28.7.2003 “Per Mbrojtjen e Konkurrences” i ndryshuar, eshte i ngjashem dhe ne linje me perkufizimin e dhene ne Udhezimin e KE, pika 44 <sup>6</sup>, udhezim i perdorur nga AKEP (ERT) ne te gjitha analizat e meparshme. Per kete arsye si dhe duke qene se udhezimi i KE, eshte pjese e dokumentave te KE te referuara ne Rregullore per analizen e tregut, AKEP ne kete Analize perdor te njejten metodologji per percaktimin e produkteve/sherbimeve qe jane pjese e te njejtit treg perkates, si dhe ne Analizat e tjera te tregut, sic eshte shtjelluar dhe ne paragrafet ne vijim.

Perkufizimi i tregut per nje produkt/sherbim merr parasysh efektin e zevendesueshmerise se produktit/sherbimit (ne anen e kerkeses dhe ofertes), si edhe dimensionin gjeografik. Nje instrument ndihmes qe perdoret per identifikimin e tregjeve eshte parimi i monopolistit hipotetik.

### **Parimi i monopolistit hipotetik**

Nje produkt konsiderohet te perbeje nje treg me vete nese “monopolisti” (hipotetik) qe ofron produktin mund te rrise çmimin e ketij produkti per nje periudhe kohe jo tranzitore dhe te mos kete renie ne shitje deri ne nivelin qe kjo te jete jo- fitimprurese. Pra, rritja e çmimit duhet te jete fitimprurese dhe e qendrueshme-monopolisti te kete aftesine te mbaje çmimin mbi nivelin konkurrues.

Testi i monopolistit hipotetik kryhet per te analizuar produktet/sherbimet te cilat mund te bejne pjese ne te njejtin treg duke marre ne konsiderate efektin e zevendesueshmerise se produkteve ne

---

<sup>6</sup> According to settled case-law, the relevant product/service market comprises all those products or services that are sufficiently interchangeable or substitutable, not only in terms of their objective characteristics, by virtue of which they are particularly suitable for satisfying the constant needs of consumers, their prices or their intended use, but also in terms of the conditions of competition and/or the structure of supply and demand on the market in question (32). Products or services which are only to a small, or relative degree interchangeable with each other do not form part of the same market (33). NRAs should thus commence the exercise of defining the relevant product or service market by grouping together products or services that are used by consumers for the same purposes (end use).



anen e kerkeses dhe/ose ofertes. Nese monopolisti perballat me kufizime nga ana e kerkeses-konsumatorit do te zhvendosen drejt konsumit te nje produkti tjetër, qe do ishte zevendesues dhe, nga ana e ofruesve- ofrues te tjere do te futeshin ne kete treg per te ofruar produktin me çmim dhe perfitim te larte, atehere produktet e tjera qe jane zevendesues te ngushte te produktit te analizuar duhet te perfshihen ne kete treg.

### ***Zevendesimi ne anen e kerkeses***

*Nese nje subjekt, qe eshte monopol ne ofrimin e nje produkti/sherbimi, do te rriste çmimin e ketij produkti, gfare mundesish kane konsumatorit te zevendesojne perdorimin e ketij produkti me nje tjetër ?*

Produkti/sherbimi qe analizohet krahasohet me produkte te tjere, nese ato mund te zevendesohen nga ana e konsumatorit. Nese konsumatorit mund te zevendesojne produktin e ofruar nga monopolisti hipotetik me nje produkt apo produkte te tjera, keto te fundit duhet te perfshihen ne perkufizimin e tregut perkates.

### **Zevendesimi ne anen e ofertes**

Nese monopolisti hipotetik do te rriste çmimin e produktit/sherbimit per nje periudhe kohe jo tranzitore, a do te kishte presion nga ofrues te tjere te mundshem te ketij sherbimi? Operatore te tjere, te cilet nuk e ofrojne sherbimin ne fjale, mund te zhvendosin burimet e tyre ne drejtim te ofrimit te ketij sherbimi.

Ne zevendesimin ne anen e ofertes duhet te merren parasysh vetem operatoret, te cilet mund te zhvendosin burimet e tyre drejt ofrimit te sherbimit te marre ne konsiderate, per nje kohe te shkurter dhe pa kosto te larta te pakthyeshme. Pra, operatore te rinj qe nuk jane ne treg nuk mund te merren parasysh, pasi reagimi i tyre ndaj nje rritjeje te çmimit te produktit nuk do te ishte i shpejte (ne periudhe afatshkurter) por do te kerkonte kohe per investime kapitale qe kerkojne nje periudhe afatgjate. Ofruesit e mundshem jane operatore qe ofrojne sherbime te tjera dhe lehtesisht per nje periudhe kohe te shkurter mund te prodhojne edhe produktin, çmimi i te cilit eshte rritur.

Efekti i operatoreve te rinj ne treg, qe duhet te kryejne investime kapitale, merret ne konsiderate vetem ne analizen e fuqise se ndjeshme ne treg, pra te konkurrences se mundshme qe keta operatore mund te ushtrojne.

Nje faktor tjetër qe merret ne konsiderate ne perkufizimin e tregut perkates eshte nese ekzistojne kufizime te perbashketa ne tarifim (common pricing constraints) midis klienteve, sherbimeve apo zonave te ndryshme. Kjo do te thote qe operatori te mos jete i pavarur ne tarifimin e sherbimeve te ndryshme: s'ka mundesi te rriste çmimin e nje sherbimi pa reduktuar çmimin e nje sherbimi tjetër, i cili ne vetevete nuk eshte zevendesues per sherbimin tjetër.

### **Fuqia e Ndjeshme ne Treg dhe masat rregulluese**

Pekufizimi i FNT eshte dhene ne nenin 33 te ligjit:

*Një sipërmarrës vlerësohet me fuqi të ndjeshme në treg nëse, i vetëm, apo së bashku me të tjerë, zotëron një pozitë të tillë ekonomike, që i mundëson një zgjerim të ndjeshëm, pavarësisht nga konkurrentët, klientët apo përdoruesit fundorë.*

Ky perkufizimi eshte pothuajse i njejte me perkufizimin e Direktives Kuader te KE 2002, neni 14<sup>7</sup> (EC 2002 Frameëork Directive).

Neni 33 i Ligjit percakton gjithashtu kriteret kryesore qe duhet merren ne konsiderate per analizen per FNT, duke bere nje ndarje per rastet kur ne treg dyshohet per nje sipermarres me FNT, qe do te thote dominance individuale, dhe per raste kur dyshohet per me shume se nje sipermarres me FNT apo dominance e bashkuar. Perkufizimi i dominances se bashkuar i dhene ne nenin 33 eshte si vijon:

*Dy ose më shumë sipërmarrës vlerësohen se kanë një pozitë zotëruese nëse edhe në mungesë të lidhjeve strukturore apo të lidhjeve të tjera, veprojnë në treg në një strukturë dhe mënyrë të tillë, e cilatë çon në një sjellje të bashkërenduar, në mënyrë të pavarur nga konkurrentët, klientët ose përdoruesit.*

Per percaktimin e FNT, dominace individuale apo e bashkuar, sic theksohet dhe ne pikat 79 dhe 98 te Udhezimit te KE, kriteret e perdorur duhen marre te gjithe ne konsiderate dhe ne kombinim me njeri tjetrin dhe jo ne menyre te vecante per secilin kriter me vete, pasi evidenca e kriterëve te vecante mund te mos jete percaktuese e FNT.

Analiza per FNT eshte nje analize e cila merr ne konsiderate zhvillimet e kaluara dhe njekohesisht tendencen per te ardhmen (forward looking), pasi mungesa e konkurrencës ne te kaluaren nuk do te thote qe nje treg nuk ka tendence per te qene ne konkurrenca ne te ardhmen. Ne kete menyre Analiza krahas shqyrtimit te kriterëve per vleresimin e konkurrencës efektive ne treg ne te kaluaren, ben vleresin se si pritet te evoluojë tregu ne te ardhmen. Analiza kryhet per te shqyrtuar nese nje treg perkates vlerësohet te jete ne konkurrenca efektive ne nje periudhe te pakten 2 vjecare, dhe mungesa e konkurrencës efektive ne nje treg perkates te justifikueshem per nderhyrje ex-ante eshte e barazvlefshme me ekzistencen e fuqise se ndjeshme ne treg, prej nje ose me shume sipermarresish.

Ekzistenca e FNT do te thote qe ne treg ka probleme te cilat identifikohen dhe ne baze te problemeve te evidentuara, propozohet marrja masave rregulluese apo detyrimeve per tu zbatuar nga sipermarresi/sipermarresit me FNT. AKEP ne baze te nenit 34, ka detyrimin qe ne rast te gjetjes se FNT ne nje treg perkates te vendose nje disa apo te gjitha detyrimet e cilesuara ne nenet 39-45 dhe neni 56 te Ligjit. Vendosja e detyrimeve/masave rregulluese per FNT duhet te marre ne konsiderate objektivat rregullatore te percaktuar ne Ligj.

Nese nga analiza arrihet ne perfundimin se tregu perkates eshte ne konkurrenca efektive, pra nuk ka FNT, atehere AKEP nuk vendos detyrime dhe ne rast se ndaj sipermarresve jane vendosur detyrime (per shkak te statusit te meparshem me FNT) atehere AKEP i heq keto detyrime duke percaktuar dhe nje afat kohor jo me te gjate se 6 muaj per berjen efektive te tyre. Ky percaktim aplikohet edhe per tregjet e analizuara, por qe nuk permbushin testin e tre kriterëve per nevojën per nderhyrje ex-ante.

---

<sup>7</sup> 'an undertaking shall be deemed to have significant market power if, either individually or jointly with others, it enjoys a position equivalent to dominance, that is to say a position of economic strength affording it the power to behave to an appreciable extent independently of competitors customers and ultimately consumers''

## II.3 Procesi i këshillimit publik dhe konsolidimi i tregut celular

AKEP me vendimin Nr.2699, datë 1.12.2016, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit *“Analizë e tregut të shërbimeve celulare: Tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare – Këshillim Publik”* dhe me Vendimin nr. 2700, datë 22.12.2016, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit *“Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – Këshillim Publik”*.

Dokumenti *“Analizë e tregut të shërbimeve celulare: Tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare – Këshillim Publik”* përmbante analizën e tregut përkatës me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare dhe propozimet e AKEP për operatorët me FNT dhe masat rregulluese për FNT për katër operatorët celularë. Ky dokument përmbante dhe një analizë të detajuar të tregut me pakicë celular duke evidentuar ecurinë e tij në vitet e fundit në lidhje me numrin e pajtimtarëve të shërbimeve celulare, përfitimet e tyre nga përdorimi i këtyre shërbimeve, tarifat dhe probleme të evidentuara në lidhje me tarifat celulare me pakicë, tregues financiarë të kompanive celulare dhe strukturë/pjessët e tregut etj., si dhe pritshmëritë e AKEP për ecurinë e tregut me pakicë të shërbimeve celulare në vitet e ardhme. Ndërsa dokumenti *“Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – Këshillim Publik”*, përmbante propozimet e AKEP për metodën e rregullimit të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetet e katër operatorëve celularë Telekom Albania, Vodafone Albania, Albtelecom dhe Plus Communication, të cilët sipas dokumentit të Analizës së tregut të nxjerrë në këshillim publik propozoheshin si sipërmarrës me FNT për terminimin e thirrjeve në rrjetet individuale të tyre, duke përfshirë dhe propozimin për vendosjen e masës rregulluese të kontrollit dhe rregullimit të tarifave me shumicë të terminimit nga AKEP.

Këshillimi publik për të dy dokumentat perfundonte me 7.02.2017 dhe kjo perudhë u zgjat pas pranimit të kërkesës së Vodafone Albania për shtyrje të procesit për shkak të negociatave midis operatorëve celularë për transferimin e radio-frekuencave të operatorit Plus Communication, cka pritej të sillte dhe një ndryshim në strukturën e tregut celular si dhe në qëndrimet e operatorëve celularë për dokumentat e nxjerrë në këshillim publik nga AKEP.

Procesi i transferimit të frekuencave të sipërmarrësit Plus Communication përfundoi me miratimin nga AKEP dhe Autoriteti i Konkurrencës (AK) të kërkesës së këtij sipërmarrësi dhe sipërmarrsve të tjerë të përfshirë në proces.

AKEP miratoi këtë proces me Vendimet e mëposhtëme:

- Vendim Nr.20, datë 13.11.2017 Për “Dhënien paraprakisht të miratimit për transferimin e të drejtave të përdorimit të frekuencave të sipërmarrësit Plus Communications Sh.a., tek sipërmarrësit Telekom Albania Sh.a., dhe Vodafone Albania Sh.a.”
- Vendim Nr.21, datë 01.12.2017 Mbi “Dhënien e Autorizimeve individuale, rrjedhojë e përfundimit të procedurës së miratimit paraprak të transferimit të të drejtave të përdorimit të frekuencave të sipërmarrësit Plus Communication Sh.a tek Sipërmarrësi Vodafone Albania Sh.a.”
- Vendim Nr.22, datë 01.12.2017 Mbi “Dhënien e Autorizimeve individuale, rrjedhojë e përfundimit të procedurës së miratimit paraprak të transferimit të të drejtave të përdorimit të frekuencave të sipërmarrësit Plus Communication Sh.a tek Sipërmarrësi Telekom Albania Sh.a.”

AK miratoi transaksionet me vendimet e mëposhtme:

- Vendim Nr. 484, Datë 23.11.2017 Për “Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet transferimit të ½ të spektrit të ndërmarrjes Plus Communication Sha tek Vodafone Albania Sha ”
- Vendim Nr. 485, Datë 23.11.2017 Për “Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet transferimit të ½ të spektrit të ndërmarrjes Plus Communication Sha tek Telekom Albania Sha”

Transaksionet e mësipërme përfshinë transferimin e të drejtave të përdorimit të frekuencave që dispononte sipas autorizimeve individuale përkatëse sipërmarrësi Plus Communication sh.a në brezat 900/1800/1900/2100 MHz tek sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a dhe Telekom Albania sh.a. Plus transferoi të gjithë spektrin e frekuencave në brezat e cituar në mënyrë të barabartë tek dy operatorët e tjerë celularë, Vodafone Albania dhe Telekom Albania, dhe ky transferim u reflektua në autorizimet individuale të këtyre operatorëve për radiofrekuenca sipas vendimeve të mësipërme të AKEP. Pjesë e këtij procesi ishte edhe Altelecom, i cili megjithëse nuk përfitoi frekuenca nga transferimi, shprehu dakortësinë për procesin si dhe për marrvëshjet që palët nënshkruan për pagesat për tarifën e terminimit të aplikueshme në rrjetin Plus nga data 1.04.2015 e në vijim dhe zgjidhjen me dakortësi të proceseve gjyqësore midis Plus dhe tre operatorëve të tjerë celularë.

Në bazë të vendimeve të AKEP, transferimi i radiofrekuencave u bë efektiv më datën 1.01.2018, dhe prej kësaj date Plus Communication nuk ofron më shërbime rrjeti celular. Gjatë muajit Dhjetor 2017, pajtimtarët e rrjetit Plus që zotëronin numër celularë me kod 067, 068 dhe 069 mund të kryenin portim të numrit në një prej operatorëve të tjerë celularë sipas preferencës së tyre, ndërsa nga data 1.01.2018 këta numra i kaluan operatorëve dhënësit fillestar apo që zotërojnë kodet përkatëse, Altelecom, Telekom Albania dhe Vodafone Albania përkatësisht. Ndërkohë për shkak të mos-gjetjes së zgjidhjes teknike dhe komerciale, të gjithë numrat me kod 066 kaluan në administrimin e AKEP, si burime të fundme natyrore, duke filluar nga data 1.01.2018.

Marrvëshjet për transferim frekuencash midis tre operatorëve (nga Plus Communication tek Vodafone Albania dhe Telekom Albania), pas miratimit nga AKEP të kërkesave të operatorëve përkatës për transferim të frekuencave dhe autorizimit nga AK të përqendrimit të realizuar nga transferimi, çuan në ndryshim të strukturës së tregut nga data 1.01.2018, apo konsolidim të tregut nga 4 në 3 operatorë celularë.

Pra nga data 1.01.2018 në Shqipëri ofrojnë rrjete dhe shërbime celularë 3 sipërmarrës: Telekom Albania, Vodafone Albania dhe Altelecom. Ky ndryshim strukture tregu con në ndryshime të pritshmërive të AKEP për ecurinë dhe konkurrencën në tregun me pakicë dhe sic kanë cituar edhe vet operatorët celularë në qëndrimet e tyre për dokumentin e analizës së tregut të publikuar nga AKEP në Dhjetor 2016.

AKEP me shkresën nr.2285 prot., datë 16.12.2017 i kërkoi operatorëve celularë Telekom Albania, Vodafone Albania dhe Altelecom që në vijim të përfundimit të procesit të konsolidimit të tregut celular, brenda datës 15.01.2018, të depozitojnë komentet finale në lidhje me dokumentat “*Analizë e tregut të shërbimeve celularë: Tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale*”

celulare – Këshillim Publik”<sup>8</sup> dhe “Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – Këshillim Publik”<sup>9</sup>, të nxjerrë në këshillim publik në Dhjetor 2016.

Gjithashtu AKEP në vijim prioritetit strategjik nr.2.3 dhe veprimeve specifike 17 dhe 18 të dokumentit “Strategjia dhe Plani i Veprimit të AKEP për vitin 2018”, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.29, datë 29.12.2017, me shkresën Nr. 69 Prot., datë 09.01.2018, u kërkoi tre operatorëve celularë dhe Albtelecom (fiks) informacion në lidhje me terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetet celulare/fikse. Megjithëse terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare është de-rregulluar prej vitit 2012, AKEP gjykon të rëndësishme që të vlerësojë impaktin e sjelljes së operatorëve celularë për këtë shërbim në tregun me pakicë celular dhe masat rregulluese për terminimin e thirrjeve në rrjetet celulare, që janë objekt i këtij dokumenti. Informacioni i marrë prej operatorëve për këtë kërkesë të AKEP është përfshirë në këtë dokument në një seksion të vecantë, duke ruajtur njëkohësisht konfidencialitetin e të dhënave që konsiderohen se përbëjnë sekret tregtar për palët.

Komentet e të gjitha palëve të interesuara për dokumentin e nxjerrë në këshillim publik dhe qëndrimi i AKEP për komentet janë përfshirë në Aneks 1 të këtij dokumenti.

## II.4 Ofruesit e rrjeteve/shërbimeve dhe terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare

Bazuar në Ligjin 9918, sipërmarresit që ofrojnë rrjete dhe shërbimeve celulare janë të regjistruar se pari në Regjistrin e Autorizimeve të Përgjithshme për keto shërbime, dhe në rast të nevojës se përdorimit burimeve të fundme të ralla si frekuenca dhe numeracion për të ofruar keto shërbime, pajisen me autorizim individual për keto burime të fundme, sipas procedurave të ligjore dhe nen-ligjore. Në sektorin e rrjeteve dhe shërbimeve celulare deri më 31.12.2017 ushtronin veprimtarinë e tyre si ofrues të shërbimeve/rrjeteve celulare katër sipërmarrës:

- Telekom Albania sh.a (me pare Albanian Mobile Communications sh.a)
- Vodafone Albania sh.a
- Albtelecom sh.a
- Plus Communication sh.a

Në vijim të tranzaksioneve midis operatorëve celularë për transferim të frekuencave nga sipërmarrsi Plus Communications tek Vodafone Albania dhe Telekom Albania, dhe miratimin e tyre nga AKEP dhe AK, duke filluar nga data 1.01.2018 në treg ofrojnë shërbime/rrjete celulare tre sipërmarrës:

- Telekom Albania sh.a

---

<sup>8</sup> Miratuar me Vendimin Nr.2699, datë 1.12.2016, për “Miratimin për Këshillim Publik të Dokumentit: Analizë e tregut të shërbimeve celulare: Tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare – Këshillim Publik”

<sup>9</sup> Vendim nr. 2700, datë 22. 12. 2016 për “Miratimin për Këshillim Publik të Dokumentit: Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – Këshillim Publik”

- Vodafone Albania sh.a
- Albtelecom sh.a

Operatori Albanian Mobile Communications (AMC) është licensuar si operator publik kombëtar i telefonise celulare ne vitin 1996 dhe ka funksionuar si kompani shtetërore deri ne Shtator te vitit 2000, kur u krye privatizimi i 85 per qind te aksioneve<sup>10</sup>, pjese e cila u ble nga Cosmote Group<sup>11</sup>, operatori celular ne Greqi, e cila eshte vete pjese e grupit OTE, operatorit incumbent në Greqi. Ministria e Ekonomise Tregtise dhe Energjetikes zoteroi rreth 12.6% të aksioneve të Telekom Albania Sh.a, deri ne vitin 2008, kur u krye dhe shitja e kesaj pjese Cosmote Group. Afersisht 2.4% te aksioneve zoteroheshin nga aksionere te vegjel (punonjes te AMC ne kohen e privatizimit) te cilat me pas jane blere nga Cosmote Group. Deutsche Telekom është aksioneri më i madhe i OTE. Në Korrik 2015, Albanian Mobile Communications ndryshoi emrin në Telekom Albania.

Operatori Vodafone Albania është licensuar si operatori i dytë kombëtar i shërbimit celular në Shqipëri më 9 Qershor 2001. Aksioneret e Vodafone Albania jane Vodafone Europe B.V<sup>12</sup>. dhe Vodafone Panafon International Holding B.V, te cilët zoterojne secili 50 për qind te aksioneve. Në 3 Gusht 2001 Vodafone Albania filloi ofrimin e shërbimeve të saj GSM në Shqipëri.

Operatori Albtelecom është licensuar si operatori i trete kombëtar i shërbimit celular ne Shqipëri me 1 Mars 2004. Licensa i eshte dhene Albtelecom si pjese e paketes se privatizimit te kësaj kompanie, proces i cili perfundoi ne vitin 2007. Operatori Eagle Mobile filloi ofrimin e shërbimeve celulare ne Mars 2008 nën emrin . Eagle Mobile sh.a ka funksionuar si kompani me vehte me 100% pronesi te Albtelecom sh.a deri me 31.01.2013, duke u perthithur me pas nga Albtelecom sh.a.<sup>13</sup> Pas bashkimit te dy kompanive Albtelecom ofron shërbime te rrjetit fiks dhe celular. Albtelecom sh.a ka si aksioner kryesor Cetel Telekom Iletisim Sanayi Ve Ticaret<sup>14</sup> me 76% të aksioneve.

Operatori Plus Communication (me pare Mobile 4 Al) ishte operatori i katërt celular, të cilit i'u akordua autorizimi individual nga AKEP me date 26.06.2009, për përdorim të frekuencave në brezat 900/ dhe 1800 MHz. Autorizimi individual iu dha konsorciumit të perfaqesuar nga Poste Telekomunikacioni i Kosoves (PTK) në bazë të Ligjit nr.10118, date 23.04.2009 “Për dhënien e së drejtës së përdorimit, për 15 vjet, në brezin e frekuencave E-GSM dhe GSM 1800, bashkimit të ofertuesve, përfaqesuar nga Postë Telekomunikacioni i Kosovës Sh.a., sipas procedurës “Tender i hapur ndërkombëtar”, i datës 20.02.2009”. Plus Communication filloi ofrimin e shërbimeve te telefonise se levizshme ne fund te muajit Nentor 2010 dhe ishte aktiv në treg deri më 31.12.2017.

Licensat/autorizimet fillestare te operatoreve te rrjeteve celulare kane qene per perdorim te brezave 900 dhe 1800 MHz dhe ofrim te shërbimeve celulare ne standardin GSM me afat 15 vjet nga dhenia e tyre. Prej vitit 2010 AKEP ka kryer nje numer te konsiderueshem procedurash

<sup>10</sup> Kontrata e shitjes se aksioneve te Telekom Albania, eshte ratifikuar ne Kuvendin e Republikes se Shqiperise me Ligjin nr. 8660, date 18.09.2000.

<sup>11</sup> Cosmote Mobile Telecommunications S.A. zoteron 99.76 % të Telekom Albania, sipas informacionit te marre në në [ëëë.qkr.gov.al](http://ëëë.qkr.gov.al) në datën 13/07/2016

<sup>12</sup> Sipas informacionit te marrë në [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al) në datën 13/07/2016

<sup>13</sup>Perthithja e Eagle Mobile sh.a nga Albtelecom sh.a.sipas legjislacionit ne fuqi eshte miratuar paraprakisht nga Autoriteti i Konkurrences dhe AKEP me VKD nr. .2270, datë 13.02.2013, ka miratuar kalimin e të gjitha te drejtave dhe detyrimeve të caktuara me pare Eagle Mobile sh.a. tek sipermarresi Albtelecom sh.a.

<sup>14</sup> Sipas informacionit te marrë në [ëëë.qkr.gov.al](http://ëëë.qkr.gov.al) në datën 13/07/2016

konkurruese<sup>15</sup> për të alokuar sasi spektri edhe në brezat 1900/2100 MHz (për përdorim të frekuencave sipas standardit UMTS-shërbime 3G) dhe 2500/2600 MHz (për përdorim të frekuencave sipas standardit LTE-4G). Në vitin 2015 AKEP finalizoi procesin e heqjes së kufizimeve teknologjike në përdorimin e brezave të frekuencave të operatorëve të rrjeteve celulare, duke mundësuar përdorimin e të gjithë spektrit në dispozicion të operatorëve celulare për shërbime të gjeneratës së katërt (4G) apo standardi LTE. E drejta e përdorimit të spektrit pa kufizim teknologjik dhe shfrytëzimi i spektrit pa kufizime filloi nga data 01.09.2015. Shërbimet bazuar në standardet GSM (2G) dhe UMTS (3G) ofrohen nga të katër operatorët, ndërsa në standardin LTE (4G), ofrohen nga Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom (Eagle Mobile).

Më mbarimin e afatëve të autorizimeve individuale për brezat 900/1800 MHz të Telekom Albania dhe Vodafone Albania të leshuara si licenca në vitet 2000 dhe 2001, AKEP në vitet 2015 dhe 2016, pas procedurave përkatëse ligjore, miratoi rinovimin e këtyre Autorizimeve Individuale për një kohëzgjatje tjetër prej 15 vitesh.

---

<sup>15</sup> Procedurat janë kryer sipas akteve ligjore dhe nen-ligjore në fuqi, dhe ato kanë qenë konkurruese dhe të gjithë operatorët celulare kanë pasur të drejtë pjesëmarrjeje. Në disa procedura janë përjashtuar nga pjesëmarrja operatorët që kanë pasur tashmë të drejtë përdorimi në brezin e alokuar dhe/ose operatori që nuk ka pasur të drejtë më parë ka pasur përparësi në fitimin e të drejtës.

# III. Zhvillimet e tregut dhe impakti i masave rregulluese të Analizës së tregut 2014

---

Dokumenti i Analizës së tregut celular i nxjerrë në këshillim publik përmbante një panoramë të tregut celular dhe zhvillimeve të tij në terma të ofruesve, perdoruesve të shërbimeve celulare dhe përfitimeve të tyre për përdorimin dhe tarifën, konkurrencën në treg etj. Analiza përmbante edhe krahasim të disa treguesve kryesorë të tregut në Shqipëri me vende të tjera, BE dhe rajon. Analiza e tregut me pakicë u fokusua gjithashtu në impaktin që kanë pasur masat rregullatore për terminimin e thirrjeve të vendosura nga analiza e fundit në tregun me pakicë celular. Në kapitullin V, të Analizës së tregut të nxjerrë në këshillim publik AKEP paraqiste edhe konkluzionet e analizës së tregut me pakicë dhe pritshmeritë për këto treg në vitet në vijim në presence të masave rregulluese të propozuara për tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare (Kapitulli IV).

Sic është cituar në pjesën e Hyrjes së këtij dokumenti, gjatë kësaj periudhe, nga koha e nxjerrjes në këshillim publik të dokumentit të Analizës së tregut (Dhjetor 2016) dhe miratimit të këtij versioni final (Janar 2018), me daljen nga tregu të Plus Communication nga data 1.01.2018, tregu ka përjetuar një ndryshim të rëndësishëm strukturor, i cili ka ndikim në pritshmëritë e AKEP për ecurinë e tregut me pakicë celular në të ardhmen.

AKEP gjykon se për të vlerësuar më mirë efektet e daljes nga tregu të Plus në strukturën e tregut me pakicë celular si dhe në të gjitha tregjet e tjera përkatës të justifikueshme për ndërhyrje ex-ante, duhet të kryhet një analizë të vecantë tregu. Për këtë AKEP do të kryejë një proces tjetër këshillimi publik në muajt në vijim për këto tregje të tjera. Për këtë arsye, analiza së tregut me pakicë të nxjerrë në këshillim publik, përfshirë arsyet për mos-aplikim të testit të 3 kriterëve në dokumentin e nxjerrë në këshillim publik në Dhjetor 2016, nuk janë përfshirë në këtë dokument final, pasi do jenë pjesë e dokumentit tjetër të vecantë të analizës së tregut me pakicë, dhe tregjeve të tjera me shumicë që mund të konsiderohen të justifikueshme për ndërhyrje ex-ante, pas ndryshimeve të strukturës së tregut celular dhe rekomandimeve të AK, që do të fillojë së shpejti nga AKEP sipas procedurave përkatëse në Ligjin 9918 dhe Rregulloren e Analizës së tregut, duke marrë në konsideratë gjithashtu (sipas Ligjit 9918) të gjitha rekomandimet e KE dhe BEREC.



### III.1 Analiza e tregut celular 2014

AKEP bazuar në Ligjin 9918 (nenet 31 e në vijim, të Kreut VI mbi Rregullimin e konkurrencës), Rregulloren për Analizën e Tregut<sup>16</sup>, gjatë vitit 2014 kreu procedurën e analizës së tregut celular, në përfundim të së cilës u miratuan vendimet e mëposhtëme:

1. Vendimi nr. 2522, datë 06.11.2014, për *“Miratimin e Dokumentit: Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe tregu me pakice të shërbimeve publike në rrjetet e telefonisë së sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Vodafone Albania dhe vendosjen e masave rregulluese”*
2. Vendimi nr. 2524, datë 06.11.2014 për *“Përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Vodafone Albania dhe vendosjen e masave rregulluese”*
3. Vendimi nr. 2524, datë 06.11.2014 për *“Përcaktimin e sipërmarrësit Plus Communication Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Plus Communication dhe vendosjen e masave rregulluese”*
4. Vendimi nr. 2525, datë 06.11.2014 për *“Përcaktimin e sipërmarrësit Albanian Mobile Communications<sup>17</sup> Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Albanian Mobile Communications dhe vendosjen e masave rregulluese”*
5. Vendimi nr. 2526, datë 06.11.2014 për *“Përcaktimin e sipërmarrësit Altelecom Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Altelecom dhe vendosjen e masave rregulluese”*

Në vijim të ankimeve administrative, AKEP me Vendimet 2542-2546, datë 13.03.2015 në bazë të trajtuimit të ankimeve administrative kreu disa ndryshime në vendimet e mesipërme. Ne lidhje me detyrimet për FNT, AKEP vendosi që të katër operatorët të vazhdojnë të kenë detyrimet e percaktuara në ligjin 9918:

- Mosdiskriminimi (neni 39),
- Transparenca (neni 40),
- Dhenie Akses dhe Interkoneksion dhe përdorimi i perbashkët i faciliteteve të rrjetit (neni 42),
- Kontrolli i tarifave dhe sistemi i mbajtjes së llogarive (neni 45)

Bazuar në rekomandimet e AK nepermjet Vendimit nr.303, datë 16.01.2014, si dhe problematiken e evidentuar të diskriminimit të tarifave të thirrjeve on-net/off-net, AKEP në analize 2014 i kushtoi vëmendje të vecante ndikimit të këtij fenomeni në konkurrencën afat-gjate në tregun celular duke vendosur masa shtese rregulluese në lidhje me detyrimin e mos-diskriminimit. AKEP vendosi nder të tjera që secili sipërmarrës rrjeti celular ndalohet të aplikojë tarifa në nivel me pakicë që kanë efekt diskriminues për sipërmarrësit e rrjeteve të tjera celulare kombëtare:

- 1) *tarifat e thirrjeve drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare nuk duhet të jenë më të larta se tarifat e thirrjeve brenda rrjetit;*
- 2) *Sasia e minutave brenda rrjetit të përfshira në oferta/pagesë fikse të paketave tarifore nuk duhet të jetë më e madhe se sasia e minutave drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare;*

<sup>16</sup>“Rregullore për Analizën e Tregut” miratuar me Vendimin nr. 747, datë 17.07.2009, të Keshillit Drejtues të AKEP, ndryshuar me VKD nr.2342, datë 31.07.2013.

<sup>17</sup> Sot Telekom Albania sh.a.

3) *Përcaktimet e pikave 1 dhe 2 më sipër aplikohen për të gjitha paketat tarifore standarte, ofertat, shportat, opsionet dhe skontot të ofruara për pajtimtarët;*

Siaps vendimeve 2522-2526, datë 6.11.2014, të ndryshuara, afatet e fillimit të zbatimit të detyrimeve për mos-diskriminimin në tarifatat e thirrjeve on-net/off-net, ishin:

- *data 1.07.2015: për programet tarifore, ofertat, opsionet etj., për përdoruesit me parapagim dhe përdoruesit e rinj me kontratë, përfshirë rinovimet e kontratave ekzistuese që kryhen pas kësaj date,*
- *data 1.01.2016: për të gjitha programet e tjera tarifore të aplikuara për përdoruesit aktualë me kontratë (kontrata me programe tarifore standarde dhe të personalizuar/specifike).*

### **Proceset gjyqesore**

Sipërmarresi Plus Communication sh.a ankimoi ne rruge gjyqesore Vendimin nr.2542, date 13.03.2015 duke kerkuar shfuqizimin e ndryshimeve te kryera nepermjet ketij vendimeve per tarifen e terminimit te thirrjeve ne rrjetin Plus dhe afatin e fillimit te aplikimit te detyrimit te mos-diskriminimit ne tarifatat e thirrjeve on-net dhe off-net.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr.1567 datë 1.04.2016 ka pranuar kërkesë padine e Plus Communication. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me Vendimin Nr.2459 datë 9.09.2016, ka lene ne fuqi vendimin të Gjykates Administrative të Shkallës së Parë, Tirane.

AKEP ka depozituar në Gjykatën e Lartë recurs në lidhje me Vendimin Nr.2459 datë 9.09.2016 të Gjykatës Administrative e Apelit Tiranë dhe është në pritje të sqarimeve nga Gjykata e Lartë.

Vodafone, Telekom Albania dhe Alblecom ankimuan Vendimin 2664/2016 dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr.80-2016-4342, datë 26.09.2016, pranoi kerkese padine e tre operatoreve. AKEP ka apeluar kete vendim ne Gjykatën Administrative te Apelit Tiranë dhe eshte ne pritje te vendimit te kesaj gjykate.

Plus Communication ankimoi ne rruge gjyqesore Vendimin 2676/2016 dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. 80-2016-5079, datë 31/10/2016, pranoi kerkese padine e Plus. AKEP ka apeluar kete vendim ne Gjykatën Administrative te Apelit Tiranë dhe eshte ne pritje te vendimit te kesaj gjykate.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr. 09678-80-2016 datë 18.01.2017, me objekt “Sqarim dhe interpretim Vendimi”, ka bërë sqarimin në lidhje me vendimin e saj të datës 31.10.2016, se bazuar në vendimet e mëparshme të gjykatës adminsitrativ (datë 1.04.2016 dhe 9.09.2016), tarifa e terminimit e aplikueshme për Plus nga data 1.04.2015 është 6.52 lek/minutë.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, më datë 5.10.2017, me Vendimin Nr. 00 - 2017 – 1841, vendosi mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala e paditur Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP); rekursit të paraqitur nga Avokatura e Shtetit; rekursit të paraqitur nga personi i tretë shoqëria “Vodafone Albania”; rekursit të paraqitur nga personi i tretë shoqëria “Alblecom” sh.a dhe rekursit të paraqitur nga personi i tretë shoqëria “Telekom Albania” sh.a, kundër vendimit nr. 2459, datë 09.09.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Duke qënë në kushtet kur:

- Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Tirane me vendimin Nr. 1567, date 01.04.2016 ka vendosur lënien në fuqi fuqi të tarifës së terminimit të PLUS ne nivelin 6.52 deri ne Analizen e radhes se tregut celular (vendim i lënë në fuqi edhe nga Gjykata Administrative e Apelit),
- AKEP nuk gëzon të drejtën për interpretim të vendimeve të gjyqesorit,

dhe në vijim edhe të marrevshjeve midis vetë operatorëve celularë, në seksionet e mëposhtme si tarifë terminimi në rrjetin Plus Communication në periudhën 1.04.2015-31.12.2017 është dhënë vlera 6.52 lek/minutë.

## III.2 Ndryshmet ne tarifat celulare me pakicë on-net dhe off-net

Ky seksion përmban një përshkrim/vlerësim të shkurtër të tarifave me pakicë celulare, duke u fokusuar në treguesin e ARPM/ARPU dhe zbatimin e detyrimeve të mos-diskriminimit në tarifat e thirrjeve on-net dhe off-net. Një vlerësim më i detajuar i tarifave me pakicë do të kryhet nga AKEP në analizën e tregut celular me pakicë që do të publikohet së shpejti sipas sqarimeve të dhëna në hyrje të këtij kapitulli.

Operatorët celularë ofrojnë një sërë shërbimesh dhe paketash tarifore dhe shpesh është e vështirë krahasimi i tarifave për shërbime të vecanta dhe/ose për njësi për shkak të rritjes së përdorimit të shportave (bundles) me një shërbime ose me shumë shërbime (paketa të integruara). Si edhe në dokumentat e tjera të AKEP, ecuria e tarifave me pakicë të tregut celular analizohet në dy drejtime kryesore:

- Te ardhura mesatare për minutë/përdorues (ARPM/ARPU);
- Tarifat nominale me pakicë të operatorëve.

Në seksionet në vijim AKEP ka analizuar fillimisht ecurinë e treguesve të ARPM dhe ARPU, dhe me pas të tarifave nominale të operatorëve celularë duke u fokusuar në ndryshimet e kryera nga operatorët celularë në zbatim të detyrimeve të mos-diskriminimit në tarifat e thirrjeve on-net dhe off-net, tarifat e shërbimeve të aksesit broadband, krahasime të tarifave të segmenteve të parapagim dhe paspagim dhe tarifat për njësi komunikimi.

### **ARPM dhe ARPU**

Treguesit e ARPU (Average Revenue Per User) dhe ARPM (Average revenue Per Minute) masin të ardhurat mesatare të operatorëve për përdorues dhe për minutë, por që njëkohësisht mund të interpretohen si shpenzime mesatare të përdoruesve celularë, dhe për këto arsye përdoren edhe si tregues agregatë të ecurisë së tarifave të shërbimeve celulare. Në prezencë të përdorimit të lartë të paketave/ofertave dhe shportave të integruara të shërbimeve me sasi të mëdha shërbimesh të përsfihura në pagesat fikse, për përdorues me parapagim dhe me kontratë, ARPM dhe ARPU janë tregues të mirë të tarifave dhe shpenzimeve mesatare efektive që paguajnë realisht përdoruesit celularë.

ARPM<sup>18</sup> apo e ardhura mesatare për minutë matet si raporti i të ardhurave nga shërbimet me pakicë me numrin mesatar të përdoruesve gjatë periudhës përkatëse dhe përdoret si përafrues i cmimit që

---

<sup>18</sup> Treguesi i ARPM llogaritet nga AKEP në baze të të dhënave që dergojnë operatorët për të ardhurat dhe thirrjet telefonike. Për shkak të ofertave/shportave që kanë një pagesë fikse dhe përfshijnë përveç thirrjeve edhe SMS dhe kapacitet Internet, vlerat e këtij treguesi mund të mos pasqyrojnë saktë të ardhurën mesatare retail për një minutë

një përdorues celular paguan mesatarisht për një minutë thirrje telefonike. ARPU e matur si raporti i të ardhurave nga shërbimet me pakicë të operatorëve me numrin mesatar të përdoruesve (aktive) gjatë një viti dhe tregon sa lek shpenzon mesatarisht një përdorues celular për shërbime celulare në vit apo në muaj. Vlerat e këtyre treguesve për periudhën 2010-2016 janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

TABELA III.1: ECURIA E ARPM DHE ARPU 2010-2016

|      | ARPM<br>(Lek/minute) | ARPU<br>(Lek/vit) | ARPM<br>Ndryshimi<br>vjetor (%) | ARPU Ndryshimi<br>Vjetor (%) |
|------|----------------------|-------------------|---------------------------------|------------------------------|
| 2010 | 6.49                 | 8,594             |                                 |                              |
| 2011 | 5.35                 | 8,319             | -18%                            | -3%                          |
| 2012 | 3.92                 | 7,132             | -27%                            | -14%                         |
| 2013 | 3.13                 | 5,863             | -20%                            | -18%                         |
| 2014 | 2.63                 | 5,447             | -16%                            | -7%                          |
| 2015 | 2.36                 | 5,125             | -10%                            | -6%                          |
| 2016 | 2.53                 | 5,037             | 7%                              | -2%                          |

*Shënim: Vlerat pa TVSH*

Nga tabela vihet re se ARPM dhe ARPU kanë tendencë rënëse dhe për vitin 2015 vlerat e tyre janë reduktuar me 10% dhe 6% respektivisht. Në vitin 2016 është vënë re një rritje e ARPM me 7% dhe një rënie e ARPU me 2%. Në vitin 2016 një përdorues celular ka paguar mesatarisht 3.04 lek/minutë (me TVSH) për thirrjet telefonike dhe ka shpenzuar mesatarisht 504 lek/muaj (me TVSH) për shërbime celulare.


Vodafone ka përdoruesit me ARPU me të madhe (sipas të ardhurave me pakicë dhe të ardhurave totale), ndërsa Plus ka qenë operatori me ARPU me të ulët.

Niveli i këtyre treguesve në Shqipëri është shumë më i ulët se niveli mesatar në vendet e BE dhe ndër më të ulët në rajon. ARPU në vitin 2015 në Shqipëri ishte 36.6 euro/vit, që është 23% më e ulët se Letonia me nivelin më të ulët në BE me 46 euro. Niveli mesatar i ARPU në BE në 2014 ishte 162.2 euro apo rreth 4.4 herë më e lartë se ARPU e Shqipërisë në 2015. ARPM për Shqipërinë ishte në nivelin rreth 1.9 eurocent në 2014 dhe rreth 1.7 eurocent në 2015. Te dhenat me të fundit për ARPM e vendeve të BE janë të disponueshme për vitin 2011 dhe krahasimi tregon se ARPM ka tendencë të ngjashme me ARPU, dhe raporti i ARPM së Shqipërisë me mesataren e BE është i ngjashëm me atë të ARPU.

---

thirrje, megjithatë ai është një tregues i përafërt dhe mund të konsiderohet vlera maksimale kur si të ardhura përdoren të ardhurat totale retail.

FIGURA III.1. ARPU NË VENDET E BE DHE SHQIPËRI (2014/2015)



Burimi: KE, Digital Agenda Scoreboard dhe AKEP

### **Tarifat e thirrjeve on-net/off-net**

Implementimi i masave rregullatore të percaktuara nga AKEP në Vendimet e Nentor 2014/Mars 2015 si dhe në udhëzimet përkatëse të Qershor 2015 për mos diskriminim të tarifave on-net/off-net u krye në dy faza:

- Faza e parë, u aplikua për programet tarifore/ofertat/opsionet për përdoruesit me parapagim dhe përdoruesit e rinj me kontratë, përfshirë rinovimet e kontratave ekzistuese që u kryen pas datës 1 Korrik 2015;
- Faza e dytë filloi me 1.01.2016, duke u aplikuar për përdoruesit me kontrata specifike/te personalizuara apo kontrata që kishin afat maturimi përtej datës 1.01.2016.

Nga monitorimi i vazhdueshëm i publikimit të tarifave në faqet e internetit të operatoreve sipas masave rregulluese dhe rregullores mbi publikimin e informacionit për tarifat e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike rezultoi se:

- Programet tarifore/ofertat/opsionet e katër operatoreve celulare treg nga të katër operatorët me detyrimin e mos-diskriminimit midis tarifave të thirrjeve off-net dhe on-net;
- Në faqet e tyre të internetit u publikuan programet tarifore, ofertat, opsionet etj., për përdoruesit me parapagim dhe përdoruesit me kontratë, sipas detyrimit të sipërpermendur;
- Të gjitha produktet që nuk plotësonin detyrimin duke filluar nga data 01.07.2015 u hoqën nga tregu.


Nepërmjet këtij detyrimi u thjeshtua informacioni për pajtimtarët në lidhje me përmbajtjen e programeve/ofertave/opsioneve dhe mundësia për të krahasuar këto të fundit midis operatoreve dhe midis njera-tjetres. U ul numri i ofertave sezonale, i cili në Qershor 2014 shkoi në 13-20 për operator, duke kaluar në paketa standarte. Njësitë e komunikimit të përfshira në pagesa fikse u konvertuan nga minuta brenda rrjetit, në minuta kombetare ose në sasi të barabarta mintash brenda dhe jashtë rrjetit celular, duke mos prekur interesin e konsumatorit madje duke rritur përfitimet e tyre.

### III.3 Ndryshimet në nivelin dhe strukturën e thirrjeve

Sasia totale e thirrjeve telefonike të gjeneruara nga përdoruesit celularë gjatë vitit 2016 u reduktua me 8% në krahasim me vitin 2015, ndërkohë numri i mesazheve SMS të dërguara nga përdoruesit celularë rezultoi me një rritje modeste prej 1%. Këto tendenca të shërbimeve tradicionale nga rrjete celulare (thirrje dhe SMS) janë të kundërta me rritjen e ndjeshme të përdorimit të aksesit broadband nga rrjete celulare. Trendi rënies së nivelit dhe/ose ritmeve të rritjes së përdorimit të thirrjeve dhe SMS-ve dhe trendi rritës i aksesit broadband celular në 2-3 vitet e fundit janë tregues të efektit të zëvendësimit të thirrjeve telefonike/mesazheve SMS me thirrje/mesazhe nga aplikacionet OTT (Over The Top) në Internet në aparat celular.

Trafiku total i thirrjeve telefonike i gjeneruar nga pajtimtarët e rrjeteve celulare në Shqipëri gjatë vitit 2016 arriti në rreth 6.8 miliard minuta, e cila përbën një rënie me 8 % në krahasim me vitin 2015. Normat e ndryshimit sipas destinacionit të thirrjeve kanë variacion të madh midis tyre. Thirrjet brenda rrjetit u reduktuan me 20% ndërsa thirrjet drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare u rritën me 83%. Thirrjet drejt rrjeteve fikse kombëtare u rritën me 22% ndërsa thirrjet drejt rrjeteve ndërkombëtare (fikse dhe celulare) u reduktuan ndjeshëm me 82%. Këto trende të ndryshme të nivelit të thirrjeve sipas destinacionit çuan në ndryshime në strukturën e trafikut siç paraqitet në figurën e mëposhtme.

FIGURA III.2: STRUKTURA E THIRRJEVE DALESE CELULARE SIPAS DESTINACIONIT



Pesha e thirrjeve brenda rrjetit ndaj totalit të thirrjeve dalëse në vitin 2016 u reduktua në 60% nga 69% në 2015 (84% në 2014), ndërsa pesha e thirrjeve off-net u dyfishua duke arritur në 37% krahasuar me 18% në 2015 (8% në 2014). Reduktimi i ndjeshëm i thirrjeve ndërkombëtare çoi në reduktim edhe të peshës së këtyre thirrjeve në 2% nga 11% në vitin 2015.

Rënia e madhe e trafikut të thirrjeve dalëse ndërkombëtare në vitin 2016 ka ardhur pas rritjeve të ndjeshme të këtyre thirrjeve në vitet 2014-2015. Këto luhatje shpjegohen me ndryshimet ofertat/paketat e operatorëve celularë për thirrjet ndërkombëtare gjatë kësaj periudhe për shkak të ndryshimeve në tarifatat e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetet celulare në vendet e BE-se të cilat përbëjnë pjesë të kostove të thirrjeve dalëse ndërkombëtare për operatorët

shqiptarë. Reduktimi i minutave/ofertave për këto thirrje nga operatorët celularë shqiptarë në vitin 2016 ka ardhur për shkak të rritjes së tarifave të terminimit në një sërë vendesh të BE-së për thirrjet ndërkombëtare të origjinuara jashtë vendeve anëtare të BE.

Gjate vitit 2017 sasia totale e thirrjeve të gjeneruara nga rrjetet celulare ishte rreth 6.6 miliard minuta, që përbën një rënie me 3% në krahasim me vitin 2016. Sasia e thirrjeve on-net vijoi me tendencën rënëse me 12% ndërsa thirrjet off-net u rriten me 15%, ndërsa thirrjet ndërkombëtare patën rënie të ndjeshme me 31%.

### **Thirrjet on-net/off-net**

Rritjet e ndjeshme të nivelit dhe peshës së thirrjeve off-net në totalin e thirrjeve celulare në vitet dhe reduktimet në thirrjet on-net në 2015-2017 kanë ndodhur në vijim të zbatimit të detyrimit të operatorëve celularë për mos-diskriminim në tarifën e thirrjeve brenda rrjetit dhe drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare, që filluan të zbatohen në Korrik 2015 (vendimet e Analizës së tregut në Nentor 2014 dhe të ndryshuara në Mars 2015).

Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e strukturës së thirrjeve të përdoruesve celularë sipas destinacionit të thirrjeve në baze mujore në periudhën Janar 2014-Qershor 2017. Nga të dhënat vihet re ndryshimet e mëdha në strukturën e thirrjeve dhe tendencat e rritjes së peshës së thirrjeve off-net (drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare) dhe reduktimit të peshës së thirrjeve brenda rrjetit (on-net). Peshë e thirrjeve off-net (ndaj totalit të thirrjeve celulare) është rritur nga 5% në Janar 2014 në 44% në Qershor 2017. Në të njëjtën periudhë peshë e thirrjeve on-net është reduktuar nga 90% në Janar 2014 në 53% në Qershor 2017.

**FIGURA III.3 STRUKTURA E THIRRJEVE CELULARE (JANAR 2014-QERSHOR 2017)**





Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e trafikut të thirrjeve brenda rrjetit (on-net) dhe drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare (off-net) në periudhën Janar 2014-Qershor 2017. Nga të dhënat mund të vihet re sa sasia e thirrjeve off-net e operatorëve celularë është rritur 8.3 here në Qershor 2017

ne krahasim me Janar 2014: nga rreth 30 milion minuta në muaj në rreth 250 milion minuta në muaj. Në të njëjtën periudhe sasia e thirrjeve on-net është reduktuar ndjeshëm me 45%: nga 520 milion minuta në muaj ne rreth 300 milion minuta në muaj.

FIGURA III.4: ECURIA E SASISË SË TRAFIKUT ON-NET DHE OFF-NET JANAR 2014-QERSHOR 2017



Ndryshimet më të ndjeshme të strukturës së thirrjeve janë vënë re në Korrik 2015 e në vijim, që përkon me afatin e fillimit të aplikimit të detyrimit të mos-diskriminimit në rrjetet e katër operatorëve celularë. Të katër operatorët celularë kanë pasur ndryshime të ndjeshme në strukturën e thirrjeve dalëse të përdoruesve të tyre, të cilat mund të vihen re në tabelën e mëposhtëme.


### III.4 Tregues financiare te kompanive celulare

#### Të ardhurat

Në vitin 2016 të ardhurat nga shërbimet celulare ishin rreth 33.9 miliard lek, që përbën një rritje me 2.4% në krahasim me vitin 2015, ndërsa të ardhurat e Altelecom nga shërbimet e rrjetit fiks patën një reduktim të ndjeshëm me 15% në krahasim me vitin e mëparshëm. Për shërbimet celulare Telekom Albania pati një rënie me 8.4% dhe Altelecom rënie të vogël me 1.1%, ndërsa të ardhurat e Vodafone u rritën me 5.7%. Plus Communication në vitin 2016 shënoi rritje të ndjeshme të të ardhurave totale me 41%, për shkak të rritjes së ndjeshme me 87% të të ardhurave me shumicë, ndërsa pati rënie me 17% të të ardhurave me pakicë. Pas tendences renese ne periudhen 2010-2013 (pervec vitit 2012), ne dy vitet e fundit vihet re nje stabilizim i te ardhurave nga sherbimet celulare.




FIGURA III.5: TE ARDHURAT TOTALE TE OPERATOREVE CELULARE 2004-2016



Shënim: Të ardhurat në milion Lek dhe janë sipas deklarimeve të operatorëve

Të ardhurat nga shërbimet me pakicë (retail) në vitin 2016 u reduktuan me 1.6% në krahasim me një vit më parë. Reduktimi varion nga 2.8% për Telekom Albania, 17.4 % për Plus, ndërsa Vodafone pati rritje më 1.7%. Figura më poshtë paraqet ecurinë e të ardhurave me pakicë për secilin operator në periudhën 2010-2016, ku vihet re tendenca rënëse për të gjithë tregun dhe secilin operator gjatë gjithë periudhës.

FIGURA III.6: TE ARDHURAT NGA SHERBIMET ME PAKICE 2010-2016




Shënim: Të ardhurat janë sipas deklarimeve të operatorëve

Te ardhura nga shërbimet me shumicë të operatorëve celularë në 2015 u rriten me rreth 16% në krahasim me 2014. Operatori Plus pati rritjen më të madhe vjetore me 44%, ndërsa të ardhurat me shumicë të Telekom Albania dhe Vodafone u rriten me më 19% dhe 14% përkatësisht. Të ardhurat

me shumice te Albtelecom nuk pesuan ndryshim te ndjeshem si edhe te ardhurat me pakice. Ne vitin 2016 te ardhurat me shumice u rriten me 7%, ku bie ne sy rritja me 87% e te ardhurave te Plus.

Ne kete rritje te te ardhurave me shumice ne dy vitet fundit ka ndikuar rritja e ndjeshme e trafikut off-net gjate 2015-2016 duke cuar ne rritje te te ardhurave nga terminimi i thirrjeve kombetare, pavaresisht tarifave me te uleta te terminimit te ketyre thirrjeve ne krahasim me vitin 2014. Ne rritjen e ndjeshme te ardhurave me shumice te Plus ka ndikuar kryesisht rritja e të ardhurave nga terminimi i thirrjeve kombetare me 37% ne 2015 dhe 240% ne 2016 (për vitin e fundit për shkak edhe të kontabilizimit të ardhurave të pritshme nga terminimi i thirrjeve kombëtare me tarifën 6.52 lek/minutë sipas vendimeve të sistemit gjyqësor).

FIGURA III.7: TE ARDHURAT NGA SHERBIMET ME SHUMICE 2010-2016




Burimi: Të ardhurat sipas deklarimeve te operatoreve ne formularet perkates

## **Fitimet**

Figura e meposhtme paraqet ecurine e fitimit neto te secilit prej sipermarrrsve te rrjeteve te operatoreve celulare dhe toatlin per te kater sipermarrrsit se bashku, per periudhen 2010-2016

FIGURA III.8: ECURIA E FITIMEVE NETO TE SIPERMARRESVE TE RRJETEVE CELULARE (2010-2015)



Sbenime:

- Fitimi neto i Telekom Albania perfshin te ardhura neto nga interesat qe zene nje peshe te rendesihme ne te ardhurat dhe fitimin e Telekom Albania.
- Fitimi (humbja) neto e Albtelcom per vitet 2014-2015 eshte rezultati neto i te gjithë kompanise (sberbime celulare dhe fikse).


Nga figura mund te vihet re se fitimet neto totale te te kater sipermarresve kane pesuar reduktime te ndjeshme ne vitet 2011, 2013-2015. Ne vitin 2015 rezultati neto total i te kater sipermarresve te komunikimeve elektronike eshte negativ, dhe kjo eshte ndikuar nga renia e ndjeshme e fitimeve te Vodafone dhe Telekom Albania ne 2015 me 84% dhe 78% respektivisht. Plus eshte i vetmi sipermarres qe pati nje ndryshim pozitiv, nga humbje neto prej 1.4 miliard lek ne 2014 ne fitim neto prej 88 milion lek ne 2015. Albtelcom dhe Plus kane rezultate negative neto gjate gjithë periudhes se hyrjes ne treg si operatore celulare (pervec vitit 2015 per Plus), ndersa Vodafone dhe TA kane pasur fitime neto te larta por qe jane reduktuar ndjeshem ne 2014-2015. Renia e ndjeshme e fitimeve te Vodafone dhe TA eshte shoqeruar edhe me renie te normave te fitimit te ketyre dy sipermarresve.

Ne vitin 2016 ka vijuar renia e ndjeshme e fitimeve te Telekom Albania dhe Vodafone Albania, ndersa Albtelcom ka reduktuar me rreth 44% humbjen. Plus pati rritje te ndjeshme te fitimit neto 948 milion lek, por qe vlerësoshet se kjo ka ndodhur edhe për shkak të politikave kontabël të ndjekur nga kompania.

## Investimet

Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e investimeve të katër sipërmarrësve në infrastrukture të rrjeteve celulare (nuk përfshihen shpenzimet për licenca/autorizime) në periudhën 2010-2015.

FIGURA III.9: ECURIA E INVESTIMEVE TË SIPËRMARRËSVE NË RRJETE CELULARE (2010-2016)



Ecuria e investimeve në rrjete celulare të katër sipërmarrësve së bashku ka pasur një tendencë të ndjeshme të uljes në vitet 2011 dhe 2012, por duket se është më e stabilizuar në vitet 2013-2015. Megjithatë, vlerat e investimeve sipas sipërmarrësve kanë luhatje të konsiderueshme në kohë dhe midis njëri-tjetrit. Nga të katër operatorët celularë, Vodafone ka pasur nivelin më të lartë të investimeve në periudhën 2010-2015, duke arritur në 3.8 miliardë lekë në vitin 2011, që përkon me fillimin e ofrimit të shërbimeve 3G nga ky operator, ndërsa nivelin më të ulët në vitin 2015 me 1.4 miliardë lekë. Telekom Albania dhe Albtelcom kanë pasur rritje të ndjeshme të investimeve në vitin 2015 krahasuar me tre dhe katër vitet e mëparshme. Plus ka pasur nivelin më të lartë të investimeve në vitin 2010, që përkon me fillimin e ofrimit të shërbimeve nga ky operator, ndërsa ka pasur nivel shumë të reduktuar në vitet 2013-2015.

Në vitin 2016 u vu re një rritje ndjeshme e investimeve të katër operatorëve, madje Plus ka pasur diz-investime apo shitje asetesh.

### III.5 Pjeset e Tregut

Në tabelën mëposhtëme janë dhene pjesët e tregut të operatoreve celularë për disa tregues kryesore në periudhën 2014-2017 së bashku me indeksin HHI<sup>19</sup> të përqëndrimit.

TABELA III.2. PJESET E TREGUT TE OPERATOREVE CELULARE 2014-2017

|   |                    | Telekom Albania | Vodafone | Albtelecom | Plus | HHI   |
|---|--------------------|-----------------|----------|------------|------|-------|
| Përdorues shërbime celulare (karta SIM përfshirë Broadband Data Card) | 2017               | 32%             | 49%      | 14%        | 5%   | 3,676 |
|   | 2016               | 32%             | 49%      | 14%        | 4%   | 3,689 |
|   | 2015               | 34%             | 42%      | 16%        | 8%   | 3,223 |
|   | 2014               | 40%             | 40%      | 14%        | 7%   | 3,395 |
| Përdorues Aktivë Telefoni   | 2017               | 33%             | 48%      | 13%        | 6%   | 3,612 |
|   | 2016               | 31%             | 51%      | 13%        | 5%   | 3,725 |
|   | 2015               | 33%             | 47%      | 14%        | 6%   | 3,501 |
|   | 2014               | 34%             | 46%      | 13%        | 8%   | 3,456 |
| Përdorues aktivë broadband  | 2017               | 18%             | 59%      | 17%        | 5%   | 4,174 |
|   | 2016               | 27%             | 55%      | 14%        | 4%   | 3,940 |
|   | 2015               | 29%             | 55%      | 17%        | N/A  | 4,082 |
|   | 2014               | 25%             | 61%      | 15%        | N/A  | 4,501 |
| Thirrje dalje   | 2017               | 34%             | 48%      | 11%        | 7%   | 3,646 |
|   | 2016               | 34%             | 52%      | 11%        | 4%   | 3,946 |
|   | 2015               | 32%             | 49%      | 13%        | 6%   | 3,644 |
|   | 2014               | 34%             | 50%      | 11%        | 5%   | 3,801 |
| Trafik Data <sup>20</sup>   | 2017               | 22%             | 56%      | 20%        | 3%   | 3,969 |
|   | 2016               | 21%             | 55%      | 22%        | 2%   | 3,939 |
|   | 2015               | 18%             | 51%      | 29%        | 3%   | 3,732 |
|   | 2014               | 16%             | 49%      | 30%        | 4%   | 3,633 |
| Të ardhura totale nga komunikimet                                     | 2016               | 31%             | 49%      | 12%        | 9%   | 3,524 |
|   | 2015               | 34%             | 47%      | 12%        | 7%   | 3,582 |
|   | 2014 <sup>21</sup> | 34%             | 48%      | 12%        | 6%   | 3,665 |
| Të ardhura retail   | 2016               | 28%             | 56%      | 12%        | 5%   | 4,045 |
|   | 2015               | 28%             | 54%      | 12%        | 5%   | 3,894 |
|   | 2014               | 30%             | 53%      | 11%        | 5%   | 3,926 |

<sup>19</sup> HHI (Herfindahl-Hirschman Index), i matur si shuma e katroreve të pjesëve të tregut të gjithë lojtareve të tregut.

<sup>20</sup> Periudha 2011-2016 sipas trafikut total në rrjetet GPRS/UMTS. 2016 e në vijim sipas trafikut broadband celular në rrjetet 3G/4G.

<sup>21</sup> Treguesi është rishikuar pasi sipërmarrësi Vodafone Albania bëri saktësime në lidhje me vlerën e të ardhurave për vitin 2014. Mund të ekzistojë një mospërputhje e vogël ndërmjet shumës së përbërësve dhe totalit të paraqitur në tabela, për shkak të rrumbullakimeve.

Nga të dhënat per pjesët e tregut në periudhën 2014-2017 vihet re se:

- Vodafone Albania është operatori më i madh në treg me pjesë tregu afërsisht 50% në shumicën e treguesve, duke arritur dhe 59% për përdorues broadband dhe 56% në të ardhura nga shërbimet me pakicë dhe përdorim të dhënash (data traffic). Për treguesit e përdoruesve aktive të telefonisë dhe broadband, Vodafone ka pasur luhajtje me trend të kundërt në pjesët e tregut, duke arritur në 48% në 2017 për telefoni dhe 59% për broadband në vitin 2017.
- Telekom Albania ka pasur pjesë tregut të qëndrueshme për përdorues telefonie dhe thirrje telefonik në nivele 32-35% pjesë tregu, ndërsa ka pjesë tregu shumë më të ulëta në përdorues broadband (18%) përdorim të dhënash (22%). Pjesa e tregut në të ardhura totale dhe retail ka pasur rënie me 3-4 pp në 2014-2016 duke arritur në 28-31% në 2016.
- Albtelecom ka pjesë tregu 13-17% për përdorues pa ndryshime të ndjeshme në këto katër vjet. Pjesa e tregut për thirrje dalëse në vitin 2017 ishte 11% si edhe në vitin 2014. Albtelecom ka pjesë tregu rreth 20% për përdorim të dhënash, por me rënie nga rreth 30% në vitin 2014.
- Plus në periudhën 2014-2016 ka rënie të pjesëve të tregut për përdorues të shërbimeve celulare telefonike, thirrjeve dhe SMS-ve me 1-4.8 pp, ndërsa ka fituar 4.3% pjesë tregu në përdorues akses broadband dhe trafik të dhënash broadband që prej fillimit të ofrimit të shërbimeve 3G në tremujorin e tretë 2016.
- Pjesët e tregut kryesisht janë të krahasueshme sipas treguesve të ndryshëm, por bie në sy pjesa e tregut e Vodafone për SMS mbi 60% për shumë vite tashmë, dhe Albtelecom që ka pjesë tregu në trafik të dhënash shumë më të madh se numri i përdoruesve akses broadband, që do të thotë përdorim mesatar për përdorues të këtyre shërbimeve shumë më të lartë se operatorët e tjerë;
- Rënia e pjesëve të tregut të Plus për disa tregues (shërbime telefonie) është e vogël në pikë përqindje por për shkak të bazës së ulët krahasuese, ato janë rënie të ndjeshme.
- Treguesi i HHI është në nivele 3700-3900, përveç treguesit të SMS-ve që është rreth 5000 për shkak të pjesës shumë të madhe të tregut të Vodafone për këtë shërbim. HHI është rritur me 200-466 pikë për treguesit e shërbimeve telefonike dhe SMS dhe është me ulje për treguesit e aksesit broadband.
- Vodafone Albania zotëron 49% pjesë tregut në të ardhura totale dhe rreth 56% pjesë tregu në të ardhura nga shërbimet me pakicë, ndërsa operatori më i afërt me të Telekom Albanai zotëron 28% pjesë tregu të ardhura nga retail.

Megjithatë ndryshimet e ndjeshme në tarifat dhe trafikun off-net dhe on-net, si dhe reduktimet e ndjeshme të tarifave të terminimit, të imponuara nga masat rregulluese të AKEP, pjesët e tregut të operatorëve nuk kanë pesuar ndryshime të ndjeshme në këto dy vite. Plus vihet re se ka humbur pjesë tregu në disa tregues si numri i përdoruesish dhe duke filluar nga 1.01.2018 nuk do të ofrojë më shërbime duke cuar në konsolidim të tregut celular. Vodafone vazhdon të ketë pjesën më të madhe të tregut për shumicën e treguesve. Pjesët e tregut të Vodafone janë rreth nivelit 50% për shumicën e treguesve, duke arritur dhe në nivele rreth 60% për disa tregues.

### **III.6 Terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare**

Ne vijim te komenteve per Analizen e tregut, si dhe te komenteve dhe kundërshtimeve te shpeshta midis operatoreve celulare per rregullimin apo de-rregullimin e tarifës se terminimit te thirrjeve hyrëse ndërkombëtare (përfshirë ato drejt numrave të portuar) , dhe impaktit te madh financiar qe ka sjelle dhe sjell rregullimi apo de-rregullimi i tarifës se terminimit te thirrjeve hyrëse ndërkombëtare edhe në konkurrencën në tregun me pakicë celular, AKEP e ka konsideruar te arsyeshme përfshirjen e nje seksioni te vecante per kete ceshtje. Në vijim është dhënë një përmbledhje e trajtimit rregullator të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare (përfshirë ato drejt numrave të portuar) si dhe impakti i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare.

#### **Rregullimi/de-rregullimi i MTR ndërkombëtare**

Tarifat e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetet celulare dhe fikse kanë qenë nën-rregullim nga AKEP në periudhën Shtator 2008-Shkurt 2012. Rregullimi i tarifës së terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në periudhën e cituar është kryer nga AKEP duke i përcaktuar ato të barabarta me MTR për thirrjet kombëtare. Arsyetimi i këtij rregullimi është dhënë në dokumentet përkatëse të AKEP (më parë ERT). Ne vijim te ketyre vendimeve te AKEP, ofertat reference te interkoneksionit te tre operatoreve me FNT (AMC, Vodafone dhe Albtelecom fikse), përmbanin ne menyre eksplicite detyrimin per secilin nga tre operoret me FNT, qe te ofrojne terminim te thirrjeve ndërkombëtare, operatoreve vendas me tarife te njejte si edhe terminimi i thirrjeve kombëtare.

AKEP me Vendimet nr.1739, 1740 dhe 1741, datë 20.12.2011, vendosi nxjerrjen nga rregullimi të tarifave të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare për Telekom Albania, Vodafone Albania dhe Albtelecom (rrjeti fikse) me efekte nga data 1.02.2012.

Në analizën e tregut të vitit 2012, AKEP me Vendimet nr.2119, 2120, 2121 dhe 2122, datë 4.07.2012 kreu de-rregullimin e plotë të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, duke e nxjerrë këtë shërbim nga përkufizimi i tregut përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare duke ehequr edhe detyrimet e tjera për FNT si dhënie akses, mos-diskriminim dhe transparençë, me efekt nga data 1.09.2012. Ky qëndrim është mbajtur nga AKEP edhe në analizën e tregut të vitit 2014 si dhe në dokumentin e nxjerrë në këshillim publik në Dhjetor 2016.

#### **Portabiliteti i numrave dhe Terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare**

Me fillimin e implementimit të portabilitetit të numrit celular në Maj 2011, AKEP me Vendimet nr. 1559, 1560 dhe 1561, datë 20.04.2011, ka kryer ndryshimet në Ofertat Referencë të Interkoneksionit (RIO) të operatorëve celularë për trajtimin e thirrjeve drejt numrave të portuar, në lidhje me përkufizimet e shërbimeve të terminimit dhe tarifën e terminimit drejt këtyre numrave. Në lidhje me tarifën e terminimit për *‘Thirrje te origjinuara nga rrjete ndërkombëtare, te percjella me interkoneksion direkt te Operatori Dhurues me bartes ndërkombëtare (jo i autorizuar nga AKEP), drejt numrave te Operatorit Dhurues te portuar ne rrjetin e Operatorit Marrës (operator rrjeti celular ne RSH)’,* AKEP përcaktoi që tarifa të jetë e njëjtë me tarifën e terminimit të thirrjeve të tjera (kombëtare). Në këtë periudhë (Prill 2011) tarifat e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare ishin nën-rregullim dhe të njëjta me tarifën e terminimit të thirrjeve kombëtare, por ky përcaktim nuk u ndryshua edhe pas de-rregullimit të tarifave të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare me Vendimet nr.1739, 1740 dhe 1741, datë 20.12.2011, si dhe de-rregullimit të plotë të këtyre thirrjeve me Vendimet nr.2119, 2120, 2121 dhe 2122, datë 4.07.2012. AKEP me Vendimet 2176-


2180, datë 29.10.2012, ka miratuar ofertat referencë të interkoneksionit të katër operatorëve celularë, duke lënë të pandryshuar trajtimin e tarifimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare drejt numrave të portuar edhe pas de-rregullimit të plotë të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare. Kjo skemë ka funksionuar në të njëjtën mënyrë edhe pas datës 1.02.2012 kur hyri në fuqi de-rregullimi i tarifës së terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare.

AKEP në trajtimin e kësaj çështjeje edhe në vendimet e tjera deri në vitin 2014 i ka dhënë rëndësi parësore reduktimit/eliminimit të rrezikut të mos-përcjelljes së këtyre thirrjeve nga operatori dhënë drejt operatorit marrës, pasi dështimi i këtyre thirrjeve do të çenonte implementimin efektiv të portabilitetit të numrit, konkurrencen në tregun me pakicë dhe interesat e përdoruesve fundorë.

### **Impakti i terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare**

Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e trafikut të terminuar në rrjetet celulare sipas origjinës, kombëtare dhe ndërkombëtare, për periudhën 2014-2016 për katër operatorët celularë.

FIGURA III.10: TERMINIMI I THIRRJEVE KOMBETARE DHE NDËRKOMBËTARE 2014-2016



Pavaresisht reduktimit të tarifave të terminimit të thirrjeve kombëtare, të ardhurat nga terminimi i këtyre thirrjeve kombëtare kanë një rritje të ndjeshme në vitet 2015 dhe 2016 për shkak të rritjes së madhe të trafikut off-net. Të ardhurat e Altelecom, Vodafone dhe Telekom nga terminimi i thirrjeve kombëtare në vitin 2016 u rritën me 80-120% në krahasim me vitin 2014. Altelecom pati rritjen më të vogël me 80% ndërsa Telekom rritjen më të madhe me 120%.

Të ardhurat nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare përbejnë një burim të rëndësishëm të ardhurash për operatorët për shkak të trafikut të lartë hyrës ndërkombëtare si dhe tarifës që operatorët aplikojnë për këto thirrje që arrijnë deri në 30 eurocent/minute apo 40 lek/minute që është shumë më herë më e lartë (rreth 27 here) se tarifa e terminimit të thirrjeve kombëtare. Tabela e mëposhtme paraqet peshën e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në totalin e thirrjeve të terminuara në rrjetet celulare si dhe peshën e të ardhurave në terminimi i thirrjeve



ndërkombëtare dhe kombëtare në ne te ardhurat nga terminimi dhe ardhurat totale (retail plus wholesale) te kater operatoreve celulare ne vitet 2014-2016.

TABELA III.3: PESHA E TERMINIMIT NDËRKOMBËTAR NË TOTALIN E TERMINIMIT 2014-2016

|             | Terminim thirrje<br>ndërkombëtare/Total<br>terminim thirrje | Të adhura nga terminimi<br>ndërkombëtar/Total terminimi |
|-------------|---|---|
| <b>2014</b> | 44%   | 81%   |
| <b>2015</b> | 23%   | 82%   |
| <b>2016</b> | 11%   | 63%   |

*Burimi: Sipas të dhënave periodike të operatorëve celulare*

Nga të dhënat per tre operatorët aktualisht aktive ne treg vihet re se:

- Pesha e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në totalin e thirrjeve të terminura është reduktuar ndjeshëm për shkak rënies së trafikut hyrës ndërkombëtar por më shumë për shkak të rritjes së ndjeshme të trafikut off-net. Pesha e këtyre thirrjeve varion nga 6 në 14% sipas operatorëve.
- Pesha e të ardhurave nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare në totalin e të ardhurave nga terminimi është reduktuar nga 81-82% në 63% në vitin 2016, por në nivel shumë të lartë krahasuar me peshën e matur në minuta.
- Pesha e të ardhurave nga terminimi i thirrjeve kombëtare në të ardhurat totale të operatorëve (ëholesale+retail), pra pjesa e të ardhurave nga shërbimi me tarifë nën rregullim nga AKEP, në vitin 2014 ishte vetëm 6% ndërsa në vitin 2016 ishte 16%. Ky proporcion varion nga 10% në 19% sipas tre operatorëve aktivë në treg.

Nga të dhënat e dërguara në Janar 2018 nga tre operatorët celularë për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare (përfshirë drejt numrave të portuar) gjatë viti 2017, ndër të tjera rezulton se:

- MTR i aplikuar për thirrjet hyrëse ndërkombëtare në marrdheniet direkte me operatorët e huaj është rreth 30 eurocent/minutë apo 40 lek/minutë që është 27 herë më e lartë se tarifa aktuale e MTR kombëtarë. Ndërkohë operatorët aplikojnë dhe skonto në bazë të sasisë së trafikut;
- Trafiku hyrës ndërkombëtar në vitin 2017 ishte rreth 168 milion minuta që përbën një reduktim me 40% në krahasim me vitin 2016.
- Trafiku ndërkombëtar drejt numrave të portuar, i tranzituar nga operatorët dhënës tek operatorët marrës, ishte rreth 8 milion minuta, dhe varion nga 1 në 4 milion minuta sipas operatorëve.

Në bazë të këtij informacioni për trafikun hyrës ndërkombëtar drejt numrave të portuar është përgatitur tabela e mëposhtme që tregon sa përfiton operatori dhënës dhe marrës i numrit nga thirrjet hyrëse ndërkombëtare.

TABELA III.4: TË ARDHURA NGA MTR NDËRKOMBËTARE DREJT NURMAVE TË PORTUAR (2017)

|                                  | E ardhura Totale per operatorin Dhenes | E ardhura për Operatorin Marres | E ardhura Neto per Operatorin Dhenes |
|----------------------------------|--|---------------------------------|--------------------------------------|
| <b>Te ardhura (euro pa TVSH)</b> | 2,001,103                              | 85,970                          | 1,915,133                            |

*Burimi: Të dhënat e dërguara nga operatorët në Janar 2018 dhe llogaritje te AKEP*

Të dhënat sipas operatorëve tregojnë për një ndryshim të madh midis operatorëve për të ardhurat neto nga terminimi i këtyre thirrjeve. Sipas të dhënave impakti është i konsiderueshëm dhe operatori dhënës siguron një të ardhur të tepërt nga diferenca midis MTR ndërkombëtare dhe MTR kombëtare që nuk është e justifikuar. Njëkohësisht sic është cituar më sipër, e ardhura nga terminimi i këtyre thirrjeve është një pjesë konsiderueshme e të ardhurave të operatorëve të cilat përdoren për të ofruar tarifa më të ulëta me pakicë. Sipas kësaj skeme, operatori dhënës i numrit (që i është larguar përdouesi fundor) vijon të marrë të ardhura të tepërta nga ky numër/përdorues të cilat i përdor të mbajtur përdoruesit aktuale apo shtuar përdorues të rinj.

AKEP në implementimin e kësaj skeme ka gjykuar se trafiku hyrës ndërkombëtar midis operatorëve për këta numra të portuar midis tyre do të ishte i balancuar. Por sic vihet re situata nuk është e balancuar (i barabartë midis operatorëve).

Kjo skemë redukton stimujt e operatorëve për të marrë përdorues të rinj nëpërmjet portimit, madje con edhe në situata absurde kur operatorit dhënës mund t'i jenë larguar shumica apo të gjithë përdoruesit dhe ai mund të përfitojë të ardhura shumë të larta vetëm nga tranzitimi i këtyre thirrjeve.

AKEP vlerëson të adresojë këtë çështje nëpërmjet kësaj analize, ofertave reference te interkoneksionit si dhe ndryshimeve në Rregulloren e Portabilitetit, për të rregulluar marrëdhëniet midis operatorëve për rrugëzimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare (pika 5, Neni 8 i Rregullores)

## IV. Analiza për FNT për terminimin e thirrjeve në rrjetet celulare

---

Ne raundin e fundit të analizës së tregut për terminimin e thirrjeve në rrjetet celulare të kryer në vitin 2014, AKEP me Vendimet nr.2522-2526, datë 06.11.2014, ka shpallur me FNT katër operatorët celulare: Telekom Albania, Vodafone Albania, Albtelecom dhe Plus Communication. Përveç analizës së tregut dhe vendimeve në 2014, terminimi i thirrjeve në rrjetet celulare është analizuar nga AKEP edhe në raundin e analizave të mbajtura në vitin 2006, 2007, 2010 dhe 2012 dhe si i tillë edhe në këto analize dokumenti përmban arsyetime të përdorura në dokumentet e analizave të sipërcituara. Në të gjitha analizat e deritanishme, terminimi i thirrjeve në rrjetet celulare është perkufizuar si një treg perkates për secilin rrjet celular dhe të gjithë operatorët celulare aktive në treg janë percaktuar me FNT në ofrimin e terminimit në rrjetet e tyre celulare.

Komisioni Europian (KE) në vijim të direktivave të vitit 2002, nxjerr në mënyrë periodike rekomandime me listën e tregjeve perkates të dyshuar/justifikuar për nderhyrje dhe rregullim ex-ante nga ana e autoriteteve rregullatore të komunikimeve elektronike në vendeve anetare të BE. Tregu perkates i terminimit të thirrjeve në rrjet individual celular, është përfshirë në listën e tregjeve perkatese të justifikuar/dyshuar për nderhyrje ex-ante të të gjitha Rekomandimeve të KE, 2003, 2007 dhe së fundmi edhe në rekomandimin e vitit 2014. Tregjet që janë pjesë e listës së rekomandimeve të KE, indentifikohen si tregje të justifikuar/dyshuar për nderhyrje ex-ante në bazë të aplikimit të testit të tre kriterëve. Ky treg perkates është njekoheisht pjesë e listës së tregjeve perkates të Rregullores së Analizës së Tregut të AKEP, numri 7, dhe i njëjti me perkufizimin e tregut perkates në Rekomandimet e KE, përfshirë atë të vitit 2014 (tregu numer 2). Siç është theksuar në kapitullin e parë të këtij dokumenti, bazuar në percaktimet e Rregullores së Analizës së Tregut, meqenëse tregu perkates i terminimit të thirrjeve është pjesë e listës së Rregullores dhe njekoheisht edhe rekomandimit në fuqi të KE për tregjet perkates (Rekomandimi i vitit 2014), AKEP nuk ka nevojë të kryejë testin e tre kriterëve për këto treg.

Në seksionet në vijim, AKEP ka analizuar faktorët dhe ndryshimet e ndodhura apo që priten të ndodhin dhe që mund të kenë ndikim në perfundimet për perkufizimin e tregut perkates dhe FNT në treg për terminimin e thirrjeve në rrjetet celulare.

### IV.1. Perkufizimi i tregut të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare

Sherbimi i terminimit të thirrjeve zanore në një rrjet celular është një sherbim interkoneksioni i percaktuar edhe në oferten reference të operatorëve celulare, si dhe në Marrëveshjet e Interkoneksionit (MI) të lidhura me operatorët celulare, i cili është perkufizuar si më poshtë:

#### ***“Sherbimi i Terminimit në rrjetin e operatorit celular X”***

*Sherbimi nepermjet të cilit operatori celular X, në emër të Operatorit Perfitues percjell Thirrjet nga Pika e Interkoneksionit për në një Pike fundore të Rrjetit të tij në Republikën e Shqipërisë, të identifikuar nepermjet numrave të abonenteve/pajtimtareve të operatorit celular X.*

**“Abonent/pajtimtar i rrjetit operatori celular X”:** Abonentet/pajtimtaret qe:

- Kane numer celular qe i perket serive numerike 06X<sup>22</sup> xx xxxxx të alokuar nga AKEP operatorit celular X, numer i cili nuk eshte portuar ne rrjetin e nje operatori tjeter, ose
- Kane numer qe nuk i perket serive numerike 06X xx xxxxx te alokuar nga AKEP operatorit celular X, por qe eshte portuar ne rrjetin e operatorit celular X.

Terminimi i thirrjeve ne rrjetet celulare eshte nje sherbim me shumice, i cili perben nje input te domosdoshem per operatoret e rrjeteve te tjere (fikse dhe celulare) qe t’u ofrojne thirrje perdoruesve te rrjetit te vet drejt perdoruesve te nje rrjeti celular.

Terminimi i thirrjeve ne rrjetet e operatoreve celulare ne Shqiperi eshte kryer dhe kryhet nepermjet interkoneksionit direkt midis operatoreve (celular-celular, Albtelecom(fiks)-celulare, Nderkombetare-celulare apo celular-operatore alternative), ose nepermjet interkoneksionit indirekt, duke bere tranzitim nepermjet rrjeteve te tjera te cilat mundesojne sherbimin e tranzitimit drejt rrjeteve celulare.

Ne te gjitha raundet e analizave te tregut celular per terminimin e thirrjeve, AKEP ka percaktuar tregje perkatese te vecanta per terminimin e thirrjeve ne secilin rrjet celular te operatoreve aktive ne treg: Telekom Albania, Vodafone Albania, Albtelecom (viti 2010 e ne vijim), dhe Plus Communication (viti 2012 e ne vijim).

Nder ndryshimet e ndodhura ne tregun e telefonise se levizshme, ne periudhen pas analizes 2014, dhe qe mund te ndodhin ne periudhe 2-3 vjecare pas kesaj analize tregu dhe qe mund te konsiderohen me ndikim ne perkufizimin e tregut te terminimit te thirrjeve ne rrjetet celulare:

- Proceset e re-farming te brezave te frekuencave 900 dhe 1800 MHz, dhe heqja e kufizimeve teknologjike te perdorimit te ketyre brezave;
- Procese alokimi te frekuencave ne brezat e frekuencave 900, 1800 dhe 2600 MHz gjate viteve 2015 dhe 2016 dhe procese te tjera qe mund te kryhen ne te ardhmen si brezi 800 MHz pas lirimit të tij nga operatorët e transmetive radiotelevizive;
- Fillimi i ofrimit të shërbimeve ne rrjetet LTE-4G ne vitin 2015 dhe mundesia ne te ardhmen e ndertimit e rrjeteve 5G.
- Transferimi i frekuencave 900/1800/1900/2100 MHz nga Plus Communication tek Vodafone Albania dhe Telekom Albania në vitin 2017.
- Dalja nga tregu i Plus Communication më 1.01.2018.

### **Ndryshime te lidhura me frekuencat dhe standardet e sherbimit celular**

Te gjitha keto ndryshime jane te lidhura me brezat e frekuencave dhe standardet te rrjeteve celulare 3G-UMTS, 4G-LTE apo edhe 5G ne te ardhmen, dhe bazuar ne rekomandimet e KE, tregu me shumice i terminimit te thirrjeve zanore ne nje rrjet celular perfshin te gjitha llojet e topologjive te

---

<sup>22</sup> X=6, 7, 8 ose 9.

rrjeteve celulare: 2G/GSM, 3G-UMTS edhe 4G-LTE, dhe nuk ndikon ne perkufizimin e tregut perkates te terminimit te thirrjeve.

### **Dalja nga tregu e Plus Communications**

Procesi i transferimit te së drejtave të përdorimit të Plus Communications në brezat 900/1800/1900/2100 MHz tek Vodafone Albania dhe Telekom Albania në vitin 2017 u shoqërua me daljen nga tregu të Plus Communication, i cili prej datës 1.01.2018 nuk ofron më shërbime të rrjetit celular.

Megjithë ndryshimin e strukturës së tregut celular me pakicë, kjo dalje nga tregu i Plus si dhe cdo ndryshim në strukturën e tregut me pakicë (si p.sh ndryshimi i pjesëve të tregut apo hyrje të operatorëve të rinj në treg), nuk ndikon në tregun përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjetet e tjera celulare, pasi sipas përkufizimit të këtij tregu secili operator celular që është aktiv në treg është ofrues i vetëm i terminimit të thirrjeve në rrjetin e tij. Pra i vetmi ndryshim është që nga 4 tregje perkates te terminimit te thirrjeve ne rrjetet individuale celulare tashmë do të jenë vetëm 3 tregje përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjetet e operatorëve Telkom Albania, Vodafone Albania dhe Altelecom.

### **Terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare**

Ne analizen e tregut 2012 dhe ne vitin 2014, AKEP ka perfshire ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjetet celulare vetem thirrjet e origjinuara ne Republiken e Shqiperise, pra terminimi i thirrjeve hyrese nderkombetare nuk perfshihet si pjese e ketij tregu perkates. AKEP vlereson se ne lidhje me kete ceshtje nuk eshte e nevojshme te kryhen ndryshime, pasi kjo zgjidhje eshte analizuar nga AKEP dhe pranuar tashme nga tregu dhe njekohesisht edhe ne vendet e BE tendenca e viteve te fundit tregon se shume vende anetare te BE kane filluar te trajtojne ne menyre te ndryshme terminimin e thirrjeve hyrese nderkombetare te origjinuara nga vendet anetare te BE dhe EEA (European Economic Area) dhe thirrjet hyrese nderkombetare te origjinuara nga vendet e tjera. Sipas informacionit te publikuar nga Cullen International deri ne Dhjetor 2017, në 22 nga 32 vende evropiane, rregullimi i terminimit te thirrjeve ne rrjetet celulare nuk perfshin thirrjet ndërkombëtare të origjinuara jashtë zonës EU/EEA, dhe në disa vende aplikohet vetëm rregullimi i terminimit të thirrjeve kombetare.

Ndërkohë një çështje që është diskutuar në vitet 2016 dhe 2017 ka qenë trajtimi aktual rregullator i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare drejt numrave të portuar. Altelecom në vitin 2016 ka kërkuar nga AKEP që të rishikojë regjimin e trajtimit të tarifës së terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare drejt numrave të portuar, që përcillen nga operatori dhënës tek operatori marrës i numrit. Sipas regjimit aktual, operatori dhënës i numrit kur merr thirrje hyrëse ndërkombëtare drejt një numrit që portuar në një rrjet tjetër (operatori marrës), ka detyrim të përcjellë thirrjen drejt operatorit marrës dhe ky i fundit ka detyrim që të aplikojë tarifë terminimi për këto thirrje hyrëse ndërkombëtare të njëjtë me tarifën nën-rregullim të terminimit të thirrjeve hyrëse kombëtare. AKEP ka zhvilluar takim me operatorët kryesorë në treg si dhe ka kërkuar opinion për propozimet e Altelecom për rishikimin e këtij regjimi rregullator (eliminimin e barazimit të tarifës së terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare me tarifën e terminimit të thirrjeve kombëtare).

Gjithsesi, nga propozimet e Altelecom dhe nga opinionet e operatorëve për këtë propozim, vihet re se nuk kërkohet që të ndryshohet përkufizimi aktual i terminimit të thirrjeve, që nuk përfshin thirrjet hyrëse ndërkombëtare, por vetëm niveli apo mënyra e përcaktimit të tarifës së terminimit

të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare drejt numrave të portuar (dhe të përcjellë nga operatori dhurues tek operatori marrës i numrit).

Impakti i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare (përfshirë ato drejt numrave të portuar) si dhe rregullim/de-rregullimi i tarifave është trajtuar në seksionin 8 të kapitullit të mëpashëm, si dhe në seksionët në vijim të këtij dokumenti.

Në lidhje me përkufizimin e tregut të terminimit të thirrjeve, AKEP gjykon që të mos ndryshojë përkufizimin e tregut përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, pra që ai të përfshijë vetëm thirrjet kombëtare dhe të mos përfshijë thirrjet hyrëse ndërkombëtare, në linjë me analizat dhe vendimet e AKEP nga viti 2012 e në vijim, si dhe me dokumnetin e Analizës së nxjerrë në këshillim publik në Dhjetor 2016.

Ndërkohë terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, nëse ai përbën një treg të vecantë përkatës (të ndryshëm apo të njëjtë me terminimin e thirrjeve kombëtare), si dhe për nevojën ose jo të rregullimit të tij, do të vlerësohet nga AKEP në procesin e ri të analizës së tregut celular, me pakicë dhe tregjet e tjera të justifikueshme për ndërhyrje ex-ante pas ndryshimeve të strukturës së tregut celular dhe rekomandimeve të AK, që do të fillojë së shpejti nga AKEP sipas procedurave përkatëse në ligjin 9918 dhe Rregulloren e Analizës së tregut, duke marrë në konsideratë gjithashtu (sipas Ligjit 9918) të gjitha rekomandimet e KE dhe BEREC.

### **Përfundim për përkufizimin e tregjeve përkatës të terminimit**

AKEP gjykon se pas vitit 2014 dhe në 2-3 vitet e ardhshme (deri në një analizë tjetër) nuk kanë ndodhur ndryshime apo pritjet të ndodhin ndryshime të tilla që të ndikojnë në konkluzionet e arritura në analizën e 2014 në lidhje me përkufizimin e tregut të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë parimin *Pala Thirrëse Pagues* (*CPP-Calling Party Pays*). Për këto arsye AKEP nuk e konsideron të nevojshme të bëjë një analizë të testit të tre kritereve apo të produkteve/shërbimeve të përfshira në këto treg, duke përmbledhur sa më poshtë:

- Shërbimi i terminimit të thirrjeve zanore në rrjet celular është një treg i veçantë për secilin operator rrjeti celular aktiv në treg;
- Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve zanore në një rrjet celular përfshin të gjitha llojet e topologjive/teknologjive/standardeve të rrjeteve celulare: GSM, UMTS dhe LTE, pra përfshirë çdo lloj topologjie/teknologjie apo rrjeti celular të mundshëm;
- Terminimi i SMS-ve nuk është pjesë e tregut përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjet celular (përfundim nga analizat e mëparshme);
- Tregu i terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare përfshin vetëm thirrjet e origjinuara në Republikën e Shqipërisë;
- Dimensionin gjeografik të shërbimit të terminimit në secilin nga rrjetet celulare është kombëtar, d.m.th territori i Republikës së Shqipërisë.

Si përfundim, tregjet përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjet individual celulare janë:

- **Tregu i terminimit të thirrjeve zanore në rrjetin celular Telekom Albania, shërbim i ofruar nga sipërmarrësi Telekom Albania sh.a.**

- **Tregu i terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin celular Vodafone Albania, sherbim i ofruar nga sipermarresi Vodafone Albania sh.a.**
- **Tregu i terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin celular Albtelecom, sherbim i ofruar nga sipermarresi Albtelecom sh.a.**

## IV.2. Analiza per Fuqi te Ndjeshme ne Treg

Sipas perkufizimit te tregjeve perkates te terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetet individuale celulare, terminimi i thirrjeve eshte monopol natyror dhe çdo operator celular eshte monopolist ne ofrimin e sherbimit te terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin e vet. AKEP ne dokumentet e meparshme te analizave te zhvilluara per kete treg, duke i'u referuar edhe dokumentave shpjegues te KE per Rekomandimin e tregjeve perkates SËD(2014) 298, Commission Staff Working Document Explanatory Note<sup>23</sup>), ka analizuar si faktore te rendesishem per FNT ne tregjet e terminimit:

- pjeset e tregut;
- konkurrenca e mundshme;
- fuqia kundervepruese e blesesve te sherbimit;
- tarifimi i sherbimit te terminimit.

Vlen të theksohet se vlerësimi i faktoreve të mësipërm për FNT kryhet sipas qasjes se si janë sjellë dhe mund të sillen ofruesit e terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare në kushtet e mungesës së rregullimit të terminimit sipas statusit me FNT, apo sic njihet ndryshe “Modified Greenfield Approach”.

Tre faktoret e pare nuk kane pasur ndryshime dhe nuk pritet te kene ndryshime deri ne nje analize tjeter te ketij tregu, pasi:

- secili operator celular ka 100% pjese tregu ne ofrimin e sherbimit te terminimit ne rrjetin e vet, qe vjen nga perkufizimi i tregut perkatese te terminimit, dhe kjo nuk pritet te ndryshoje ne te pakten 2-3 vitet e ardhshme, pavaresisht ndryshimeve te ndodhura dhe te pritshme teknologjike;
- Asnje operator celular, nuk kercenohet nga operatore te tjere te mundshem qe te hyjne ne tregun individual te secilit prej tyre dhe te ofrojne sherbimin e terminimit te thirrjeve ne rrjetin e nje operatori tjeter celulare, pasi ky sherbim mund te ofrohet vetem nga operatori i rrjetit perkates;
- Asnje nga tre operoret celulare nuk ndeshet dhe nuk pritet te ndeshet me fuqi kundervepruese nga operatore te tjere qe te kufizojne fuqine e ndjeshme te secilit prej tyre ne percaktimin e tarifave te terminimit te rrjeteve respektive celulare, ne mungese te rregullimit te tarifave te terminimit nga AKEP (me vendime te vecanta sipas statusit se FNT apo nepermjet procedurave te zgjidhjeve te mosmarreshjeve). Parimi CPP (Calling Part Pays) nuk pritet te ndryshoje ne vitet ne vijim, pra secili operator nuk ndeshet me fuqi kundervepruese nga perdoruesit e tyre per terminimin e thirrjeve, pasi ata nuk paguajne per thirrjet hyrese, por vetem per thirrjet dalese.

---

<sup>23</sup>A market definition for call termination on each network could imply that currently each network operator is a single supplier on its respective termination market, which suggests that each operator has a 100% market share. While a 100% market share provides a very strong presumption of SMP, in accordance with competition law principles, a finding that there is no SMP may occur if there is sufficient countervailing buyer power, which could render any non-transitory price increase unprofitable.



## **Ecuria e tarifave te terminimit ne rrjetet celulare**

Niveli i tarifave të terminimit në rrjetet celulare ka qene objekt rregullimi nga AKEP (më parë ERT) që nga viti 2006. Rregullimi i këtyre tarifave nga AKEP deri në vitin 2010 është kryer duke përdorur nivelin mesatar të tarifave të terminimit në vendet e BE, dhe duke filluar nga viti 2010, ky rregullim është kryer bazuar në reduktimin e përshkallëzuar për orientimin në kosto drejt vlerës së nxjerrë nga modeli BU-LRAIC<sup>24</sup> i ndërtuar në vitin 2010 nga AKEP me konsulencë ndërkombëtare.

AKEP me Vendimin nr.1505, datë 10.02.2011, miratoi dokumentin për orientimin e tarifave të terminimit në kostot BULRAIC, duke përcaktuar një grafik për reduktimin e përshkallëzuar (glide path) të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet e katër operatorëve celulare (tarifat për Plus ishin rekomanduese, pasi Plus nuk kishte status me FNT në kohën e vendim-marrjes). Vendimet 1506-1508, përcaktuan tarifat e terminimit të thirrjeve në mënyrë individuale për Telekom Albania, Vodafone Albania dhe Albtelecom.

Në dokumentin e Analizes së tregut celular, miratuar më 4.07.2012, dhe me vendimet përkatëse të FNT, AKEP ka miratuar nivelin e tarifave të terminimit të katër operatorëve celularë deri në vitin 2015 apo deri në një vendim-marrje tjetër. Tarifat e përcaktuara me vendimet 2118-2122, datë 4.07.2012 ishin të njëjta me Vendimet 1505-1508, duke konfirmuar reduktimin e përshkallëzuar të vendosur në Shkurt 2011, me disa ndryshime për operatorin Plus Communication.

Sipas vendimeve të mësipërme tarifat e terminimit të Telekom Albania, Vodafone dhe Albtelecom janë reduktuar dhe më 1.09.2013 kanë arritur nivelin e koston 4.57 lek/minutë, ndërsa për Plus me vendimet e dates 4.07.2012 u vendos qe tarifa e terminimit te arrijë nivelin 4.57 lek/minutë më 1.09.2015.

AKEP me vendimet nr.2431-2435, date 13.03.2014, vendosi qe tarifat e terminimit te kater operatoreve te reduktoheshin gradualisht duke filluar nga 1.04.2014 per te arritur ne nivelin 1.48 lek/minute ne 1.01.2016, e cila eshte sa vlera mesatare e tarifave te terminimit ne vendet Evropiane qe kane aplikuar LRIC te paster ne vitin 2013.

Bazuar në gjetjet e analizes se tregut 2014, AKEP me Vendimet nr.2522-2526, datë 06.11.2014, percaktoi qe tarifa 1.48 lek/minute te fillonte te aplikohet qe prej dates 1.12.2014 per Vodafone, Telekom Albania dhe Albtelecom, ndersa tarifa e terminimit ne rrjetin Plus te qendronte ne vleren 6.52 lek/minute deri ne nje vendim tjeter te AKEP.

Bazuar ne procesin e shqyrtimit te ankimeve administrative te kater operatoreve celulare per vendimet e dates 6.11.2014, AKEP me Vendimin nr.2542, datë 13.03.2015, ndryshoi tarifen e terminimit ne rrjetin Plus (te percaktuar me vendimet e dates 6.11.2014), duke percaktuar nje glidepath (reduktim te pershkallezuar) ne menyre qe tarifa e terminimit ne rrjetin Plus te arrinte nivelin 1.48 lek/minute me date 1.01.2016. Reduktimi u percaktua te kryhej me dy faza te ndermjetme qe fillonin me 1.04.2015 dhe 1.07.2015.

AKEP në vijim të Vendimeve për monitorim të situates ne treg, bazuar në vlerësimin e rrethanave konkrete në treg, me VKD nr.2664, datë 14.01.2016, njoftoi operatorët për një pezullim 90 ditor në lidhje me fillimin e aplikimit të simetrisë me datë 1.01.2016.

---

<sup>24</sup> Bottom-Up Long Run Average Incremental Cost (Model Poshtë-Lart i Kostos Mesatare Inkrementale Afatgjatë)


AKEP me Vendim nr.2676, datë 14.04.2016, miratoi mbylljen e procesit te filluar me VKD 2664 dhe miratimin e rezultateve, duke vendosur datën 1 Prill 2016 si datë për vendosjen e simetrisë së MTR-ve për të gjithë operatorët.

Në vijim të sqarimeve të dhëna në seksionin III.1 të këtij dokumenti për proceset gjyqësore në lidhje me Vendimet e mësipërm, AKEP në seksionet e mëposhtme si tarifë terminimi në rrjetin Plus Communication në periudhën 1.04.2015-31.12.2017 ka dhënë vlerën 6.52 lek/minutë.

### **Ecuria dhe krahasimi i tarifave te terminimit celular me vendet e BE/BEREC**

Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e tarifave të terminimit në rrjetet celulare të katër operatorëve për periudhën Mars 2008 deri në Korrik 2017, si dhe krahasimin e këtyre tarifave në Shqipëri me tarifatat mesatare në vendet e BEREC.

**FIGURA IV.1: TARIFAT Ë TERMINIMIT CELULAR NË SHQIPËRI DHE VENDET E BEREC (2008-2017)**



Burimi: AKEP dhe BEREC<sup>25</sup>

Siç mund të vihet re, tarifatat e terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare të dy operatorëve më të mëdhenj në Shqipëri kanë qënë afër nivelit mesatar të vendeve të BE në vitet 2008 deri sa barazohen në vitin 2014, duke pasur një diferencë më të madhe në 2013 me vendet e BE dhe BEREC. Diferenca më e lartë me vendet e BEREC në 2013 ka ardhur për shkak të reduktimeve të mëdha në vendet e BE, në 2013, për orientimin në kostot LRIC të pastër. Reduktimet e AKEP të përcaktuara me Vendimet e datës 13.03.2014 e në vijim, për orientimin në kostot LRIC të pastër, duke përdorur të dhëna benchmark, kanë çuar nivelin e tarifës së terminimit për tre operatorët me

<sup>25</sup> Kursi I kembimit i përdorur: 1 Euro=140 lek deri në vitin 2014 ndërsa për periudhat me pas sipas kursit të publikuar në dokumentat e BEREC.

të medhenj në nivelin 1.48 lek/minutë më datë 1.12.2014, sa tarifa mesatare e vendeve të BEREC që kishin aplikuar modelin LRIC të pastër deri në vitin 2013.

Duke iu referuar ecurisë së tarifave në periudhën 2012 deri aktualisht si edhe në periudhën para vitit 2012, vihet re se reduktimet në vite të tarifës së terminimit në rrjetet celulare, përafrimi i tarifës së terminimit me nivelet mesatare të BE, dhe përcaktimet për orientim në kosto të tyre (BULRAIC dhe benchmark sipas mesatares së vendeve Evropiane me LRIC të pastër) nuk kanë ardhur si pasojë e presionit konkurrues në tregjet përkatëse të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, por për shkak të nderhyrjes së AKEP nëpërmjet procedurave të zgjidhjeve të mos-marreveshjeve, implementimit të metodologjive të rregullimit të tarifave si edhe orientimit në kosto. Në mungesë të nderhyrjes rregullatore, operatorët celulare do të ishin dhe do jënë në gjendje t'u impononin operatorëve vendas tarifa më të larta për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre celulare. AKEP ka përcaktuar nivelin maksimal të tarifave dhe asnjë operator nuk ka aplikuar tarifa më të ulët se vlera maksimale e imponuar nga AKEP.

Referuar dokumentave rregullatore të KE-së, dhe së fundmi edhe dokumentit të BEREC *BoR (16) 159, 'BEREC Report Regulatory Accounting in Practice 2016' 6 October 2016* rezulton se të gjithë operatorët e rrjeteve celulare aktive në treg janë përcaktuar si operatorë me FNT për terminimin e thirrjeve zanore në rrjetet e tyre., dhe në disa vende edhe MVNO-të janë përcaktuar me FNT për këtë shërbim.

### **IV.3. Përfundim për FNT për terminimin e thirrjeve**

Në analizën e faktorëve të marrë në konsideratë për fuqinë e ndjeshme në tregjet përkatëse, rezulton se:

- Secili prej operatorëve Telekom Albania, Vodafone Albania dhe Albtelecom zoteron 100 % të tregut të terminimit të thirrjeve në rrjetet e tyre;
- Operatorët celulare nuk përballen me kërcënimin e hyrjes në tregjet e tyre të terminimit të operatorëve të tjerë, që do të ishin të afte të kryenin edhe terminimin e thirrjeve në këto rrjete;
- Operatorët celulare ndeshen me fuqi të ulët kundërvepruese nga operatorët e tjerë të telefonisë së lëvizshme dhe të telefonisë fikse për tarifën e terminimit në rrjetet e tyre;
- Në mungesë të nderhyrjes rregullatore, çdo operator celular do të jetë në gjendje t'ju impononte operatorëve vendas tarifa të larta për terminimin e thirrjeve në rrjetin celular që zoteron;
- Përfundimet e analizës së tregut për FNT për tregun përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare nuk ndikohen nga ndryshimi i strukturës së tregut me pakicë celular, dhe dalja nga tregu e Plus Communication nuk ndikon në përfundimet për FNT të tre operatorëve të tjerë celularë për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale;
- Kriteret e marra në shqyrtim nuk kanë ndryshuar dhe nuk priten të ndryshojnë të pakten në një periudhë afatmesme 2-3 vjeçare, në mënyrë që të eliminojnë aftësinë ndikuese apo FNT të operatorëve në tregjet përkatëse të terminimit të thirrjeve në rrjetet e tyre.

Duke marrë në konsideratë faktorët (argumentat) e mësipërm, AKEP vlerëson se të tre operatorët celulare përmbushin kriteret për fuqi të ndjeshme në tregjet përkatëse të terminimit të thirrjeve zanore në rrjetet e tyre celulare:

- **Sipermarresi Telekom Albania sh.a permbush kriteret per FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjetin celular Telekom Albania.**
- **Sipermarresi Vodafone Albania sh.a permbush kriteret perFNT ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjetin celular Vodafone Albania.**
- **Sipermarresi Albtelecom sh.a permbush kriteret perFNT ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjetin celular Albtelecom.**

# V. MASAT RREGULLUESE PËR FNT

---

Nga analiza për FNT në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë celulare në kapitullin IV të këtij dokumenti, rezultoi se përmbushen kriteret për FNT (dominance individuale) në tregun përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare aktive në Shqipëri, Telekom Albania, Vodafone Albania dhe Altelecom.

Në bazë të parashikimeve të ligjit, **neni 34**: *Nëse AKEP-i përcakton se një ose disa sipërmarrës kanë fuqi të ndjeshme në treg, në tregun përkatës, pra nuk ka konkurrencë efektive, atëherë ajo vendos ndaj tyre një, disa ose të gjitha detyrimet e veçanta të nevojshme, të cilësuar në nenet 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45 e 56 të këtij ligji.*

Sipas përcaktimeve të ligjit 9918 detyrimet që mund të vendosen në lidhje me FNT në tregun përkatës janë:

- Mosdiskriminimi (neni 39),
- Transparenca (neni 40),
- Ndarja e llogarive (neni 41)
- Dhenie Akses dhe Interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (neni 42),
- Kontrolli i tarifave dhe sistemi i mbajtjes së llogarive (neni 45)

Sipas pikës 5 të nenit 34 të ligjit 9981 detyrimet e vendosura në përputhje me nenin 34 **duhet të bazohen në natyrën e problemit të identifikuar dhe duhet të jenë proporcionale e të justifikuar nga pikëpamja e objektivave rregullatore të vendosura në nenin 7 të këtij ligji.**

Nderkohe nenet 55-59, përmbajnë përcaktime në lidhje me detyrimin për kontrollin dhe rregullimin e tarifave dhe zbatimin e tyre.

Për sa më sipër, në seksionin në vijim trajtohen problemet e identifikuar me terminimin e thirrjeve në rrjetet celulare si dhe masat përkatëse rregulluese proporcionale sipas problemeve për secilin treg (3 tregje përkatëse) të nevojshme për realizimin e objektivave rregullatore të promovimit të konkurrencës dhe rritjes së përfitimeve të përdoruesve fundorë.

## V.1. Identifikimi i problemeve nga FNT në terminimin e thirrjeve

AKEP në një sërë dokumentash të mëparshëm të analizave të tregut ka evidentuar problemet kryesore tipike që lindin nga FNT për terminimin e thirrjeve dhe nevojën e masave rregulluese për adresimin e tyre. Grupi i Rregullatoreve Europiane (ERG- aktualisht BEREC) në dokumentin , *ERG (06) 33, Revised ERG Common Position on the approach to Appropriate remedies in the ECNS regulatory framework, Final Version May 2006*, citon 4 probleme kryesore për konkurrencën në lidhje me FNT për terminimin e thirrjeve (në kushtet e mungesës së masave rregulluese):

- koluzioni i fshehtë;
- tarifim i tepert (mbi kosto i MTR);
- diskriminim ne tarifa të terminimit (midis operatorëve të ndryshëm dhe/ose midis divizionit të vet retail dhe operatorëve të tjerë);
- refuzimi per te negociuar apo mosdhenie aksesit për interkoneksion/terminim.

Për adresimin e këtyre problemeve që lindin nga FNT per terminimin e thirrjeve në rrjetet celulare, AKEP, në përputhje me rekomandimet e ERG/BEREC dhe ligjit 9918, ka vendosur masat rregulluese të parashikuara nga ligji 9918, ku më kryesoret kanë qenë:

1. Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39);
2. Detyrimi i transparencës (Neni 40);
3. Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42);
4. Detyrimi për kontroll të tarifave (Neni 45).

Në lidhje me diskriminimin në tarifa që vjen nga FNT në terminim, ERG në dokumnetin e cituar më sipër shpjegon se kjo strategji për të mbyllur tregun është e lidhur kryesisht me konkurrencën në tregun celular apo marrdhëniet midis operatorëve celularë (M2M). Operatorët më të herëshëm/të mëdhenj në treg mund të kërkojnë të mbyllin tregun apo përjashtojnë operatorët e vegjël duke aplikuar tarifa të larta (mbi kosto) për terminimin për operatorët e tjerë ndërsa aplikojnë tarifa të ulët të brendshme për terminimin (për divizionin e vet retail). Kjo con në kosto të larta për thirrjet off-net për operatorët e tjerë në nivel me shumicë pra dhe në tarifa/kosto të larta të thirrjeve me pakicë off-net. Ndërkohë kostot më të ulëta për thirrjet on-net cojnë në tarifa më të lira on-net. Kjo strukturë tarifore (on-net shumë më i lirë se off-net) krijon atë që quhet eksternalitete të rrjetit për shkak të tarifave (tariff mediated network externalities) duke vendosur operatorët e vegjël në dizvantazh ndaj operatorëve të mëdhenj.

Externalitetet e rrjetit nënkuptojnë që sa më i madh një rrjet (në terma të numrit të pajtimtarëve) aq më tërheqës bëhet ai rrjet për pajtimtarët (aktualë dhe të rinj), pasi kanë mundësi të komunikojnë me tarifa shumë të ulëta on-net me një numër më madh pajtimtarësh në krahasim me një rrjet më të vogël. Dhe sa më e madhe diferenca midis pjesëve të tregut për pajtimtarë të operatorëve të mëdhenje dhe të vegjël, midis tarifave tarifa on-net/off-net dhe sa më i lartë niveli i MTR në raport me koston eficente, aq më të mëdha avantazhet e operatorëve më bazë të madhe pajtimtarësh dhe dizavantzhet e operatorëve më të vegjël.

Ky diskriminim në tarifat me pakicë on-net/off-net është është shumë më i favorshëm për operatorët më të hershëm (të mëdhenj) në treg dhe con në ruajtje apo rritje të pjesës së tregut të operatorit/operatorëve më të mëdhenj dhe mos-ndryshim i pjesëve të tregut të operatorëve të më të vegjël, madje dhe rënie të tyre, për shkak të aftësisë së ulët konkurruese të këtyre operatorëve ndaj operatorëve më të mëdhenj.

Diskriminimi në tarifat me pakicë të thirrjeve on-net dhe off-net dhe ndikimi i tij negativ në konkurrencën midis operatorëve në treg ishte një ndër problemet kryesore të evidentuara nga AKEP në analizën e vitit 2014 si dhe në rekoamandimet e AK në vitin 2014. Për të adresuar këtë problem ku tarifat me pakicë on-net ishin shumë më të ulëta se tarifat off-net, AKEP vendosi që

përveç reduktimit të MTR, masa rregulluese e mos-diskriminimit për MTR të përfshinte edhe detyrimin për mos-diskriminim në tarifatat me pakicë on-net/off-net nga të katër operatorët celularë

AKEP në kapitullin III ka evidentuar ndryshimet e ndjeshme në trafikun on-net/off-net pas zbatimit të detyrimit të mos-diskriminimit nga të katër operatorët. Më poshtë janë disa të dhëna në lidhje me ndryshimet sipas operatorëve në strukturën e thirrjeve dhe në të ardhurat/pagesat neto të operatorëve nga terminimi i thirrjeve.

Raporti i thirrjeve on-net/off-net të operatorit më të madh celular, Vodafone Albania, ka ndryshuar nga 97% v 3% në Janar 2014 në 66% v 34% në Dhjetor 2017. Për Telekom Albania ky raport ka pësuar ndryshime edhe më të mëdha: nga 96% v 4% në Janar 2014 në 53% v 47% në Dhjetor 2017.

Ndërkohë edhe dy operatorët më të vegjël kanë pësuar ndryshime të mëdha. Albtelcom në Dhjetor 2017 kishte 28% të thirrjeve on-net dhe 72% të thirrjeve off-net. Në Korrik 2015 që filloi implementimi i detyrimit të mos-diskriminimit në tarifatat on/off net, Albtelcom arriti në raportin 48/52 të thirrjeve on-net/off-net, ndërkohë Vodafone dhe Telekom Albania ishin edhe në nivele shumë të larta të thirrjeve on-net me 83-85%.

Albtelcom është operatori më i vogël aktualisht në treg dhe me proporcionin më të madh të thirrjeve off-net se dy operatorët e tjerë (Kapitulli III). Për vitin 2017 Albtelcom kishte 29% të thirrjeve on-net dhe 71% off-net, krahasuar me Vodafone ku ky raport ishte pothuajse inversi me 67% on-net dhe 33% off-net, ndërsa Telekom Albania kishte raportin 55/45 të thirrjeve on/off-net

TABELA V.1: RAPORTI I THIRRJEVE ON-NET DHE OFF-NET SIPAS OPERATORËVË JANAR 2014-DHJETOR 2017

|               | Vodafone |         | Telekom Albania |         | Albtelcom |         | Plus   |                   | Mesatare tregu |         |
|---------------|----------|---------|-----------------|---------|-----------|---------|--------|-------------------|----------------|---------|
|               | On-net   | Off-net | On-net          | Off-net | On-net    | Off-net | On-net | Off-net           | On-net         | Off-net |
| <b>Jan-14</b> | 97%      | 3%      | 96%             | 4%      | 81%       | 19%     | 88%    | 12%               | 95%            | 5%      |
| <b>Jan-15</b> | 92%      | 8%      | 89%             | 11%     | 68%       | 32%     | 70%    | 30%               | 87%            | 13%     |
| <b>Jul-15</b> | 85%      | 15%     | 83%             | 17%     | 48%       | 52%     | 50%    | 50%               | 78%            | 22%     |
| <b>Jan-16</b> | 76%      | 24%     | 66%             | 34%     | 37%       | 63%     | 31%    | 69%               | 67%            | 33%     |
| <b>Jan-17</b> | 69%      | 31%     | 56%             | 44%     | 29%       | 71%     | 20%    | 80%               | 58%            | 42%     |
| <b>Dec-17</b> | 66%      | 34%     | 53%             | 47%     | 28%       | 72%     | 19%    | 81% <sup>26</sup> | 55%            | 45%     |


Një aspekt i rëndësishëm i marrdhënieve midis operatorëve celularë në treg dhe me impakt në aftësitë konkurruese të tyre në tregun me pakicë janë dhe trafiku neto dhe të ardhurat neto nga terminimi i thirrjeve midis operatorëve celularë. Balanca e trafikut midis operatorëve në treg apo struktura e përdoruesve (raporti i thirrjeve dalëse dhe hyrëse) ka rëndësi në marrdhëniet midis operatorëve pasi këto ndikojnë në pagesat neto midis operatorëve si dhe aftësitë konkurruese në

<sup>26</sup> Për Plus i referoem muajt Gusht 2017 dhe mesatare e tregut për Dhjetor 2017 është vlerësim i AKEP.

tregun me pakicë, pasi të ardhurat nga terminimi i thirrjeve janë një burim të ardhurash nga përdoruesit me pakicë në mënyrë indirekte. Në Shqipëri si në shumicën e vendeve të botës aplikohet parimi CPP, dhe pajtimtari marrës i thirrjes nuk paguan për thirrjen e marrë d.m.th nuk gjeneron të ardhur me pakicë, por gjeneron të ardhur me shumicë për operatorin e vet që e merr këtë të ardhur nga operatori origjinues.

Figurat e mëposhtëme paraqesin trafikun neto (trafik hyres minus trafik dales) në periudhën Janar 2014-Dhjetor 2017 midis tre operatoreve celulare të përcaktuar me FNT në këtë dokument.

**FIGURA V.1: ECURIA E TRAFIKUT DHE TË ARDHURAVE NETO MIDIS TRE OPERATORËVE CELULARE 2014-17**




Burimi: AKEP, bazuar në të dhënat mujore të dërguara nga operatorët

Në figurat më poshtë jepet në ecuria të pagesave neto dhe Altelecom në periudhën Janar 2014-Dhjetor 2017, nga shkëmbimi i trafikut me dy operatorët e tjerë celularë të përcaktuar me FNT në këtë dokument.



FIGURA V.2: PAGESAT NETO TE TERMINIMIT TE ALBTELECOM PER TRAFIKUN E SHKEMBYER ME TRE OPERATORET E TJERE CELULARE 2014-2017



Nga të dhënat e të ardhurave/pagesave neto mdis tre operatorëve rezulton se:

- Vodafone Albania është përfitues neto në vlera të mëdha në këto katër vite nga dy operatorët e tjerë, për shkak se ka shumë më tepër trafik hyrës nga këta operatorë se trafik dalës drejt tyre (figura më poshtë).
- Telekom Albania në total për katër vitet paraqitet me vlerë të ulët pagesë neto, por ecuria e trafikut neto në vitin e fundit e ka kaluar në pagese neto për shkak të trafikut të madh dalës drejt Vodafone.
- Albtelecom ka qene paguesi neto më i madh në këto katër vjet. Niveli me i ulet i pagesave neto te Albtelecom ka qene në periudhen Prill-Nentor 2014 kur AKEP aplikoi tarifa asimetrike per Albtelecom ne raport me Vodafone dhe Telekom Albania (Figura më poshtë).

### **Përfundim për problemet nga FNT në terminimin e thirrjeve**

Sic është evidentuar në Kapitullin III dhe me siper, zbatimi i detyrimit të mos-diskriminimit në tarifatat e thirrjeve on-net/off-net i shoqeruar dhe me ulje të të MTR të tre operatorëve celularë, ka cuar në ndryshime të rëndësishme pozitive të tarifave me pakicë dhe në strukturën e thirrjeve dhe përfitime të përdoruesve fundorë gjatë kësaj periudhe, por

- nuk ka cuar në rritje të nivelit të konkurrencës apo rritje të pjesëve të tregut/aftësisë konkurruese të operatorëve më të vegjël (hyrësve më të rinj në treg) apo reduktim të indeksit HHI për një sërë treguesish. Madje sic është evidentuar në këtë dokument, HHI ka pasur rritje për një sërë treguesish, dhe Vodafone ka ruajtur pjesën e tregut rreth 50% për shumë tregues apo ka rritur pjesën e tregut në tregues të tjerë, duke arritur dhe nivele mbi 60% për disa tregues;
- Albtelecom është operatori më i vogël në treg për vitin 2017 kishte 29% te thirrjeve on-net dhe 71% off-net, krahasuar me Vodafone ku ky raport ishte pothuajse inversi me 67% on-net dhe 33% off-net, ndërsa Telekom Albania kishte raportin 55/45 të thirrjeve on/off-net

- MTR ndikojnë në pagesat që operatorët i kryejnë njëri tjetrit për terminimin e thirrjeve, të cilat njihen si të ardhura/kosto neto nga interkoneksioni si dhe në aftësitë konkurruese në tregun me pakicë. Në periudhën 2014-2017 nga trafiku i shkëmbyer midis 3 operatorëve:
  - o Vodafone ka qenë përfitues neto në vlera të mëdha monetare.
  - o Telekom Albania ka pasur të ardhura neto totale negative në vlerë të vogël në katër vitet e fundit, por këto të ardhura neto negative ishin në rritje në vitin 2017 në raport me Vodafone për shkak të rritjes së trafikut off net drejt këtij operatori.
  - o Albtelecom ka qenë operatori që ka pasur të ardhura neto negative gjatë gjithë kohës së aktivitetit të tij, dhe në këtë periudhë 2014-2017 ka pasur të ardhura neto negative apo ka paguar dy operatorët e tjerë vlera të mëdha të pagesave neto.
  
- Pësia e madhe e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare dhe në të ardhurat e operatorëve, fakti që Vodafone për shumë vite ka qenë dhe është operatori që ka nivel shumë të lartë të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në raport me dy operatorët e tjerë celularë (pjesë tregu rreth ose mbi 60% për këto thirrje), bën që de-rregullimi i MTR ndërkombëtare të krijojë avantazhe më të mëdha për operatorët më të mëdhenj në treg sidomos Vodafone Albania. Në vendet e BE që kanë filluar të derregullajnë MTR për thirrjet hyrëse ndërkombëtare nga vendet jashtë BE/EEA, ky nuk është problem pasi pësia e këtyre të ardhurave nga MTR ndërkombëtar jashtë rregullimit është shumë e vogël:
  - o Thirrjet me të mëdha hyrëse ndërkombëtare janë midis vendeve të BE që janë me MTR ndërkombëtare nën rregullim (=MTR kombëtare);
  - o Normalisht vendet e zhvilluara (përfshirë ato të BE) janë vende që gjenerojnë shumë më tepër trafik dalës ndërkombëtar drejt vendeve në zhvillim dhe me emigracion të lartë (si Shqipëri apo rajoni) se sa hyrës ndërkombëtar nga këto vende
  
- Nga të dhënat e dërguara në Janar-Shkurt 2018 nga tre operatorët celularë për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare drejt numrave të portuar gjatë viti 2017, rezulton se operatori dhënës siguron një të ardhur të tepërt nga diferenca midis MTR ndërkombëtare dhe MTR kombëtare që nuk është e justifikuar. Sipas skemes aktuale, operatori dhënës i numrit (që i është larguar përdouesi fundor) vijon të marrë të ardhura të tepërta nga ky numër/përdorues të cilat i përdor të mbajtur përdoruesit aktuale apo shtuar përdorues të rinj, dhe kjo skemë nuk është në linjë me vendimet e AKEP për de-rregullimin e MTR të thirrjeve ndërkombëtare. Kjo skemë ka nevojë të rishikohet në linjë me vendimet e tjera të AKEP për FNT dhe praktika ndërkombëtare të ngjashme
  
- duke filluar nga 1.01.2018 Plus nuk ofron më shërbime dhe në tregun celular janë aktualisht aktivë apo që ofrojnë rrjet/shërbime celularë vetëm 3 operatorë nga 4 që ishin në periudhën Nëntor 2010-2017, dhe kjo situatë e re së bashku me analizën e tarifave me pakicë (ARPM/ARPU shumë e ulët dhe deri nën kosto) e shoqëruar me rënie të ndjeshme të fitimeve të operatorëve më të mëdhenj dhe humbje të qëndrueshme ndër vite e operatorit më të vogël dhe të ri në treg Albtelecom (celular), krijon shqetësime për qëndrueshmërinë e konkurrencës në tregun me pakicë celular si dhe rrjedhimisht edhe të përfitimeve të përdoruesve të këtyre shërbimeve në periudhë afatgjatë.

## V.2 Masat rregulluese për FNT sipas këtij dokumenti

Sipas përfundimeve të analizës, terminimi i thirrjeve kombëtare në rrjetin individuale të secilit prej tre operatorëve celularë përbën një treg të vecantë përkatës dhe të tre operatorët celularë janë me FNT për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale.

AKEP në dokumentin e nxjerrë në këshillim publik propozoi që të katër operatorët celularë (përfshirë Plus) të vazhdojnë të kenë të njëjtat detyrime për FNT në terminimin e thirrjeve si edhe masat rregulluese të përcaktuara në Vendimet e datës 6.11.2016, të ndryshuara:

1. Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39);
2. Detyrimi i transparencës (Neni 40);
3. Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42);
4. Detyrimi për kontroll të tarifave (Neni 45).

Sipas pikës 5 të nenit 34 të ligjit 9981 detyrimet e vendosura në përputhje me nenin 34 **duhet të bazohen në natyrën e problemit të identifikuar dhe duhet të jenë proporcionale e të justifikuara nga pikëpamja e objektivave rregullatore të vendosura në nenin 7 të këtij ligji.**

Analiza e kryer në këtë version final përmban disa ndryshime nga dokumenti i nxjerrë në këshillim publik duke u fokusuar më shumë në impaktin e rregullimit të terminimit dhe aspekte të tjera të tregut që ndikohen nga trajtimi i terminimit, për një qasje më të kujdesshme rregullatore për shkak të ndryshimit të strukturës së tregut celular.

Duke reflektuar zhvillimet në treg gjatë vitit 2017, bazuar në parimin e proporcionalitetit të përcaktuar në ligjin 9918 dhe direktivat dhe rekomandimet e KE/BEREC, AKEP gjykon se masat rregulluese për FNT për terminimin e thirrjeve të vijojnë të zbatohen për të tre operatorët sipas vendimeve të analizës së tregut 2014, të ndryshuara, pra të gjitha detyrimet të përcaktuara më sipër.

### **Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39)**

Ky detyrim i përcaktuar dhe pershkruar në nenin 39 të Ligjit, për FNT në terminimin e thirrjeve, do të vijojë të zbatohet sipas përcaktimeve të kryera në analizat e mëparshme, si dhe në analizën e vitit 2014, dhe përfshin edhe detyrimin e mos-diskriminimit në tarifën me pakicë të thirrjeve on-net/off-net. AKEP gjykon se vazhdimi i zbatimit të kësaj mase është i nevojshëm, pasi pavaresisht ndryshimeve të ndjeshme në strukturën e thirrjeve celulare, të evidentuara në këtë dokument, në mungesë të këtij detyrimi operatorët celularë do të kishin stimulim të rikthimit në praktikën tarifore të mëparshme. Kjo theksohet akoma më shumë nga fakti se megjithë ndryshimet e vëna në strukturën e thirrjeve dhe rritjen e ndjeshme të thirrjeve off-net, pjesët e tregut në treguesit kryesorë nuk kanë pësuar ndryshime të ndjeshme. Sic është theksuar në vendimet e mëparshme kjo masë rregulluese përfshin detyrimet e mëposhtme:

*Sipermarrësi X ndalohet të aplikojë tarifa në nivel me pakicë që kanë efekt diskriminues për sipërmarrësit e rrjeteve të tjera celulare kombëtare:*

- (1) tarifën e thirrjeve drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare nuk duhet të jenë më të larta se tarifën e thirrjeve brenda rrjetit;*

- (2) *Sasia e minutave brenda rrjetit të përfshira në oferta/pagesë fikse të paketave tarifore nuk duhet të jetë më e madhe se sasia e minutave drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare;*
- (3) *Përcaktimet e pikave 1 dhe 2 më sipër aplikohen për të gjitha paketat tarifore standarte, ofertat, shportat, opsionet dhe skontot të ofruara për pajtimtarët.*

Detyrimi për aplikim të tarifave të njëjta me pakicë on-net/off-net nënkupton që edhe ofertat/shportat/opsionet apo skontot në teresi duhet të kenë nivel të njëjta on-net/off-net: tarifa dhe/ose sasi minutash të përfshira në oferte/pagese fikse.

Njekohesisht AKEP gjykon që të vijojë edhe aplikimi i masave të tjera rregulluese për kohezgjatjen e ofertave sipas përcaktimeve në analizen e vitit 2014, pasi edhe kjo masë ka dhënë efekt në reduktimin e numrit të përveç të madh të ofertave të operatoreve celularë që krijojnë konfuzion dhe pasiguri tek përdoruesit fundorë.

Aplikimi i detyrimit të mesipër është i drejtperdrejtë, i thjeshtë dhe ka rezultuar shumë efikas në ndryshimin e strukturës së thirrjeve, që sipas të dhënave rezultoi se ka qenë shumë e deformuar në mungesë të këtij detyrimi.

Ndërkohë, në ndryshim nga analiza në vitin 2014, dhe nga dokumeti në këshillim publik, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe ndryshimeve të ndodhura në treg gjatë kësaj periudhe (2014-2017), të evidentuara në këtë version final të analizës së tregut, AKEP vlerëson se ekzistojnë kushtet që zbatimi i masës rregulluese të mos-diskriminimit në tarifën me pakicë të thirrjeve on-net/off-net të përfshihet në një diskutim më të gjerë, për shkak të lidhjes indirekte të kësaj mase me detyrimet për FNT në tregun me pakicë celular, ku ky detyrim mund të vendoset vetëm për operatorët që kanë dominancë apo FNT edhe në tregun përkatës me pakicë celular. AKEP gjykon që tre operatorët të vijojnë zbatimin e kësaj mase, ndërsa rishikimi i proporcionalitetit të saj për secilin operator do të kryhet në kuadër të analizës së tregut me pakicë celular dhe tregjeve të tjera të justifikuar për ndërhyrje ex-ante që do kryejë AKEP me këshillim publik në muajt në vijim.

### **Detyrimi për kontroll i tarifave (Neni 45)**

AKEP në analizën e fundit të tregut celular ka dhënë detaje për procesin e rregullimit të tarifave të terminimit dhe metodën e rregullimit të tyre, përfshirë zbatimin e Rekomandimit të Komisionit Europian të datës 7 Maj 2009 (2009/396/EC),<sup>27</sup> nëpërmjet metodës benchmark me tarifën mesatare të vendeve që kanë aplikuar metodën e kostove BU-LRIC e pastër.

AKEP gjykon se masa rregulluese e kontrollit të tarifave të terminimit të tre operatoreve me FNT është e nevojshme, pasi në mungesë të saj secili operator, që është monopolist në ofrimin e terminimit të thirrjeve në rrjetin e vet, do kishte stimulim për të aplikuar tarifa të larta të terminimit në dem të konkurrencës dhe interesave të konsumatorëve. Vlen të theksohet se në gjithë proceset e analizave të tregut celular, vendosja e kësaj mase rregulluese nuk ka pasur kundërshtime nga operatorët. Operatorët kanë kundërshtuar nëpërmjet komenteve, ankimeve administrative apo në

---

<sup>27</sup> COMMISSION RECOMMENDATION of 7 May 2009 on the Regulatory Treatment of Fixed and Mobile Termination Rates in the EU (2009/396/EC)

rruge gjyqesore kryesisht nivelin e tarifës së terminimit të përcaktuar nga AKEP, por jo vetë masën rregulluese të kontrollit/rregullimit të kësaj tarife.

Sic është theksuar në hyrje të këtij dokumenti final të analizës, AKEP zhvilloi një proces të vecantë këshillimi publik, në përputhje me përcaktimet e nenit 57 e në vijim të Ligjit 9918 duke nxjerrë në këshillim publik dokumentin “Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – Këshillim Publik”<sup>28</sup>, i cili përmbante propozimet e AKEP në lidhje me metodën e kontrollit të tarifave të terminimit të sipërmarrësve të propozuar për status me FNT në këshillin publik të analizës së tregut.

Bazuar në ndryshimet ndodhura në treg si dhe në dokumentin e rishikuar të MTR, AKEP gjykon që të nisë një proces të vecantë këshillimi publik për përcaktimin e MTR të tre operatorëve celularë të përcaktuar me FNT sipas këtij dokumenti. Tre operatorët do të vijojnë me MTR ekzistuese deri në afatet e përcaktuara nga AKEP nëpërmjet vendimeve që do merren pas ri-nxjerrjes në këshillim publik të dokumentit “Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – Këshillim Publik”, i cili është ndryshuar për të marrë në konsideratë zhvillimet e tregut në Shqipëri, MTR në vendet e BEREC etj.

### **MTR për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare përfshirë drejt numrave të portuar**

Bazuar në vlerësimin e kryer në këtë dokument final të analizës së tregut, përfshirë një vlerësim më të detajuar të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, AKEP gjykon të lërë të pandryshuar përkufizimin e tregut përkatës për terminimin e thirrjeve, pra që ai të përfshijë vetëm thirrjet kombëtare. Vlerësimi nëse terminimi i këtyre thirrjeve përbën një treg të vecantë përkatës, si dhe për nevojën ose jo të rregullimit ex-nate apo zgjidhje mosmarrveshje të tij, do të vlerësohet nga AKEP në procesin e ri të analizës së tregut celular, me pakicë dhe tregjet e tjera të justifikueshme për ndërhyrje ex-ante, që do të fillojë së shpejti nga AKEP sipas procedurave përkatëse në ligjin 9918 dhe Rregulloren e Analizës së tregut, duke marrë në konsideratë gjithashtu (sipas Ligjit 9918) të gjitha rekomandimet e KE dhe BEREC.

AKEP gjykon të heqë rregullin për barazimin e MTR të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare drejt numrave të portuar (kur këto përcillen nga operatori dhurues tek operatori marrës) me MTR kombëtare. Ky de-rregullim është në linjë me trajtimin rregullator të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, ku operatorët nuk kanë FNT që prej vitit 2012, si dhe me praktikën ndërkombëtare.

Pra operatori marrës ka të drejtë të aplikojë MTR për këto thirrje (drejt numrave të portuar në rrjetin e tij) si edhe për thirrjet e tjera ndërkombëtare, pra në negociatën komerciale me operatorin dhënës. Nëse palët nuk bien dakort, AKEP do të zgjidhë mosmarrveshjet dhe/ose do të nxjerrë tarifa referencë bazuar në informacionin mbi tarifat e aplikuar për MTR ndërkombëtare nga operatorët.

Rregullimi aktual i MTR të thirrjeve të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare drejt numrave të portuar (kur këto përcillen nga operatori dhurues tek operatori marrës) është kryer me vendimet për miratimin e ofertave referencë të operatorëve celularë (dhe fiks për analogji), dhe që ndryshimi të

---

<sup>28</sup> Vendim nr. 2700, datë 22. 12. 2016 për “Miratimin për Këshillim Publik të Dokumentit: Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – Këshillim Publik”

hyjë në fuqi do të duhet të ndrsyhohen oferta referncë të operatorëve për këto thirrje (përcaktimi barazmit të MTR të këtyre thirrjeve me MTR të thirrjeve kombëtare).

Pas miratimit të këtij dokumenti secili nga operatorët mund të depozitojë në AKEP ndryshimet e RIO-s përkatëse sipas përcaktimeve në ligjin 9918 dhe Rregullores së Akses dhe Interkoneksionit.

**AKEP gjykon që masat rregulluese per FNT të përcaktuara në këtë dokument janë të arsyetuara, propcionale me problemet e identifikuara dhe i shërbejnë objektivit rregulator të rritjes së konkurrencës në treg, investimeve, inovacionit dhe përfitimeve të përdoruesve.**

# ANEKS 1. Komentet e Këshillimit Publik për Analizën e Tregut dhe Qendrimi i AKEP

---

AKEP me VKD Nr. 2699, datë 01.12.2016 miratoi publikimin e dokumentit “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare–Këshillim Publik*”. Dokumenti u publikua në faqen e Internetit të AKEP dhe këshillimi publik u krye në periudhën 7.12.2016-7.02.2017.

Bazuar në kërkesën e Vodafone Albania, Këshilli Drejtues i AKEP në mbledhjen e datës 16.02.2017, vendosi për shtyrjen e periudhës së këshillimit publik të këtij dokumenti si dhe dokumentit “*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – Këshillim Publik*” për një afat maksimal jo më shumë se 60 ditë nga data 16.02.2017. Njoftimi për shtyrjen e afatit të këshillimit publik u publikua në faqen e Internetit të AKEP dhe i’u dërgua në rrugë shkresore palëve kryesore të interesuara.

Në përfundim të periudhës së këshillimit publik në AKEP depozituan komentet:

- Autoriteti i Konkurrencës nëpërmjet shkresës Nr.406/1 Prot., datë 7.02.2017 (referenca e AKEP Nr.1907/7 prot., datë 9.02.2017);
- Telekom Albania sh.a nëpërmjet shkresës me Nr. Prot. 687, datë 1.02.2017 (referenca e AKEP Nr.1907/3 prot., datë 3.02.2017);<sup>29</sup>
- Albtelecom sh.a nëpërmjet shkresës me Nr. 893 Prot., datë 7.02.2017 (referenca e AKEP Nr.1907/4 prot., datë 7.02.2017)<sup>30</sup>;
- Plus Communication sh.a. nëpërmjet shkresave me Nr.Prot. 132, datë 7.02.2017 (referenca e AKEP Nr.1907/5 prot., datë 7.02.2017) dhe Nr.Prot 517, datë 15.05.2017 (referenca e AKEP Nr.1907/10 prot., datë 16.02.2017);
- Vodafone Albania sh.a nëpërmjet shkresës me Ref. LEA 045/0X, datë 15.05.2017 (referenca e AKEP Nr.1907/11 prot., datë 17.05.2017);
- Neofone nëpërmjet shkresës me Nr.305 Prot., datë 4.03.2017 (referenca e AKEP Nr.1050 prot., datë 5.04.2017).

AKEP me shkresën nr.2285 prot., datë 16.12.2017 i kërkoi operatorëve celularë Vodafone Albania, Albtelecom dhe Telekom Albania që në vijim të përfundimit të procesit të konsolidimit të tregut celular, brenda datës 15.01.2018, të depozitojnë komentet finale në lidhje me dy dokumentat e nxjerrë në këshillim publik në Dhjetor 2016. Tre operatorët celularë kanë depozituar qëndrimet finale të depozituara në AKEP me shkresat e mëposhtëme:

- Telekom Albania me shkresën nr.8237/1 Prot, datë 11.01.2018 (referenca e AKEP Nr.2285/1, datë 12.01.2018);

---

<sup>29</sup> Konfirmuar dhe me shkresën Nr. Prot. 688, datë 15.05.2017 (referenca e AKEP Nr.1907/12 prot., datë 17.05.2017).

<sup>30</sup> Konfirmuar nëpërmjet shkresës me shkresës me Nr. 3402 Prot., datë 18.05.2017 (referenca e AKEP Nr.1907/13 prot., datë 19.05.2017).

- Albtelecom me shkresën nr.263 Prot, datë 12.01.2018 (referenca e AKEP Nr.2285/2, datë 12.01.2018);
- Vodafone Albania me shkresën Ref. LEA/003/OX, datë 15.01.2018 (referenca e AKEP Nr.2285/3, datë 16.01.2018).

AKEP i falenderon të gjithë pjesëmarrsit në këtë proces këshillimi për komentet dhe sugjerimet e dhëna në komunikimet cituara më sipër.

Në dokumentin e nxjerre në këshillim publik, AKEP kishte hartuar disa pyetje për të marrë opinionin e palëve të interesuara. Ky Aneks më poshtë përmban komentet e dërguara nga palët e interesuara dhe qëndrimin e AKEP mbi komentet. Për orientim dokumenti më poshtë është stukturuar në këtë mënyrë:

#### I. Komente të përgjithshme

Kjo pjesë përmban komentet e dhëna nga palët e interesuara në përgjithësi për dokumentin, dhe jo në mënyrë specifike për pyetjet e këshillimit publik, si dhe qëndrimi i AKEP për këto komente të përgjithshme.

#### II. Komentet sipas pyetjeve të këshillimit publik

Kjo pjesë përmban komente e palëve të interesuara të grupuara sipas pyetjeve të këshillimit public dhe qëndrimi i AKEP për komentet për çdo pyetje.



## **I. Komete të përgjithshme dhe qëndrimi i AKEP**

**Autoriteti i Konkurrencës** nëpërmjet shkresës Nr.406/1 Prot., datë 7.02.2017 nuk ka bërë komente mbi pyetësin, por nga vlerësimi i dokumentit të analizës i rekomandon AKEP-it,

- të kryejë vlerësimin nëse në tregun celular të pakicës ka ose jo operator me FNT dhe në rast se konstatohet, të ndërmarrë masat e nevojshme për rregullimin e këtij tregu;
- nëse vëren sjellje abuzimi me pozitën dominuese në tregun celular me pakicë të ndonjë operatori, në zbatim të nenit 61, pika 2 të Ligjit Nr. 9918/2008, ta parashtrojë rastin përpara AK.

**Telekom Albania** në përgjigjen e tij me shkresën nr.8237/1 Prot, datë 11.01.2018 (referenca e AKEP Nr.2285/1, datë 12.01.2018) sugjeron që për shkak të zhvillimeve të ndodhura në tregun celular dokumenti i analizës së tregut celular dhe rregullimit të tarifave (MTR) të zgjerojë fushën e analizës së tij, për të evidentuar më qartë shkaqet e rënies së të ardhurave që lidhen me sjelljen e operatorëve në treg, ku TA vlerëson se një numër i ndjeshëm ofertash janë hedhur në treg duke mos refelktuar koston e shërbimeve (nën kosto), e cila sipas TA dëmton konkurrencën në treg, por në mënyrë të vecantë perspektivën e investimeve dhe modernizimin e shërbimeve.

**Albtelecom** me shkresën nr.263 Prot, datë 12.01.2018, ka dërguar komentet finale për dokumentat e nxjerrë për këshillim publik për “Analizën e Tregut Celular” dhe “Rregullimit të Tarifave të Terminimit Celular” duke mos dhënë komente për secilën pyetje, por duke u shprehur në tërësi për dokumentat me komentet e mëposhtme:

- Albtelecom, kërkon që në dokumentin final të Analizës së Tregut, të merren në konsideratë efektet dhe impakti i realizimit të përqëndrimeve të operatorëve VA dhe TA, miratuar me Vendimet 484/2017 dhe 485/2017 të Autoritetit të Konkurrencës dhe vendimet 20/2017, 21/2017 dhe 22/2017 të AKEP. Pra përfundimet e analizes finale të përcaktojnë kushte dhe detyrime të vecanta mbi operatorët VA dhe TA, si rezultat i avantazheve të dukshme në tyre në treg, pasi janë pajisur me spektrin e frekuencave të Plus.
- Bazuar në pjesët aktuale të tregut, pas daljes nga tregu të operatorit Plus e kanë rritur ndjeshëm dominancën e dy operatorëve VA dhe TA, të cilët zotërojnë së bashku mbi 80% të tregut. Ndaj, në kuadër të mbrojtjes dhe nxitjes së konkurrencës së ndershme dhe në kuadër të parimit të proporcionalitetit në vendosjen e masave rregulluese, AKEP duhet të lejojë një asimetri të arsyeshme për Albtelecom dhe përjashtimin e tij, si operator më i vogël në treg, nga detyrimi i aplikimit të detyrimit të mos-diskriminimit të tarifave për thirrjet on-net/off-net.
- Bazuar në pjesët aktuale të tregut, dhe në qasjen lineare të lidhjes së MTR me pjesët e tregut, Albtelecom sugjeron që MTR të jetë 5.82 për Albtelecom, 3.82 për TA dhe 1.48 për VA. Albtelecom në rrugë elektronike me email ka dërguar dhe një dokument me sqarime në lidhje me përcaktimin e MTR-se se operatorëve celulare bazuar në funksion linear dhe pjesët e tregut. Në këtë dokument Albtelecom sqaron se si mund të lidhen MTR me pjesët e tregut të operatorëve dhe duke marrë të dhënë MTR të Vodafone dhe të Plus dhe pjesët e tregut, shpjegon si ka arritur në vlerat e sugjeruara të MTR më sipër. Ndërkohë nëse përdoren pjesët e tregut të Tremujorit 2 2017 të pajtimtarëve aktivë, Albtelecom sugjeron se MTR sipas formulës duhet të jenë 5.68 për Albtelecom, 3.28 për TA dhe 1.48 për VA.
- Pozita dominuese në treg e dy operatorëve të mëdhenj e ka kushtëzuar Albtelecom që të jetë “ndjekës” dhe “net payer” ndaj tyre, për shkak të balancave të trafikut, ku trafikur dalës ka qënë gjithmonë më i

lartë se tafiku hyrës. Si rezultat i saj Altelecom, kërkon nga AKEP që të garantojë që ky element të mos kufizojë nxitjen e konkurrencës dhe të mos shërbejë për rritjen e mëtejshme të dominancës në treg të VA dhe TA.

- Altelecom kërkon që të përcaktohen cmime dysHEME për operatorët FNT për të eliminuar çmimet shkatërruese në tregun celular, duke sjellë si shembull Autoritetin Rregullator të Turqisë, ku rregullimi me cmime dysHEME i shoqëruar me tarifa asimetrike terminimi është aplikuar për pesë vjet, ndërsa vijon ende aplikimi I tarifave asimetrike të MTR.
- Altelecom kërkon ndërhyrje rregullatore për terminimin indirekt të trafikut ndërkombëtar drejt numrave të portuar, duke theksuar se operatori që është pronar i ri i numrave të portuar duhet të ketë të drejtën të terminojë thirrjet ndërkombëtare drejtpërdrejt te këto numra.
- Altelecom sugjeron që implementimi i masave të propozuar prej tij të jetë në mënyrë të njëkohshme me qëllim sigurimin e konkurrencës së drejtë, dhe se në vijim të rekomandimeve të AK (vendimet e miratimit të Autorizimit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet transferimit të spektrit të Plus te Vodafone dhe Telekom Albania), të shpallë Vodafone dhe Telekom me FNT në tregun me pakicë të thirrjeve celulare dhe vendosjen e masave rregulluese përkatëse, me qëllim korrektimin e situatës duopol të krijuar nga Vodafone dhe Telekom Albania (të paktën 10 vjet mbi 80% të tregut). Në të njëjtën kohë, me sjelljen e tyre në treg, VA dhe TA kanë penguar operatorët e vegjël të konkurreojnë në një mjedis të drejtë, dhe kur për pasojë operatori më i vogël në treg, Plus, u detyrua të dilte nga tregu për shkak se nuk arriti t'i mbijetonte konkurrencës agresive të krijuar nga sjellja duopoliste e Vodafone dhe Telekom Albania.

## **Qëndrimi i AKEP**

AKEP në përmbledhjen ekzekutive të këtij versioni final të analizës së tregut ka sqaruar se për të reflektuar zhvillimet në treg gjatë vitit 2017, si konsolidimi i tregut celular nga 4 në 3 operatorë, impakti i masave rregulluese dhe proporcionaliteti i tyre etj, AKEP me miratimin e këtij dokumenti do të nisë dy procese të reja këshillimi publik:

- *“Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – Këshillim Publik nr.2.*  
Ky dokument i miratuar për këshillim publik me Vendim nr. 2700, datë 22. 12. 2016 të AKEP së bashku me përditësimet dhe ndryshimet e kryera pas këshillimit publik, do të hidhet përsëri në këshillim publik me afat 30 ditë (sipas nenit 57);
- *“Analizë e tregut celular: tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit, tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë të shërbimeve celulare-Këshillim Publik”.*  
Ky dokument do të përfshijë ri-vlerësimin e AKEP për tregun me pakicë celulare dhe gjithë tregjet e tjera justifikueshme për ndërhyrje ex-ante pas ndryshimeve të strukturës së tregut celular dhe rekomandimeve të AK, përfshirë një diskutim më të gjerë për rishikimin ose jo të masës rregulluese të mos-diskriminimit në tarifatat me pakicë on-net/of-net dhe terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare. Procesi i këshillimit publik do jetë 2 muaj sipas nenit 34 të ligjit 9918.

## **II. Komentet sipas pyetjeve të këshillimit publik dhe qëndrimi i AKEP**

## **1. A ka pasqyruar drejt AKEP zhvillimet në tregun me pakicë të shërbimeve celulare?**

### **TELEKOM ALBANIA**

TA gjykon se zhvillimet në tregun me pakicë të shërbimeve celulare janë pasqyruar në menyrë të drejtë në këtë dokument dhe në lidhje me këtë përshkrim nuk ka për të shtuar apo evidentuar ndonjë element të ri shtesë. Ecuria në tregun me pakicë të shërbimeve celulare gjatë periudhës 2014-2016 ka qenë dinamike në disa aspekte, në vijimësi të konkurrencës së lartë të evidentuar edhe përpara kësaj periudhe, gjë që tregon një mjedis të fortë konkurrues i karakterizuar nga një sërë faktorësh, duke përmendur disa tregues statistikorë, gamën e gjerë të paketave të integruara, investimet në teknologji 3G/4G, duke rritur volumin e trafikut data. Rritja e konkurrencës në tregun me pakicë ka sjellë përfitime për përdoruesit duke përmbytur pritshmëritë e tyre të konkurrencës në tregun me pakicë, terma të cmimit dhe përdorimit të shërbimeve celulare. Operatorët kanë aplikuar dhe vazhdojnë të aplikojnë politika tarifore shumë favorizuese dhe racionale të diferencuara. Gjithashtu, reduktimi i tarifave me pakicë si dhe ndërhyrja rregulluese e AKEP në tregun me pakicë, krahas rritjes së përfitimit të përdouesve fundorë, ka ndikuar ndjeshëm në reduktimin e të ardhurave të operatorëve dhe të treguesve të tjere financiare të cilat kanë pasoja negative në investime dhe në kontributin në buxhetin e shtetit. Në konkluzion, TA mendon që këto zhvillime dhe dinamika të tregut celular retail, i cili ka qenë mjaft konkurrues edhe përpara rregullimit të tij nga AKEP si pasojë e aplikimit të mos-diskriminimit midis tarifave dhe thirrjeve on-net/off-net, pritet të vazhdojnë dhe në të ardhmen si pasoje e nivelit të lartë të konkurrencës midis operatorëve dhe të evolucionit të shpejtë dhe investimeve në rritje në teknologji nga ana e tyre, duke pasur si prioritet kryesor interesat e abonenteve.

### **VODAFONE ALBANIA**

Vodafone (VA) mbështet perfundimin e AKEP se tregu i pakices i shërbimeve të telefonise celulare është konkurrues dhe nuk i pëmbush kushtet për të qenë i rregulluar ex-ante. Edhe përse i takon testit të 3 kritereve, Vodafone Albania gjykon që tregu me pakice i shërbimeve në rrjetet celulare nuk plotëson ato dhe nuk konsiderohet si treg i justifikueshem për ndërhyrje ex-ante.

VA shprehet se karakteristikat e tregut të pakices së telefonise celulare në Shqipëri pasqyrojnë një treg konkurrues dhe dinamik. Ka një sërë faktorësh të cilët mbështesin ekzistencën e konkurrencës në treg ku përfshihen: ulja e çmimeve të pakices që dëshmon përfitime për konsumatorët, ulja e të ardhurave dhe normes së fitimit të Vodafone përkundrejt rritjes së të ardhurave për operatorët me të vegjël, rritja e përdorimit të shërbimeve të telefonise së levizshme, niveli i lartë i churn-it vjetor për Vodafone, shifrat e larta të portabilitetit të numrit, rritja thelbësore e trafikut off-net përkundrejt rënies së trafikut on-net dhe aftësia e konkurrentëve jo vetëm që t'iu kunderspergjigjen tarifave të VA, por të ofrojnë sistematikisht çmime edhe me të ulëta.

Vodafone shprehet se me zhvillimet e fundit dhe me daljen e operatorit Plus nga tregu, përsëri ky treg do të vazhdojë të mbetet konkurrues dhe operatorët e mbetur do të kenë mundësi të jenë edhe më eficientë e të ulin kostot e ofrimit të shërbimit falë ekonomisë së shkallës. Për më tepër, tregu i pakicës, tanimë i përbërë nga tre operatorë celularë që do të kenë mundësinë të konkurrojnë në kushte të barabarta do të sjellë një konkurrencë të ndershme, ku operatorët do të jenë të lirë të investojnë në inovacion, e perkthyer kjo në shërbime më cilësore dhe më pranë nevojave të pajtimtarëve.

Njekoherisht këto dy vitet e fundit tregojnë një rritje të qëndrueshme të trafikut të të dhenave, sidomos përse i takon trafikut VoIP, ku vihet re që kjo % (trafik i të dhenave VoIP përkundrejt trafikut të përgjithshëm të të dhenave) në Shqipëri është disa here më e lartë se mesatarja e BE (8% në Shqipëri

perkundrejt 1.4% ne Europe, sipas te dhenave te Vodafone Group). Kjo eshte theksuar edhe me shume pas lancimit te thirrjeve VoIP nepermjet aplikacionit Ehsatsapp ne Nentor 2016. E njejta gje mund te thuhet edhe per trafikun e mesazhimit nepermjet te dhenave ne internet, ku serish ne menyre te ngjashme me qasjen ne nivel European vihet re nje rritje e larte konsumi. Theksojme se keto zhvillime stimulohen sidomos nga prezenca e rrjetit 4G, ku qartesisht perdoruesit e rrjetit 4G konsumojne me shume trafik te dhenash se perdoruesit e rrjeteve 3G dhe GSM.

Ndryshe nga sa shprehet AKEP ne document se “devijimi i perdoruesve nga pas-pagim ne parapagim ka ardhur si pasoje e eliminimit te grupeve te mbyllura”, Vodafone eshte e mendimit se devijimi i perdoruesve nga pas-pagim ne parapagim nuk ka ardhur si pasoje e eliminimit te grupeve te mbyllura, si faktori i vetem; ne gjykojme se jane nje sere arsyes qe mund te kene ndikuar ne sjelljen konsumatore pergjate kesaj periudhe ku mund te permendim p.sh. pamundesia per pagese, mungesa e mundesive/deshires per angazhim afatgjate nga ana e konsumatoreve, informaliteti ekonomik, mungesa e adresave, mungesa e aksesit ne sherbime bankare, mungesa e nje oferte te qarte dhe te diferencuar per klientet biznes (ndryshe nga oferta per konsumatoret) nga ofruesit e sherbimit, mungesa e segmentimit te mire te klienteve me paspagim dhe profilizimit perkates te produkteve nga ana e operatoreve sherbim-ofrues, etj. Per te zbuluar shkaqet e verteta nevojitet nje analize shteruese; vetem keshtu do mund te adresohen ne menyre korrekte problemet dhe te arrihet nje zgjidhje e qendrushme dhe afatgjate.

Ne fakt, duhet theksuar se segmenti i tregut te pajtimtarëve biznes (jo konsumatore) fatkeqesisht është një segment që është anashkaluar deri me tani nga Grupet e Punes që merren me analizat e tregut. Kjo eshte e kuptueshme persa kohe qe mbi 90% e perdoruesve te sherbimeve te komunikimit elektronik jane konsumatore dhe vemendja e organit rregullator afermendsh eshte e fokusuar ne ta. Por nga ana tjeter, ne gjykojme se ka ardhur koha qe segmentit biznes ti jepet nje vemendje dhe theks i vecante pasi vetem ata jane ne gjendje te ushtrojne presion mbi operatoret e sherbimeve dhe te nxisin tregun ne teresi per te dizenuar produkte dhe sherbime te reja inovatore dhe te personalizuaruara pertej atyre masive zanore, SMS dhe data. Shpesh-here segmentet konsumatore dhe biznes ngaterrohen me segmentet para dhe pas-pagim (kontrate) cka nuk eshte korrekte. Kjo eshte nje indikator i rendesise se ulet qe i jepet ketij grupi perdoruesish dhe mos-njohjes se specifikave qe kane. Pajtimtaret biznes kane nevojte per sherbime te profilizuara qe per nga vete perkufizimi nuk mund te cilesohen si sherbime te natyres publike, e per rrjedhoje nuk mund te trajtohen ne menyre te padiferencuar nga sherbimet qe i ofrohen segmentit konsumator ne nje analize tregu pakice. VA sugjeron qe ne dokumentin final AKEP te përfshijë një analizë të posaçme dhe të veçantë për këtë segment e specifikat e tij dhe në të ardhmen të shqyrtojë e diskutojë me aktorët e interesit në nivel industrie kush janë faktorët realë që kanë çuar në tkurrjen e ketij segmenti, si mund të adresohen ata dhe se si mund të promovohet më tej rritja në vlerë dhe volum e segmentit biznes, përfshirë këtu lejjimin e thirrjeve brenda rrjeteve të mbyllura VPN.

## **ALBTELECOM**

Zhvillimet e tregut me pakice të shërbimeve celulare janë trajtuar përgjithësisht drejt dhe gjerësisht në seksionet III.1-III.7 të dokumentit të analizës duke vënë në pah disa dukuri kryesore, si:

- Rritjen e vogël të numrit të pajtimtarëve aktivë, c'ka tregon për një treg të maturuar, si pasoje e vendosjes dhe zbatimit të rregullit të mosdiskriminimit;
- Vijimin e një strukture solide të abonentëve me parapagim(prepaid) dhe paspagim;
- Vijimin e rritjes së numrit të abonentëve me akses broadband, si dhe të sasisë së të dhënave të shkarkuara nga abonentët celularë dhe ecuria positive si pasoje e futjes se teknologjise LTE;
- Ndryshimin thelbësor në strukturën e thirrjeve dalëse të operatorëve celularë si përta i takon uljes/reduktimit të përqindjes së thirrjeve on-net;

- Reduktimin me 12% të numrit të mesazheve të gjeneruara nga abonentët celularë, c'ka tregon për ndryshim të sjelljes së abonentëve për zëvendësimin nga dërgimi i SMS-ve në mënyrë tradicionale, në përdorimin e gjerë të aplikacioneve.

## **PLUS COMMUNICATION**

Tregu shqiptar i shërbimeve të telefonisë së lëvizshme në 2 vitet e fundit është karakterizuar nga shumë problematika, të cilat nuk janë pasqyruar në këtë dokument. Në këtë dokument është bërë një përshkrim "rozë" i situatës, sikur çdo pjesë e tregut celular ka ecur normalisht dhe vendimet e AKEP kanë dhënë efekte të dukshme në rregullimin e tij.

Me miratimin e dokumentit Final të Analizës së tregut në Nëntor 2014 dhe detyrimet që rrodhën prej tij në lidhje me asimetirin e Plus dhe masën për mosdiskriminim të tarifave të thirrjeve on/off net fillon edhe problematika e Plus në lidhje me pasqyrimin e situatës. Sipas Plus vendimet u morën bazuar në një analizë të deatjuar të tregut, rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë për vlerësimin e veprimtarisë së AKEP dhe AK për vitin 2013 dhe rekomandimeve e Komisionit të Konkurrencës për AKEP.

Bazuar vetëm në ankimimet administrative të 3 operatorëve: VA, TA dhe ALBtelecom, të ngritura mbi të njëjtat argumenta e pa asnjë ndryshim nga komentet e dhëna gjatë këshillimit publik të Analizës së Tregut nga këta operatorë dhe në kundërshtim me rekomandimet e institucioneve të mësipërme shtetërore, AKEP 4 muaj më vonë, me vendimet nr. 2542 - 2546 , datë 13.03.2015, vendosi uljen e tarifës së terminimit në rrjetin PLUS deri në barazimin e saj me tarifën e operatorëve të tjerë në datë 01.01.2016 dhe shtyrjen e implementimit të detyrimit për të barazuar tarifën brenda dhe jashtë rrjetit, duke reduktuar ndjeshëm për pjesën më të madhe të vitit 2015 të ardhurat e PLUS nga interkoneksioni, duke favorizuar hapur vetëm operatorët e mëdhenj dhe duke i shkaktuar një dëm të madh ekonomik.

PLUS ka ankimuar ne rruge administrative vendimin nr. 2542, date 13.03.2015 dhe ne vijim te rrezimit te ankimit administrativ nga AKEP, PLUS e ka ankimuar ne rruge gjyqesore kete vendim ne date 16.04.2015 duke kerkuar:

- Shfuqizimin e pjesshem te Vendimit te Keshiit Drejtues nr. 2542, date 13.03.2015 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne Vendimet e Keshiit Drejtues te AKEP me nr.2522, 2523, 2524, 2525 dhe 2526, date 06.11.2014".

Ne perfundim te procesit gjyqesor, i cili ka zgjatur rreth 11 muaj, Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Tirane me Vendimin nr. 1567 te dates 01.04.2016 ka vendosur:

- Pranimin e kerkese padise se PLUS;
- Shfuqizimin e pjesshem te vendimit nr. 2542 duke lene ne fuqi tarifen e terminimit ne rrietin PLUS ne nivelin 6.52 lek/min deri ne Analizen e rradhes se Tregut Celular;
- Shfuqizimin e shtyrjes se afatit te aplikimit te detyrimit per mosdiskriminimin tarifor brenda dhe Jashte rrjetit dhe hyrjen me efekt nga data 01.01.2015 per te gjithë pajtimtaret.

Ky vendim i Gjykates Administrative te Shkalles se Pare, i cili u ankimua nga AKEP dhe operatorët celuarë te cilat ishin pale te treta ne gjykim dhe Gjykata Administrative e Apelit Tirane me vendimin nr. 2459, date 09.09.2016, la ne fuqi vendimin nr. 1567 te dates 01.04.2016 te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane, i cili mori forme te prere, duke u bere idetyrueshem per t'u zbatuar nga te gjitha palet ne proces, si AKEP ashtu edhe palet e treta.

Referuar vendimeve gjyqesore PLUS u ka derguar ne menyre te perseriturte gjithe operatoreve mobile faturat te cilat gjenerohen nga Marreveshja e Interkoneksionit, duke kerkuar aplikimin e tarifes se terminimit 6.52 lek/min ne rrjetin PLUS per periudhat 01.04.2015, 01.07.2015 dhe 01.01.2016, tarife te cilen e percaktoi Gjykata dhe palet e aplikojne ne menyre detyruese bazuar edhe ne Marreveshjen e Interkoneksionit mes tyre. AKEP eshte vene ne dijeni ne gdo rast nga PLUS per problemet e mosshlyerjes

se faturave te Interkoneksionit midis paleve dhe ka reaguar me nje shkrese nr. 80/17, date 20.10.2016 drejtuar te gjithe operatoreve mobile "Mbi Vendimin e Gjykates Administrative te Apeit Tirane...." .

Refuzimi I zbatimit te Vendimit te Formes se prere te Gjykates nga ana e operatoreve mobile dhe mospagimi i faturave tatimore ka sjelle nderprerjen drastike te te gjitha te ardhurave te PLUS nga Interkoneksioni Kombetar dhe flukseve hyrese monetare, e per pasoje ka sjelle ndryshime drastike ne gjendjen financiare te shoqerise PLUS.

Per keto refuzime dhe sjellje te paprecedenta e te qellimshme nga ana e operatoreve mobile, duke mos zbatuar ne menyre flagrante jo vetem IVlarreveshjen e Interkoneksionit mes paleve, por edhe ne kundërshtim me kuadrin rregullator te AKEP dhe vendimeve te Gjykates ne Republiken e Shqiperise, PLUS iu drejtua AKEP, si organi rregullator dhe mbarevajtës i fushes se telekomunikacioneve, per nxjerrjen e Urdhrit perkates per zbatim nga ana e operatoreve te tarifes se terminimit te percaktuar ne rrjetin PLUS, 6.52 lek/min deri ne analizen e radhes se tregut celular, ashtu si e sanksionojne vendimet e siperpermendura te Gjykates.

Ne keto kushte ekstremisht jo normale per nje treg te rregulluar dhe monitoruar, moszbatimi I ketij vendimi gjyqësor ka bere qe PLUS te pesoje nje dem te rende e te pariparueshem pasi ka renduar poziten e shoqerise me nje humbje teper te madhe financiare, duke krijuar keshtu nje pamundesie reale per ushtrimin e aktivitetit, si dhe demtim te imazhit dhe reputacionit ne treg ndaj pajtimtareve dhe bashkepunetoreve tane.

Kjo humbje ka sjelle veshtiresi te medha, deri ne pamundesie per te permbushur detyrimet kryesore te aktivitetit si ndaj buxhetit te shtetit per kestet e Licenses 3G, e po ashtu ndaj Institucionit tuaj.

Duke qene se operatorët nuk kane zbatuar vendimet gjyqësore dhe duke qene se AKEP nuk ka nxjerre asnje akt urdherues per operatorët lidhur me zbatimin e tij, PLUS ka kerkuar ne rruge gjyqësore permbushjen e detyrimeve te siperpermendura nga secili operator, duke shpresuar qe keto procese te perfundojne shpejt, per te vendosur ne vend te drejten e pamohueshme te shoqerise sone dhe riparimin e demeve te shkaktuara. Por operatorët vazhdojne te krijojne vonesa e arsye pa fund ne shtyrjen e ketyre proceseve me qellimin e vetem dhe te kordinuar midis tyre (si ne argumenta ashtu edhe ne veprime), per krijimin e nje pamundesie financiare ekstreme deri ne nxjerrjen e PLUS nga tregu.

AKEP, eshte informuar qe ne fillimet e kesaj shtate dhe hap pas hapi per perkeqesimin e saj.

PLUS me keqardhje konstaton se AKEP nuk i eshte pergjigjur asnjehere ne menyre te drejtperdrejte kerkesave te tij per te zgjidhur kete shtate dhe per te urdheruar operatorët, qe ne perputhje me Vendimet e Gjykates, te zbatojne Marreveshjet e Interkoneksionit dhe pagesat mes tyre, por AKEP ka justifikuar veprimet e tij me argumentin se vendimet e Gjykates nuk mund te interpretohen nga ana e tij.

Ashtu sic kemi sqaruar disa here ne menyre shkresore, PLUS nuk ka kerkuar asnjehere qe AKEP te interpretojte vendimin e Gjykates, por duke qene nje vendim i formes se prere, ka kerkuar nga ky i fundit si organ rregullator, marrjen e masave per zbatim te detyrueshem dhe te menjehershëm nga operatorët, bazuar ne ligjin nr. 9918, date 19.05.2008 "Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise" dhe kuadrin rregullator ne fuqi, duke deklaruar ne menyre te qarte Tarifen e Terminimit ne rrjetin PLUS, prej 6.52 lek/min.

Vete AKEP ne faqen 20/81 te dokumentit deklaroi se: vendimet gjyqësore kane krijuar nje konfuzion ne lidhje me tarifat qe duhet te aplikohen per terminimin e thirrjeve ne rrjetin PLUS". Ky deklarim i bere tregon ne nje fare menyre se AKEP s'ka marre masat e duhura dhe te domosdoshme per rregullimin e tregut dhe vendosjen e tarifave pas kryerjes se analizave perkatese.

Persa anaizuar me lart per te gjitha kete periudhe 2 vjegare, PLUS nuk eshte dakord me perfundimet e AKEP lidhur me zhvillimet dhe ecurine e tregut celular ne Shqiperi dhe referuar ketyre deformimeve dhe mos implementimit ne kohe te masave rregulatore, PLUS gjykon qe gjate kesaj periudhe, 2014-2016, nuk kane ndodhur ndryshime te tilla qe te ndikojne ne konkluzionet e arritura ne kete analize. Do te duhet ende

kohe qe tregu celuiar te maturohet dhe te ndjeje realisht efektin e ketyre masave te filluara ne menyre te plote vetem ne 2016, mbas vendimit te Gjykates.

PLUS konsideron qe:

- Vendimi dhe arsyetimi i Analizes se tregut celuiar i vitit 2014 i lene ne force nga Gjykatat ne Republiken e Shqiperise mbetet aktual per t'u vene ne zbatim.
- Vendimi i marre nga AKEP per te kryer Analizen e tregut eshte i parakohshem dhe jo ligjor, pasi jo vetem eshte ende i pazbatuar Vendimi qe Gjykata e konsideron te drejte e ne fuqi, por edhe sig e tregon vete situata ne treg, mosapilkimi i plote i ketij vendimi ka parandaluar cdo ndryshim te pritshem nga zbatimi i tij.

Cdo tentative per te vepruar ne te kundert perben jo vetem nje veprim arbitrar te AKEP, por edhe nje sflde per verdiktin e shprehur nga ana e Gjykatave ne Republiken e Shqiperise, te cilat e konsiderojne te paarsyeshme ndryshimin e Vendimit te AKEP.

Duke qene se, vete AKEP e ka ankimuar kete vendim gjyqesor prane Gjykates se Larte dhe aktualisht ende sot ne treg nuk jane vendosur masat rregullatore te vendosura nga AKEP, do te duhej qe ky instituclon te pezullonte cdo tentative per perseritjen e nje Vendimarie te ngjashme me ate qe Giykatat kane konsideruar te pavlefshme.

## **QËNDRIMI I AKEP**

AKEP ne kete version final te dokumentit te analizes se tregut ka perditesuar informacionin ne lidhje me nje sere treguesisht te tregut qe lidhen me shumë me tregun perkatës të terminimit të thirrjeve, si struktura e thirrjeve dalëse dhe hyrëse, tregues financiare, tarifa on-net/off-net etj.

Sic është cituar në pjesën e Hyrjes së këtij dokumenti, gjatë kësaj periudhe, nga koha e nxjerrjes në këshillim publik të dokumentit të Analizës së tregut (Dhjetor 2016) dhe miratimit të këtij versioni final (Janar 2018), me daljen nga tregu të Plus Communication nga data 1.01.2018, tregu ka përjetuar një ndryshim i rëndësishëm strukturor, i cili ka ndikim në pritshmëritë e AKEP për ecurinë e tregut me pakicë celular në të ardhmen.

AKEP gjykon se për të vlerësuar më mirë efektet e daljes nga tregu të Plus në strukturën e tregut me pakicë celular si dhe në të gjitha tregjet e tjera perkatës të justifikueshme për ndërhyrje ex-ante, duhet të kryhet një analizë të vecantë tregu. Për këtë AKEP do të kryejë një proces tjetër këshillimi publik në muajt në vijim për këto tregje të tjera. Për këtë arsye, analiza së tregut me pakicë të nxjerrë në këshillim publik, përfshirë arsyet për mos-aplikim të testit të 3 kriterëve në dokumentin e nxjerrë në këshillim publik në Dhjetor 2016, nuk janë përfshirë në këtë dokument final, pasi do jenë pjesë e dokumentit tjetër të vecantë të analizës së tregut me pakicë, dhe tregjeve të tjera me shumicë që mund të konsiderohen të justifikueshme për ndërhyrje ex-ante, pas ndryshimeve të strukturës së tregut celular dhe rekomandimeve të AK, që do të fillojë së shpejti nga AKEP sipas procedurave perkatëse në Ligjin 9918 dhe Rregulloren e Analizës së tregut, duke marrë në konsideratë gjithashtu (sipas Ligjit 9918) të gjitha rekomandimet e KE dhe BEREC.

## **2. Cfarë mendoni për konkluzionin e AKEP për rritjen e përfitimeve të përdoruesve celularë në tregun me pakicë të shërbimeve celulare si thirrje telefonike, SMS, Internet?**

**TELEKOM ALBANIA**

Reduktimi i nivelit ARPU dhe ARPM gjatë 5-6 viteve të fundit është një tregues i rëndësishëm në lidhje me rritjen e përfitimeve të përdoruesve në tregun me pakicë të shërbimeve celulare, por edhe të rënies së të ardhurave të operatorëve, sipas të dhënave të AKEP. Kjo ka ardhur si rrjedhojë e uljes së vazhdueshme të cmimeve të aplikuara nga operatorët celularë nëpërmjet ofrimit të paketave të integruara (telefoni/SMS/Internet) dhe gamës së gjerë të këtyre shërbimeve. Ndërsa rënia e ARPU dhe ARPM është dhe një tregues i reduktimit të të ardhurave të operatorëve, ku një impakt negativ në këtë drejtim ka pasur edhe rregullimi i tregut retail nga AKEP nëpërmjet aplikimit të mos-diskriminimit midis tarifave dhe thirrjeve on-net/off-net, pasi si pasojë e këtij rregullimi, operatorët kanë shitur shërbimet e tyre me pakicë nën kosto nën efektin e asimetrisë së MTR-ve me operatorin PLUS, duke subvencionuar këtë të fundit në dëm të tre operatorëve të tjerë. TA ofron paketa dhe shërbime të ndryshme për thirrjet telefonike, SMS dhe Internet me cmime mjaft konkurruese për abonentet e saj në treg gjë që ka cuar në rritjen e përfitimeve dhe mundësive për të zgjedhur midis gamës së ofertave dhe shërbimeve. TA gjykon se ka pasur një rritje të përfitimeve të përdoruesve celularë në tregun me pakicë të shërbimeve celulare, sic është evidentuar dhe nga AKEP në të dhënat e paraqitura, por në të njëjtën kohë të ardhurat e operatorëve janë ulur ndjeshëm, kostot operationale nuk mund të ulen tej një niveli të caktuar, duke reduktuar në këtë mënyre mundësitë e tyre për të kryer investime në teknologji të reja, dhe gjithashtu rënia e treguesve financiare të operatorëve ka një ndikim negativ në taksat e derdhura nga ana e tyre në buxhetin e Shtetit.

## **VODAFONE ALBANIA**

VA shprehet dakord përse i takon rritjes së përfitimeve të përdoruesve celularë në tregun me pakicë të shërbimeve celulare. Kjo është rrjedhojë e konkurrencës së theksuar midis operatorëve celularë, masivizimit të shërbimeve OTT, trafikut të shtuar të të dhënave nëpërmjet rrjetit 4G, masave rregullatore të ndërmarra nga AKEP si dhe e uljeve të vazhdueshme që ka aplikuar VA në tarifatat thirrjeve zanore, SMS dhe data.

AKEP, me të drejtë në draft-dokumentin e analizës së tregut paraqet se cmimi mesatar për minute i thirrjeve celulare (ARPM) dhe e ardhura mesatare për përdorues (ARPU) në Shqipëri është më e ulët se vlerat përkatëse mesatare në BE dhe ndër me të ultat në rajon. Gjithashtu, treguesit e të ardhurave të fitimit në nivel pakice dhe shumice, kanë pësuar rënie të ndjeshme në vitet në shqyrtim, përjashto operatorin Plus. Ky është një sinjal i qartë dhe që duhet lexuar me kujdes, ndaj dhe me shumë përpjekje duhen ndërmarrë nga organi rregullator për ndihmuar nxitjen e investimeve dhe kthimin e tyre në kohë dhe jo vetëm në përfitim të konsumatorëve.

Nga ana tjetër, Vodafone gjykon se analiza e Grupit të Punës është jo e thelluar kur ai prezumon se ulja e përdorimit të SMS me 9% është pasojë e zëvendësueshmërisë nga aplikacionet OTT. Vodafone gjykon se, në mungesë të një studimi të thelluar mbi zëvendësueshmërinë e SMS me aplikacionet OTT, kjo mbetet në nivelin e një hipoteze. Patjetër që zëvendësueshmëria me aplikacionet OTT është nga faktorët, por jo i vetmi; faktorë të tjerë mund të jenë, për të përmendur disa, zëvendësueshmëria me thirrjet dalëse, përdorimi i shtuar i rrjeteve sociale (jo mesazhim) si një mjet komunikimi, ndryshimet demografike, etj. Ndaj në mendojme se AKEP duhet të investohet me në thellësi në këtë drejtim nëpërmjet analizave të brendshme empirike apo nëpërmjet konsulencës së jashtme për të arritur rezultate të qëndrueshme, pasi ato kanë impakt të rëndësishëm për vendim-marrjen rregullatore dhe zhvillimin afatgjatë të tregut.

## **ALBTELECOM**

Lidhur me pyetjen 2, Albtelecom ka konkluduar si më poshtë:

- Hyrja në fuqi e rregullit të mosdiskriminimit të thirrjeve përveçse i ka mundësuar abonentëve kryerjen e thirrjeve pavarësisht destinacionit të thirrjes, nuk e ka kufizuar aspak këtë të fundit që të ulë sasinë e thirrjeve të kryera nga secili abonent, epasqyruar kjo në rritjen e thirrjeve dalëse apo të MOU;



- Do të ishte mbase e nevojshme nxjerrja e një treguesi në minuta për thirrjet on-net/off-net për abonentë për operatorë celularë për vitin 2014, 2015 dhe Q3/2016, për të mundësuar një informacion apo një gjykim shtesë mbi përfitimin konkret të abonentit (për të mos u kycyr brenda një operatori të caktuar) e lidhur kjo e fundit direkt me fillimin e zbatimit të rregullit të on net dhe off net;
- Vijimi i uljes së ARPM dhe ARPU-së dhe kryerja e më shumë shërbime celulare nga abonentët, tregon se përfitimet e tij nga shërbimet celulare janë rritur ndërsa buxheti i tij i shpenzuar për komunikim ka ardhur në ulje.
- Ulja e përdorimit të SMS për abonentë për muaj është direkt e lidhur nga zgjedhja personale e abonentit për aplikacioneve interaktive, që i sigurojnë informacion shtesë nëse abonenti tjetër që thirret është online, e shikon SMS ose jo, etj.

## **PLUS COMMUNICATION**

Në treguesit kryesorë të shërbimeve celulare rritja kryesore vihet re në volumn total të të dhënave të transmetuara me GPRS/UMTS dhe në numrin e pajtimtarëve me akses në internet broadband UMTS. Shërbimi 3G/broadband është tepër i rëndësishëm në shërbimet celulare por PLUS arriti ti ofrojë këto shërbime pajtimtarëve të saj vetëm duke filluar nga periudha Maj-Qershor 2016, për shkak të vonesave në procedurat e dhënies së autorizimit për PLUS, kjo ka cuar në diskriminim jo vetëm operatorin por vecanërisht pajtimtarët e tij të cilët nuk kanë mundur të përfitojnë nga ky shërbim. PLUS nuk ka mundur si pasojë të konkurojë në kohë me operatorët e tjerë, fakt që reflektohet në një të ardhur të munguar të konsiderueshme.

Kjo humbje vjen si pasojë jo vetem e mosterheqjes se pajtimtareve te rinj, por edhe e largimit te vazhdueshem te pajtimtareve ekzistues, per shkakun e vetem te mosofrimit te sherbimeve 3G deri ne Maj - Qershor 2016. Kjo mungesë nuk ka lejuar që kompania të kryejë investimet e nevojshme për këte frekuencë dhe të marrë frekuencën 4G në mënyrë që të konkurojë me të drejta të njëjta me operatorët e tjerë në treg.

## **QËNDRIMI I AKEP**

Në vijim të sqarimeve për pyetjen nr.1, AKEP ne kete version final te dokumentit te analizes se tregut ka perditesuar informacionin ne lidhje me nje sere treguesisht te tregut që lidhen më shumë me tregun përkatës të terminimit të thirrjeve, si struktura e thirrjeve dalëse dhe hyrëse, tregues financiare, tarifa on-net/off-net etj.

Sic është cituar në pjesën e Hyrjes së këtij dokumenti, gjatë kësaj periudhe, nga koha e nxjerrjes në këshillim publik të dokumentit të Analizës së tregut (Dhjetor 2016) dhe miratimit të këtij versioni final (Janar 2018), me daljen nga tregu të Plus Communication nga data 1.01.2018, tregu ka përjetuar një ndryshim i rëndësishëm strukturor, i cili ka ndikim në pritshmëritë e AKEP për ecurinë e tregut me pakicë celular në të ardhmen.

AKEP gjykon se për të vlerësuar më mirë efektet e daljes nga tregu të Plus në strukturën e tregut me pakicë celular si dhe në të gjitha tregjet e tjera përkatës të justifikueshme për ndërhyrje ex-ante, duhet të kryhet një analizë të vecantë tregu. Për këtë AKEP do të kryejë një proces tjetër këshillimi publik në muajt në vijim për këto tregje të tjera. Për këtë arsye, analiza së tregut me pakicë të nxjerrë në këshillim publik, përfshirë arsyet për mos-aplikim të testit të 3 kriterëve në dokumentin e nxjerrë në këshillim publik në Dhjetor 2016, nuk janë përfshirë në këtë dokument final, pasi do jenë pjesë e dokumentit tjetër të vecantë të analizës së tregut me pakicë, dhe tregjeve të tjera me shumicë që mund të konsiderohen të justifikueshme për ndërhyrje ex-ante, pas ndryshimeve të strukturës së tregut celular dhe rekomandimeve të AK, që do të fillojë së shpejti nga AKEP sipas

procedurave përkatëse në Ligjin 9918 dhe Rregulloren e Analizës së tregut, duke marrë në konsideratë gjithashtu (sipas Ligjit 9918) të gjitha rekomandimet e KE dhe BEREC.

### **3. Cili është opinioni juaj në lidhje me efektet e masave rregulluese të mos-diskriminimit në tarifatat e thirrjeve on-net/off-net?**

#### **TELEKOM ALBANIA**

Ndryshimet e strukturës së trafikut sipas TA, duke u bazuar në dokumentin e Analizës 2014, kanë shfaqur shenja para ndërhyrjes së AKEP për mosdiskriminim të thirrjeve on net/off net. Tregu me pakicë ka evidentuar vet-rregullim nga operatorët pasi fokusi i politikave komerciale nga ana e tyre ka qënë dhe ka mbetur i orientuar pikërisht drejt eliminimit të diferencave midis tarifave brenda dhe jashtë rrjetit, gjë e cila është vërejtur e implementuar në paketat tarifore të operatorëve celularë që përpara fillimit të aplikimit të ndërhyrjes rregulluese të AKEP në këtë çështje. Kjo ndërhyrje e AKEP u përcaktua si një detyrim shtesë kur ndërkohë efektet kishin filluar të shfaqeshin më parë në treg. Edhe pse raporti i on net/off ka ndryshuar gjatë dy viteve të fundit duke u rritur ndjeshëm pesha e thirrjeve off-net, TA mbetet e mendimit që më shumë se një detyrim i AKEP, këto efekte janë rrjedhojë e konkurrencës së fortë në treg nga operatorët nëpërmjet politikave të tyre tarifore. Për të argumentuar këtë TA i referohet edhe dokumenti për këshillim publik SHU, ku AKEP shprehet për tarifa dhe paketa të përballeshme dhe të arsyeshme.

Masat rregulluese të mos-diskriminimit në tarifatat e thirrjeve on-net/off-net kanë shërbyer më shumë si një barrë më tepër për operatorët në treg, pasi konkurrenca në tregun me pakicë ka qënë mjaft efikase, duke qënë se TA por edhe operatorët tjerë kishin marrë në konsideratë rekomandimet dhe indikacionet e dhëna nga Autortiteti i Konkurrencës në paketat dhe planet e tyre tarifore si dhe një mjet për suvencionimin e Plus. Gjithashtu, masat rregulluese të mosdiskriminimit on-net/off-net funksionojnë vetëm nëse aplikohen në kushtet e simetrisë së plotë midis MTR-ve të operatorëve, gje e cila nga ana e AKEP është ndërmarrë e shoqëruar me asimetri të tarifave të terminimit ndërmjet Plus Communications dhe tre operatorëve TA, VF dhe Albtelecom. Niveli i asimetrisë së MTR-ve u përcaktua në mënyrë të prerë me anë të Vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, datë 09.09.2016 duke lënë në fuqi tarifën 6.52 lek/min në rrjetin e Plus, ndërsa AKEP ndërhyri më pas me anë të vendimit nr.2664, datë 14.01.2016 duke zgjatur edhe për tre muaj të tjerë asimetrinë (kur ndërkohë me anë të vendimit nr.2542, dt.13.03.2015 ishte përcaktuar me anë të glide-path-it të MTR-ve që simetria të fillonte me datë 1.01.2016), ndërkohë që nuk ndërhyri për heqjen rregullimit të retail. Në të tilla rrethana, aplikimi i rregullimit të retail nuk ka funksionuar dhe ka dëmtuar rëndë të tre operatorët në favor të Plus Communication, pasi janë gjendur në kushtet e ofrimit nën kosto të paketave dhe shërbimeve për thirrjet e pajtimtarëve drejt rrjetit të këtij operatori, duke marrë parasysh këtu dhe konkurrencën gjithnjë e më agresive të tregut me pakicë. TA gjykon se aplikimi i masave rregulluese të mos-diskriminimit on-net/off-net shoqëruar me asimetrinë e tarifave të terminimit ka deformuar konkurrencën në tregun me pakicë, duke sjellë diskriminim në trajtimin midis Plus dhe tre operatorëve të tjerë, pasi është subvencionuar Plus në mënyrë të padrejtë në kurriz të konkurrencës dhe duke e mbajtur kështu artificialisht në treg, duke qënë se thirrjet drejt Plus tarifohen me 6.52 leke/min ndërsa nga Plus drejt rrjeteve të tjerë celularë me 1.48 lek/min. Është e rëndësishme për t'u theksuar që operatori Plus ka operuar me humbje që në momentin e hyrjes në treg për shkak të keqmenaxhimit dhe paaftësisë për të qënë konkurrues në treg dhe pikërisht në vitin 2015, ka pasur fitim pozitiv në sajë të nivelit të asimetrisë së përmendur më sipër. Efekti financiar i TA për periudhën Janar- Mars 2016 në të cilën u pezullua simetria e plotë ishte 141,114 Euro si kosto shtesë, ndërsa vetëm për muajt Shtator – Tetor 2016 pas vendimit të gjykatës administrative të Apelit, impakti financiar për TA është -426,580 Euro kosto shtesë. Të gjendur në këto kushte të një asimetrie shumë të lartë dhe në të njëjtën kohë në një rregullim të retail pa diferencim on net-off net në volume dhe cmime, AKEP urgjentisht duhet të hiqte rregullimin e retail për TA dhe operatorët e tjerë.

## **VODAFONE ALBANIA**

Karakteristikat e tregut të pakicës së telefonisë celulare në Shqipëri, pasqyrojnë një treg konkurrues dhe dinamik që shfaq karakteristika identike me tregjet e përparuar dhe konkurrues në Europë. Prandaj AKEP duhet të nderhyjë vetëm në tregun e shumicës, pra atë të terminimit të thirrjeve në rrjete celulare individuale duke orientuar tarifat në kosto – vetëm kështu do të garantojë ligjshmëri dhe rezultate konkrete në tregun e pakicës.

Vodafone shprehet kundër ndërhyrjeve në tregun e pakicës, si sjellje e pambështetur në legjislacion, e papërkrahur nga praktikat Europiane dhe e pajustificuar nga specifikat e tregut. Ndërhyrjet rregullatore në tarifat e tregut të pakicës janë të papranueshme nga legjislacioni i KE dhe demtojnë konkurrencën dhe avantazhet për përdoruesit fundore. Ndaj dhe VA i kërkon AKEP që të mbajë në vëmendje kuadrin rregullator vendas dhe atë europian, ti referohet eksperiencës së huaj ku rezulton që asnjë vend nuk ndërhyr në tregun e pakicës të telefonisë celulare (përfshirë këtu barazimin on/off-net), dhe të promovojë konkurrencën e ndershme dhe efektive në treg vetëm nëpërmjet mjeteve të lejueshme rregullatore.

Nga ana tjetër, sipas VA, ndërhyrja e vitit 2014 për barazimin e tarifave on/off-net ka ndryshuar përfundimisht qasjen e trafikut. Ndaj dhe mbajtja e detyrimeve për një periudhë tjetër 2 vjeçare është e pajustificuar nga gjendja aktuale e tregut dhe jo-proporcionale në raport me qëllimin që pretendon të arrijë. VA shprehet se njëhësimi i çmimeve on-net dhe off-net për të gjithë operatorët ka rezultuar në më pak minuta komunikimi për konsumatorët në qarqet e tyre familiare dhe sociale, çka në fund të ditës përkthehet në pakënaqësi për to.

VA thekson se me trendin e konfirmuar tashmë gjatë vitit 2017 në shifrat 36% off-net me 64% on-net dhe rritjen eksponenciale të trafikut off-net, vazhdimi i masave rregullatore në këtë treg me pakicë është i papërshtatshëm. Sjellja e konsumatoreve tashmë nuk mund të ndryshojë më dhe raportet që tregojnë qëndrueshmërinë e trafikut off-net do mbeten të pandryshueshme në të ardhmen.

AKEP paralelisht duhet të mbajë në vëmendje se vijimi i tarifave të barazuara brenda dhe jashtë rrjetit nuk mundet kurrësi të bashkë-ekzistojë me tarifa asimetrike terminimi, pasi në të kundërt sjell dëme të parikuperueshme në konkurrencë dhe avantazhon arbitrarisht operatorin asimetrik. Kujtojmë se përgjatë analizës së tregut në vitin 2014, u diskutua dhe dakordua me palët e përfshira në proces që zbatimi i rregullimit on/off-net do të shoqërohej paralelisht me tarifat simetrike mes të gjithë operatorëve, pasi në të kundërt ndërhyrja e AKEP avantazhon qartazi dhe në mënyrë arbitrare operatorin asimetrik Plus dhe çënon rëndë operatorët e tjerë. Ndaj, pavarësisht çështjeve gjyqësore në vazhdim AKEP duhet të luajë rolin e tij konstruktiv dhe të angazhohet për perkufizimin dhe zbatimin e tarifës simetrike me efekt të menjëhershëm nga mbyllja e analizës së tregut.

## **ALBTELECOM**

Nga sa informacion është dhënë në këtë analizë, përgjithësisht efektet e masave rregulluese të mos-diskriminimit on-net/off-net duket të jenë pozitive, komenton Albtelecom, duke gjykuar:

- Mbi ndryshim thelbesor të stuktues dalëse të trafikut për abonentët dhe për secilin operator;

- Mbi numrin e ofertave të hedhura në treg, thjeshtimin e termave të ofertave dhe rritjen e kuptueshmërisë së tyre për abonentët;
- Mbi reduktimin e numrit të kartave SIM të operatorëve në treg, apo dhe rritjen e ulët të numrit të pajtimtarëve aktivë.

Ndërkaq, Albtelecom mendon se për të dhënë një gjykim më të drejtë dhe më të saktë mbi efektet e kësaj masë të vendosur për operatorët celularë do të ishte i nevojshëm/i domosdoshëm informacion mbi procesin e portabilitetit të paktën që me fillimin e zbatimit të rregullimit, për të parë flusin dhe kahun e ndryshimit, për të konsideruar/konkluduar ose jo për efekte pozitive në drejtim të rritjes së fluiditetit të tregut dhe lëvizjes së lirë të abonentëve. Gjithashtu Albtelecom kërkon edhe informacion përkatësisht, për thirrjet mesatare on-net/ abonenet dhe off-net/abonentë për secilin operator. Tregues tjetër që Albtelecom merr në shqyrtim është dhe numri i portimeve 2013-2015, i cili pas një rënijeje në shifrën e vitit 2015, për vitin 2016 u rrit me 58% krahasimisht me vitin 2015. Rritje kjo, që tregon për një fluiditet në rritje të tregut, si dhe për lëvizje të lirë dhe të pakushtëzuar të abonentëve celular nga njëri operator në tjetrin, varësisht përfitimeve dhe benefiteve në shërbimet e komunikimit që ata mund të sigurojnë nga ofertat në tregun celular. Gjithsesi, ecuria e mëtejshme e këtij procesi do të tregojë mbi vijueshmërinë dhe efektet e masës rregullatore të mosdiskriminimit në tarifën e thirrjeve on-net/off-net.

## **PLUS COMMUNICATION**

Zbatimi i masave rregullatore të mos diskriminimit në tarifën e thirrjeve On-net/Off-net, të përcaktuara si masa të detyrueshme rregullatore në vendimet e Analizës së tregut të vitit 2014, dhe veçanërisht përfshirja në mënyrë të barabartë e minutave brenda dhe jashtë rrjeteve celulare në paketat dhe planet tarifore me parapagim dhe paspagim kanë hyrë në fuqi 6 muaj dhe 1 vit me vonesë, duke deformuar dhe dëmtuar zbatimin korrekt të masave të ndërmarra.

Raporti I thirrjeve On-net/Off-net ka pësuar ndryshime por mbetet ende larg nga ato të vendeve të tjera të BE-së për shkak të kësaj vonese dhe abuzimit të fshehtë e të qëllimshëm të bërë nga operatorët e mëdhenj me minutat brenda rrjetit.

Plus gjykon se (i) zbatimi i vonuar i masave të mosdiskriminimit, (ii) vonesat e shkaktuara për mëse 1 vit nga paftësia e AKEP për të detyruar operatorët të zbatojnë këto masa që nga 1.1.2015 (siapas vendimit Nëntor 2014), shoqëruar me (iii) uljen e menjëhershme të Tarifës së terminimit, e akoma më keq me (iv) moszbatimin e vendimeve të formës së prerë të Gjykatës, kanë ndikuar në mënyrë vrastare ndaj “PLUS”.

Ndaj qëndrimi i AKEP i shprehur në këtë dokument për vazhdimin e mosdiskriminimit dhe masave rregullatore edhe për periudhën 2017-2018 është një qëndrim I domosdoshëm dhe më e pakta që mund të bëjë AKEP në kushtet ku ka degjeneruar tregun. Por këto masa, siç edhe sanksionon vendimi I Gjykatës, duhet të shoqërohen me ruajtjen e tarifave të terminimit në rrjetin PLUS në nivelin që vetë AKEP ka vendosur për PLUS në vendimin e nëntorit 2014 dhe më pas me një ulje të përshkallëzuar në përputhje me mënyrën e reduktimit të MTR-ve të aplikuar në Shqipëri nga vetë AKEP ndër vite për gjithë operatorët celularë.

## **QËNDRIMI I AKEP**

Ne lidhje me komentet e Telekom Albania dhe Vodafone Albania për masen rregulluese e mosdiskriminimit në tarifën me pakicë on-net/off-net, AKEP gjykon se kjo masë ishte e nevojshme dhe ndryshimet e ndjeshme të vena re në sasinë e trafikut off-net dhe peshën e tij në raport me thirrjet on-net kanë ardhur pikërisht prej zbatimit të këtij detyrimi, sidomos për dy operatorët me të mëdhenj në treg. Ne lidhje me komentet Vodafone kundër ndërhyrjeve në tregun e pakicës, si

sjellje e pambështetur në legjislacion, e papërkrahur nga praktikat Europiane dhe e pajustificuar nga specifikat e tregut, AKEP gjykon se masa e diskriminimit ishte dhe është e nevojshme pikerisht për shkak të specifikave të tregut celular në Shqipëri, ku trafiku on-net arriti në nivele deri në 97% të thirrjeve celulare, pra duke cuar në mbyllje të rrjeteve dhe përdoruesve në rrjetet celulare. Gjithashtu niveli i lartë i pjesës së tregut të Vodafone dhe sjelljet e fundit të tre operatoreve kryesore celulare në tregun me pakicë (ndryshimi i tarifave në Mars 2017) krijojnë shqetësime dhe/ose dyshime për sjellje të koordinuar apo stimulim për sjellje të koordinuar nga këta tre operatorë në tregun me pakicë celular, dhe Autoriteti i Konkurrencës (AK) me Vendimin Nr. 461, datë 23/05/2017, ka vendosur për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare. Në lidhje me masën e mos-diskriminimit AK është shprehur se ajo është në përputhje me rekomandimet e AK në vitin 2014, ndërsa sic është theksuar nga AKEP sjelljet e mundshme antikonkurrese në tregun me pakicë celular mund të adresohen nga AK, në bashkëpunim dhe me AKEP. Tregu me pakicë celular nuk përjashtohet apriori nga rregullimi ex-ante, por në kushtet kur nuk plotësohet testi i 3 kriterëve. Pra të gjitha këto nuk përjashtojnë mundësinë e nderhyrjes direkte të AKEP në tregun me pakicë celular, nëse nga ndryshimet që mund të ndodhin plotësohet testi i 3 kriterëve.

Sic është theksuar në përmbledhjen ekzekutive dhe në seksionin e masave rregulluese të këtij dokumenti, AKEP vlerëson se ekzistojnë kushtet që zbatimi i masës rregulluese të mos-diskriminimit në tarifën me pakicë të thirrjeve on-net/off-net të përfshihet në një diskutim më të gjerë, për shkak të lidhjes indirekte të kësaj mase me detyrimet për FNT në tregun me pakicë celular, ku ky detyrim mund të vendoset vetëm për operatorët që kanë dominancë apo FNT edhe në tregun përkatës me pakicë celular. AKEP gjykon që tre operatorët të vijojnë zbatimin e kësaj mase, ndërsa rishikimi i proporcionalitetit të saj për secilin operator do të kryhet në kuadër të analizës së tregut me pakicë celular dhe tregjeve të tjera të justifikuara për ndërhyrje ex-ante që do kryejë AKEP me këshillim publik në muajt në vijim.

#### **4. Cfare mendoni në lidhje me ecurinë e pjesëve të tregut dhe treguesve financiarë të operatorëve celularë?**

##### **TELEKOM ALBANIA**

Ecuria e treguesve financiarë dhe pjesët e tregut reflektojnë efektet e rregullimit të tregut me shumicë dhe pakicë si dhe dinamikën dhe ecurinë e tregut të telefonisë së levizshme. Reduktimi i të ardhurave gjatë 2010-2015 ka ardhur si pasojë e uljes së MTR kombëtare dhe një asimetri 350% ndaj Plus, konkurrencës agresive, aplikimi i mosdiskriminimit dhe heqja nga tregu e disa produkteve si pasojë e këtij rregulli duke zvogeluar gamën e produkteve në treg. Në të njëjtën linjë janë edhe fitimet neto, të cilat janë reduktuar edhe si pasojë e investimeve për rinovim autorizimesh për përdorim spektri si dhe ofrimi i shërbimeve LTE. Tendencat për pjesët e tregut sipas përdoruesve, thirrjeve dhe të ardhurave, vijojnë të shfaqin trend të njëjtë, ndërsa rregullimi i pakicës dhe shumicës ka ndikim negativ në uljen e të ardhurave. Ky trend duket se do të vazhdojë të jetë i tillë dhe për dy-tre vitet e ardhshme në sajë të disa faktoreve si: efektet e mos-diskriminimit në tarifën retail on-net/off-net, konkurrenca agresive e operatorëve, saturimi i tregut celular karakterizuar nga tarifa gjithnjë e më të ulëta për përdoruesit fundorë, tendenca për reduktim të mëtejshëm në tarifën e terminimit, etj.

##### **ALBTELECOM**

Lidhur me pjesët e tregut të operatorëve celularë Altelecom komenton se pasqyrimi vetëm i Q3\_2016 nuk paraqet në mënyrë korrekte situatën duke qenë se ky tremujor përkon me një përdorim sezonal të kartave SIM nga emigrantët/pushuesit që zgjedhin të vizitojnë Shqipërinë, dhe duke qenë se kompanitë Vodafone dhe Telekom Albania janë globale, ka një pritshmëri që zgjedhja e këtyre abonentëve të jetë e ndikuar nga emri. Për rrjedhojë, edhe pjesët e tregut në terma të thirrjeve dalëse apo dhe të SMS-ve të gjeneruara mundësi të jenë të ndikuara nga kjo kategori përdoruesish, dhe nga sa shihet në këtë tabelë VA dhe TA figurojnë më një rritje të konsiderueshme. Kjo çënon disi analizën mbi ecurinë e pjesëve të tregut apo dhe mbi gjëndjen faktike të operatorëve të tregut celular. Ndërkaq, sa i takon pjesëve të tregut në lidhje me të ardhurat totale nga tregu i komunikimeve elektronike, duket se TA VA kanë zvogëluar pjesët e tyre të tregut, ndërsa i vetmi operator me rritje të konsiderueshme të të ardhurave është Plus, rritje kjo e lidhur direkt me trajtimin e padrejtë me tarifë terminimi asimetrike, që arrin deri në rreth 340% me operatorët e tjerë.

## **PLUS COMMUNICATION**

Më poshtë paraqitet një përshkrim dhe argumenta në lidhje me efektet financiare mbi PLUS të krijuara nga moszbatimi i tarifës së ligjshme të terminimit në rrjetin PLUS në vlerën prej 6.52 lek/min.

Shoqëria PLUS ka pasur mungesë në të ardhurat e interkoneksionit hyrës kombëtar për periudhën Prill'15 – Dhjetor '16, mungesë e cila kap vlerën 8.6 milionë Euro apo 1.2 bilionë Lekë si rezultat i mosaplikimit të tarifës së terminimit 6.52 lek/min, si edhe mosnjohjes së vendimit të Gjykatës për aplikimin e kësaj tarife nga operatorët për vitin 2016. Sic vihet re, vlerat janë konsiderueshëm të mëdha, duke zënë rreth 30% të xhiros së realizuar për periudhën 2015-2016.

Mosaplikimi në kohë i vendimit të barazimit të on net/off net në retail për klientët me parapagim dhe paspagim nga 01.01.2015 ka ndikuar gjithashtu në rënien e bazës së klientëve të kompanisë (me të paktën 35%) dhe ka rezultuar në të ardhura të munguara tepër të konsiderueshme për një operator si PLUS (që përllogariten në vlerën 5 milionë Euro).

- Rënia e bazës së klientëve në T3 2016 është një tregues i pamundësisë financiare për të investuar me shërbime të domosdoshme për pajtimtarët e PLUS. Kurse rritja e numrit të klientëve në T4 2016 tregon një rritje relative të efekteve që diktojnë masat rregullatore, por sigurisht kërkojnë mbështetje edhe me support financiar i cili deri tani ka munguar;
- Arsyeja e pamundësisë financiare e trajtuar më lart, ka cuar në mungesë të shërbimeve të domosdoshme, pa të cilat një shoqëri celulare nuk mund të ekzistojë në treg;
- Licensën për ofrimin e shërbimit 3G, PLUS e ka mar vetëm në muajin Prill 2016, për pamundësi financiare gjatë vitit 2014 dhe për pamundësitë e pagesës së kësteve të licenses, madje duke rrezikuar tani edhe heqjen e saj;
- Ofrimi i shërbimit 4G, si një domosdoshmëri për pajtimtarët, kërkon mundësi financiare dhe investim.

Për sa më sipër PLUS vlerëson se është më se i domosdoshëm vijimi i masave rregullatore edhe për një periudhë tjetër, sic edhe propozohet në këtë analizë, e sidomos mbajtja e MTR të PLUS në nivelin që përcaktohet në vendimin e Gjykatës për të paktën një periudhë 12 mujore e më pas reduktimi i përshkallëzuar i tij sipas të njëjtës normë ulje që është aplikuar edhe për operatorët e tjerë në Shqipëri.

## **QËNDRIMI I AKEP**

Ne lidhje me komentin e Altelecom për pjesët e tregut të QIII 2016, AKEP në kohën e nxjerrjes së dokumentit në keshillim public ka përdorur të dhënat me të fundit të disponuara, dhe në këtë version final ka përditësuar dokumentin me të dhënat më të fundit të disponueshme; viti 2016 për treguesit financiarë dhe viti 2017 për tregues të tjerë të volumit të shërbimeve.

## **5. A jeni dakort me përfundimet e AKEP për përkufizimin e tregut përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjet individual celular?**

### **TELEKOM ALBANIA**

TA është dakord me përfundimet e AKEP në lidhje me përkufizimin e tregut të terminimit të thirrjeve në një rrjet individual celular dhe të faktoreve përkatës që e përkufizojnë atë si një treg më vete si psh: zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës/ofertës; praktika CPP (Calling Pay Party), etj. Në lidhje me këtë çështje, TA është shprehur dhe në analizat e mëparshme të tregut të telefonisë së lëvizshme, duke qenë në të njëjtën linjë me përfundimet e AKEP dhe me faktoret e marrë në konsideratë për përkufizimin e tregut të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare. Bazuar në parimin e neutralitetit teknologjik sipas direktivave përkatëse të BE-së të 2002 dhe 2009, terminimi i thirrjeve në rrjetet individuale mobile përfshin të gjitha llojet e tipologjive dhe teknologjive të rrjeteve celulare: 2G, 3G-UMTS, apo 4G-LTE të cilat aplikohen tashmë nga pothuaj të gjithë operatorët celulare. Në konkluzion të sa më sipër, shërbimi i terminimit me shumicë të thirrjeve në rrjetet celulare përkatëse perben një treg të vecantë për cdo operator në treg, i cili gjendet në listen e tregjeve të justifikueshme për ndërhyrje rregullatore ex-ante të të gjitha Rekomandimeve të BE-së të 2003, 2007 dhe të rekomandimit të BE të Tetor 2014.

### **VODAFONE ALBANIA**

VA shprehet dakord me përfundimin e arritur nga AKEP. Tregu përkatës i terminimit të thirrjeve në rrjetin individual celular përfshihet në listën e tregjeve të rekomanduara për rregullim nga Rekomandimi i KE për rregullim ex-ante. VA gjithashtu mbështet qëndrimin e AKEP të bazuar në parimin e neutralitetit teknologjik sipas të cilit tregu i terminimit të thirrjeve zanore në një rrjet celular nuk bën diferencim dhe përfshin të gjitha llojet e topologjive/ standarteve të rrjeteve celulare (2G, 3G, 4G).

VA mbështet përfundimin e AKEP se tregu gjeografik i shërbimit të terminimit në secilin nga rrjetet celulare është kombëtar, d.m.th. territori i Republikës së Shqipërisë. VA thekson se këtu bën përjashtim terminimi i thirrjeve ndërkombëtare, të cilat origjinohen nga jashtë territorit Shqiptar. Terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare nuk është pjesë e tregut përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjetin celular dhe shërbimi i terminimit përfshin vetëm thirrjet me origjinë kombëtare. Kjo është një qasje e njohur dhe zbatuar nga vendimet rregullatore të disa vendeve të BE (përmendim këtu psh Itali dhe Greqi) ku parimi i reciprocitetit të tarifave të terminimit është i zbatueshëm prej kohësh.

### **ALBTELECOM**

Albtelecom shpreh dakortësinë e tij për përfundimet e AKEP në lidhje me përkufizimin e tregut përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjet individual celular duke gjykuar njësoj si AKEP se, shërbimi i terminimit të thirrjeve zanore është një treg i vecantë për secilin operator. Po ashtu, Albtelecom shprehet dakort se tregu me shumicë i thirrjeve zanore në një rrjet celular përfshin të gjitha llojet e topologjive/standarteve të rrjeteve celulare dhe se dimensionin gjeografik i shërbimit të terminimit në secilin nga rrjetet celulare është territori i Republikës së Shqipërisë. Kryerja e analizës së tre kritereve nuk do të sillte ndryshim të përkufizimit të tregut të terminimit të thirrjeve zanore aq më tepër që përcaktimi i këtij tregu është pjesë e Direktivës së Bashkimit Europian për tregjet nën rregullim dhe ka mbetur sërish pjesë e kësaj liste edhe në Rekomandimin e vitit 2014.

### **NEOFONE**

Jo. Neofone e konsideron trajtimin e AKEP për tregun e terminimit të paarsyetuar dhe në favor të operatorëve mobile duke subvencionuar monopolizimin e tregut të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe krijimin e barrierave për hyrjen e sipërmarrësve të rinj. Neofone e konsideron qëndrimin e AKEP duke trajtuar ndryshe trafikun me origjinë ndërkombëtare nga ai me origjinë Kombëtare si diskriminues sipas origjinës në shkelje të Ligjit Nr. 9918, i ndryshuar, dhe në kundërshtim me praktikën europiane. Ndërhyrja e AKEP për të trajtuar ndryshe trafikun sipas origjinës dhe për të hequr detyrimet e operatorëve të telefonisë së levizshme për trafikun ndërkombëtar në vitin 2012 ishte "ex-post", duke vazhduar në vitin 2014 dhe sot në analizën e 2016.

AKEP në kompetencat e tij ka si parim kryesor ruajtjen e konkurrencës dhe trajtimin me pa anësi të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike. AKEP ka detyrimin që të përcaktojë tregjet përkatëse dhe të analizojë operatorët të cilët përmbushin kriteret për fuqi të ndjeshme.

Edhe nëse një treg mund të jetë në kushtet e konkurrencës vet ndërhyrja "ex-ante" nënkupton një projektion në të ardhmen për të përcaktuar nëse ndonjë operator ka potencial dhe aftësi për të ndikuar tregun. një arsyetim dhe rregullim "ex-ante" është parandalues në vetvete dhe nuk nënkupton në të gjitha rastet që tregu është i parregulluar por thjesht vendoset si masë paraprake për të ndaluar cdo hapësirë për abuzim potencial në të ardhmen.

## **QËNDRIMI I AKEP**

Ne lidhje me komentet e Neofone, AKEP në kete version final të dokumentit të analizes ka dhene informacion shtese për impaktin e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në konkurrencën në tregun me pakicë si dhe ka përditësuar informacionin për trendin e vendeve të BE për trajtim të ndryshëm të tarifave të terminimit të trafikut hyres ndërkombëtar, nga vendet e BE /EU/EEA) dhe jashtë vendeve të BE, të cilat mbeshtesin trajtimin aktual të ketyre thirrjeve nga AKEP.

Në lidhje me përkufizimin e tregut të terminimit të thirrjeve, AKEP gjykon që të mos ndryshojë përkufizimin e tregut përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, pra që ai të përfshijë vetëm thirrjet kombëtare dhe të mos përfshijë thirrjet hyrëse ndërkombëtare, në linjë me analizat dhe vendimet e AKEP nga viti 2012 e në vijim, si dhe me dokumnetin e Analizës së nxjerrë në këshillim publik në Dhjetor 2016.

Ndërkohë terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, nëse ai përbën një treg të vecantë përkatës (të ndryshëm apo të njëjtë me terminimin e thirrjeve kombëtare), si dhe për nevojën ose jo të rregullimit të tij, do të vlerësohet nga AKEP në procesin e ri të analizës së tregut celular, me pakicë dhe tregjet e tjera të justifikueshme për ndërhyrje ex-ante pas ndryshimeve të strukturës së tregut celular dhe rekomandimeve të AK, që do të fillojë së shpejti nga AKEP sipas procedurave përkatëse në ligjin 9918 dhe Rregulloren e Analizës së tregut, duke marrë në konsideratë gjithashtu (sipas Ligjit 9918) të gjitha rekomandimet e KE dhe BEREC.

## **6. A mendoni se të katër operatorët celulare aktiv në treg, përmbushin kriteret për FNT në terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale?**

## **TELEKOM ALBANIA**



Tregu i terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare është një treg monopolist natyral në të cilin cdo operator rrjeti ka 100% të kontrollit të rrjetit përkatës në të cilin ofrohet shërbimi i terminimit. Gjithashtu, në sajë të kësaj karakteristike operatori zotëron aftësinë për përcaktimin e tarifave të terminimit pa u ndikuar nga konkurrenca, dhe has në një fuqi të ulët kundërvepruese nga konkurrentet apo blerësve të ndryshëm të shërbimit të terminimit në rrjetin e tij, etj. Në lidhje me përmbushjen e kriterëve për FNT në terminimin e thirrjeve TA është në të njëjtën linjë me opinionin e shprehur në analizen e tregut të 2014, ku cdo operator është monopolist në rrjetin që ai zotëron dhe si i tillë plotëson të gjitha kriteret e shqyrtuara për të pasur statusin për FNT në këtë treg, në përputhje me të gjitha përcaktimet rregullatore sipas direktivave të BE-së dhe të legjislationit shqiptar.

### **VODAFONE ALBANIA**

VA mbështet qëndrimin se tregu i terminimit të thirrjeve në rrjetin telefonik të levizshëm është një treg subjekt i rregullimit ex-ante nga AKEP për të katër operatorët celulare në treg. Sidoqoftë në terma afatmesëm e afatgjatë, VA mendon se duhen rivlerësuar nga AKEP kriteret që ndikojnë në përcaktimin e dominancës në tregun e terminimit të thirrjeve në një rrjet individual, si rrjedhojë e zhvillimeve të hovshme të teknologjise, përhapjes së lartë të internetit dhe të përdorimit të smartphones dhe tabletave, shfrytëzimit të spektrit për teknologjine 3G/LTE, të cilat kanë sjellë gjithnjë e më shumë rritje të aksesit në internet e për pasojë rritjen e përdorimit në treg të teknologjive të reja të komunikimit dhe aplikacioneve përkatëse, të cilat zëvendësojnë komunikimin tradicional telefonik.

### **ALBTELECOM**

Fakti që secili nga Operatorët celularë zotëron 100% pjesë tregu në shërbimin e terminimit të thirrjeve zanore në këto rrjete dhe njëkohësisht nuk pritet ndyshim në periudhë afatmesme i kriterëve të marra në shqyrtim në analizë, do të thotë që përmbushen të gjitha kushtet për të qenë FNT për terminimin në rrjetet e tyre individuale. Në analizën e AKEP shërbimi i terminimit në një rrjet individual celular nuk ka zëvendësues të tij për të njëjtin rrjet celular ndaj edhe operatori konsiderohet se ka 100% pjesë tregu në shërbimin e terminimit të thirrjeve, ndaj asnjë nga operatorët nuk ndeshet me fuqi kundërvepruese të ndonjë konkurenti tjetër për terminim të thirrjeve në rrjetin e vet. Në mungesë të ndërhyrjes rregullatore, cdo operator celular do të mund të vendoste/të impononte tarifa të larta për terminimin e thirrjeve në rrjetin e tij. Albtelecom mendon se të katër operatorët celularë përmbushin kriteret për FNT në terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale

### **PLUS COMMUNICATION**

PLUS është dakord me përfundimin e nxjerrë nga AKEP se, të katër operatorët celularë: Vodafone Albania, Telekom Albania, Albtelecom dhe PLUS përmbushin kriteret për fuqi të ndjeshme në tregjet përkatëse të terminimit të thirrjeve zanore në rrjetet e tyre celulare, për vetë vecoritë e tregut të terminimit të thirrjeve, i cili është monopol natyror dhe cdo operator celular është monopolist në ofrimin e shërbimit të terminimit të thirrjeve zanore në rrjetin e vet.

### **NEOFONE**

Te katërt operatorët përmbushin kriteret për të marrë masa rregullatore dhe obliguese për të krijuar kushtet e konkurrencës efektive.

Në këndvështrimin e Direktivave të BE masat "ex-ante" nuk imponohen vetëm kur ka mungesë konkurrence por ato imponohen për të parandaluar cdo rast të mungesës së konkurrencës edhe nëse tregu është në konkurrencë efektive. Pra masat në vetvete vendosen për operatorët të cilët kanë potencial për të prishur konkurrencën, dhe jo vetëm në rastet e prishjes së konkurrencës.

AKEP ka arsyetuar se tregu i terminimit të thirrjeve ndërkombetare është në konkurrencë efektive dhe si pasojë heqim detyrimet për këte trego AKEP ka gabuar rende pasi edhe nëse ky treg do të jete në kushtet e konkurrencës efektive perseri obligimet duhet të qendrojne për të parandaluar rastet e shkeljeve në të ardhmen. Gjithsesi sot Neofone dhe shumë operatorë alternative megjithse të licensuar nuk kanë mundesi të perfitojne nga liberalizimi i tregjeve të terminimit dhe origjinimit si në të gjitha vendet e perparuara Europiane. FNT ka të bëjë me potencialin e një operatori për të prishur konkurrencën dhe është masë parandaluese.

## **QËNDRIMI I AKEP**

Ne lidhje me komentet e Neofone se ‘AKEP ka arsyetuar se tregu i terminimit të thirrjeve ndërkombetare është në konkurrencë efektive...’, AKEP sqaron se ky citim/perfundim nuk mbeshtetet ne dokumentin e analizes se tregut celular te nxjerre ne keshillim publik dhe ne asnje prej dokumentave te meparshem te AKEP (perفشire Analizen e tregut 2012: seksioni III.3/III), ku jane dhene arsyetimet perkatese per heqjen e detyrimeve per terminimin e thirrjeve hyerese nderkombetare.

Nëse terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare përbën një treg të vecantë përkatës (të ndryshëm apo të njëjtë me terminimin e thirrjeve kombëtare), si dhe për nevojën ose jo të rregullimit të tij, do të vlerësohet nga AKEP në procesin e ri të analizës së tregut celular, me pakicë dhe tregjet e tjera të justifikueshme për ndërhyrje ex-ante pas ndryshimeve të strukturës së tregut celular dhe rekomandimeve të AK, që do të fillojë së shpejti nga AKEP sipas procedurave përkatëse në ligjin 9918 dhe Rregulloren e Analizës së tregut, duke marrë në konsideratë gjithashtu (sipas Ligjit 9918) të gjitha rekomandimet e KE dhe BEREC.

### **7. Cfare mendoni për masat rregullatore për terminimin në rrjetet celulare?**

#### **TELEKOM ALBANIA**

Duke qënë se tregu i terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare është një treg i justifikuar për ndërhyrje rregullatore sipas përcaktimeve rregullatore dhe ligjore, në të cilin të gjithë operatorët e telefonisë celulare i plotësojnë kriteret për të pasur FNT, për këta operatorë aplikohen masat rregullatore përkatëse të mos-diskriminimit, trasparëncës, dhënies akses dhe interkoneksion dhe kontrolli i tarifave në përputhje me nenet 39, 40, 42 dhe 45 të Ligjit nr.9918, i ndryshuar për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë. Masat rregullatore të propozuara në këtë dokument të analizes së tregut, janë përcaktuar më parë nga ana e AKEP nëpërmjet Vendimeve Nr.2522-2526, datë 14.11.2014, të ndryshuara me Vendimin Nr.2542, datë 13.03.2015. në propozimin për mbajtjen e obligimeve rregullatore të mësipërme, është e rëndesishme që ato të jenë të njëjta për të gjithë operatorët në respekt të parimit të mos-diskriminimit, në menyrë që të mos krijohen kushte favorizuese për një operator të vecantë dhe të mos krijojnë shtremberime në treg. një gjë e tille theksohet mjaft qartë dhe në raportin e ERG (03) 30rev1 ERG Common Position on the approach to Appropriate remedies in the neë regulatory frameëork, në faqjen 60. Meqenëse masat rregullatore të mësipërme për terminimin e thirrjeve janë të njëjta dhe simetrike për të 4 (katër) operatorët celularë në tregjet përkatëse të terminimit, si dhe në përputhje dhe në koherence me gjetjet dhe përcaktimet e analizave të meparshme të tregut, TA nuk ka ndonje objeksion apo shtese për të bere në lidhje me këtë pike.

#### **VODAFONE ALBANIA**

VA shprehet kundër ndërhyrjeve në tregun e pakices dhe rregullimit on/off-net, si masë detyruese që rrjedhon nga tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve. Se dyti, ulja e fortë dhe e menjehershme e tarifave të terminimit përben rrezik për qëndrueshmerine financiare të operatorëve në treg dhe ndikon negativisht në nivelin e investimeve. 'Glide path' apo përshkallezimi i uljes së tarifave nga organet rregullatore përdoret me qëllim që operatorët të përshtasin modelin e biznesit të tyre, të rregullojnë nivelet e reja të cmimeve dhe gjithashtu për të garantuar që operatorët të mos bien pre e 'shokut' të renies se fortë të tarifave që mund të shkaktoje luhatje të forta te fitimet e kompanive dhe për rrjedhojë të qëndrueshmeria e tyre financiare. 'Glide path' duhet të ketë në fokus balancimin mes perfitimit afatshkurter të konsumatoreve përkundrejt mbrojtjes së shtysave për investim. Nga ana tjetër, është jo-rationale që tu kërkohet operatorëve shërbim-ofruer të shtyjne për investime të reja, kur qartazi vihet re që të ardhurat kanë rënë në mënyrë drastike, deri në nivelet kur fitimi është negativ; aq më tepër kur Vodafone tashme figuron si investitori me i madh.

## **ALBTELECOM**

Lidhur me masat/detyrimet rregullatore të propozuara nga AKEP, Albtelecom mendon se ato janë të nevojshme për tu vendosur, por theksojmë se është i rëndësishëm proporcionaliteti dhe trajtimi i arsyeshëm për të gjithë operatorët e tregut për të bërë kështu të mundur efikasitetin dhe arritjen e rezultateve pozitive. Më gjerësisht, Albtelecom komentet për kontrollin e tarifës do ti shprehë për dokumentin "Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare".

Në vijim të një sërë korrespondencash të tjera, Albtelecom gjen rastin t'i kërkojë edhe njëherë AKEP se thirrjet ndërkombëtare drejt numrave të portuar nuk mund të jenë pjesë e detyrimit për kontroll të tarifave njësoj sic ky detyrim aplikohet për thirrjet kombëtare. Pra, efekti i masës rregullatore për kontrollin e tarifave të terminimit dhe niveli i këtyre tarifave, nuk duhet të shtrihet mbi thirrjet ndërkombëtare drejt numrave të portuar, por këto thirrje duhet të tarifohen sipas regjimit rregullator të trafikut ndërkombëtar i cili aktualisht është në terma komercial (i derregulluar). Në lidhje me këtë çështje, Albtelecom parashtron edhe njëherë argumentet e tij mbështetëse si më poshtë:

- Pas pothuasje 5 vjetësh operimi sipas këtij vendimi të AKEP, nga informacioni e marra nga disa pika reference, në lidhje me regjimet rregullatore të vendeve të Europës, nuk ka mundur të gjejë asnjë rast që të jetë i ngjashëm me Shqipërinë me përcaktime në kuadrin rregullator përkatës që në rastin e numrave të portuar thirrjet ndërkombëtare të trajtohen njësoj me tarifën e terminimit të thirrjeve kombëtare.
- Përvec njësimimit të praktikës së vëndit tonë më praktikata e vendeve të tjera të Europës, në gjykimin e Albtelecom, varësisht edhe balancave të numrave të portuar, do të bëhet e mundur gjithashtu që cdo operator të marrë atë cka i përket/takon nga trafiku që zhvillohet drejt numrave në rrjetin e tij.
- Të dhënat nga trafiku demostrojnë se Albtelecom ka impakte negative financiare të konsiderueshme që do të vijojnë të jenë, nëse AKEP nuk ndryshon përcaktimet rregullatore në fuqi, sipas të cilave thirrjeve ndërkombëtare drejt numrave të portuar tarifohen aktualisht me tarifën e thirrjeve kombëtare.
- Aktualisht, dhe në rrethanat kur trafiku ndërkombëtar hyrës në rrjetet e operatorëve vendas nuk është më subjekt i rregullimit nga AKEP por është çështje për tu trajtuar komercialisht ndërmjet palëve, të ardhurat nga trafiku ndërkombëtar hyrës drejt numrave të portuar, që si e drejte do duhet të përfitoheshin nga operatori marrës i numrit të portuar, po përfitohen në mënyrë të padrejtë nga operatori dhurues i numrit, i cili në zbatim të Rregullores ka detyrimin thjesht për të rrugëzuar thirrjen drejt rrjetit ku është portuar numri.

## **PLUS COMMUNICATION**

Në lidhje me tarifat e terminimit të popozuara nga AKEP, PLUS gjykon se AKEP duhet implementojë menjëherë dhe të vendosë në zbatim, si institucioni përgjegjës për mbarëvajtjen e tregut celular, Vendimin e formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, nr. 2459, datë 09.09.2016, i cili ka lënë në

fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, nr. 1567 datë 1.04.2016, e cila kishte vendosur: pranimin e kërkesë padisë së PLUS, shfuqizimin e pjesshëm të vendimit nr. 2542 duke lënë në fuqi tarifën e terminimit në rrjetin PLUS në nivelin 6.52 lek/min deri në Analizën e radhës së tregut celular dhe shfuqizimin e shtyrjes së afatit të aplikimit të detyrimit për mosdiskriminimin tarifor brenda dhe jashtë rrjetit dhe hyrjen me efekt nga data 01.01.2015 për të gjithë pajtimtarët.

PLUS gjykon se Asimetria e tarifave të terminimit mes PLUS në raport me operatorët e tjerë duhet të vijojë për shkak të karakteristikave të mëposhtme të tregut të telefonisë celulare në Shqipëri dhe penalizimin që është bërë ndaj PLUS në gjithë periudhën e tij të aktivitetit:

- Situata penalizuese për PLUS që prej hyrjes në treg dhe në vijimësi. Abuzimi me pozitën dominuese në treg nga operatorët e mëdhenj, aplikimi i strategjive diferencuese të tarifimit, të konstatuara jo vetëm nga Autoriteti i Konkurrencës por edhe nëpërmjet kësaj analize, e kanë shoqëruar PLUS-in prej hyrjes së tij në treg dhe në vijimësi;
- Pjesa e tregut të operatorëve. Edhe pas gati 6 viteve operimi në treg, operatori PLUS nuk ka rritje të pjesës së tij të tregut në të gjithë treguesit, duke provuar se masat rregullatore të ndërmarra deri tani kanë qenë jo efektive dhe të pamjaftueshme;
- Vendimi i gabuar i uljes së menjëhershme të MTR të PLUS, i cili e ka penalizuar PLUS nga ana financiare deri në kushtet e mbijetesës, duke i krijuar vështirësi dhe pamundësi të funksionojë normalisht dhe të rrisë treguesit e vet;
- Koha e hyrjes në treg të operatorit PLUS, rreth 10 vjet më vonë se operatorët AMC (sot Telekom Albania) dhe Vodafone Albania, kur tregu kishte arritur një shkallë të lartë penetrimi;
- Strategjia e përdorur nga operatorët e mëdhenj për të mos lejuar rritjen e hyrësit më të ri në treg. Zbatimi i masave rregullatore ka filluar prej vetëm 1 viti, një kohë kjo shumë e shkurtër për të krijuar efekte të qëndrueshme;
- Kostot për njësi janë shumë më të larta për operatorin PLUS në krahasim me operatorët e tjerë për shkak të pjesës së vogël të tregut, hyrjes së vonë në treg dhe ekonomive të shkallës;
- Mekanizmi rregullator si Portabiliteti i numrit nuk ka funksionuar lehtësisht dhe kjo gjithashtu ka krijuar vështirësi për PLUS;
- Tregu është jo konkurrent, me pozitë dominuese të operatorit Vodafone Albania dhe me pjesë tregu mbi 87 % të dy operatorëve të mëdhenj të marrë së bashku. Pozita dominuese është konfirmuar nga Autoriteti i Konkurrencës;
- Tarifat asimetrike të terminimit të aplikuara deri më tani nuk kanë dhënë asnjë efekt ndaj konkurrencës në treg (pasi PLUS-it i janë mohuar ato për gati 18 muaj). PLUS ka të njëjtat pjesë tregu apo është duke i humbur ato, e si rrjedhim nevojitet ndërmarra e masave të tjera, si p.sh. minimalisht zgjatja e periudhës së asimetrisë, e cila është më se e domosdoshme;
- PLUS ka qenë i diskriminuar deri më tani, krahasuar me operatorët e tjerë, në lidhje me dhënien e mundësisë për ofrimin e shërbimit 3G duke e përjashtuar kështu nga ajo pjesë e tregut ku përfshihen përdoruesit e 3G, pjesë e cila në vitet e fundit është rritur ndjeshëm.

Për sa është argumentuar gjerësisht më lart, PLUS kërkon thellimin e masave rregullatore në tregun e terminimit të thirrjeve dhe gjykon që vlerat maksimale të tarifave të terminimit për periudhën 2017-2019 të jenë 6.52 lek/min deri në një vendim tjetër të AKEP ose:

| Operatorë                                   | Tarifa Aktuale | 01.09.2017-31.3.2018 | 1.04.2018-30.09.2018 | 01.10.2018-31.03.2019 | 1.04.2019 - Vazhdim |
|---|----------------|----------------------|----------------------|-----------------------|---------------------|
| Vodafone Albania                            | <b>1.48</b>    | <b>1.22</b>          | <b>1.22</b>          | <b>1.22</b>           | <b>1.22</b>         |
| Telekom Albania                             | <b>1.48</b>    | <b>1.22</b>          | <b>1.22</b>          | <b>1.22</b>           | <b>1.22</b>         |
| ALBtelecom                                  | <b>1.48</b>    | <b>1.22</b>          | <b>1.22</b>          | <b>1.22</b>           | <b>1.22</b>         |
| <b>PLUS Communication</b>                   | <b>6.52</b>    | <b>6.52</b>          | <b>4</b>             | <b>2.66</b>           | <b>1.22</b>         |
| % e ndryshimit tarifa terminimi <b>PLUS</b> |                | <b>0%</b>            | <b>-39%</b>          | <b>-34%</b>           | <b>-54%</b>         |

Ky përshkallëzim i tarifave të terminimit të PLUS, respekton gjithashtu edhe nivelin e asimetrisë së aplikuar në kohë për të gjithë *operatorët* celularë në Shqipëri.

## **NEOFONE**

AKEP duhet të aplikojë sa me gjerë rekomandimet e KE ku tek të cilat nuk ka një dallim midis shërbimit të terminimit të thirrjeve me origjinë Kombëtare nga ato me origjinë Ndërkombëtare.

Të gjitha masat rregullatore duhet të vendosen ndaj të katër operatorëve mobile pasi të gjithë zotërojnë infrastrukturë dhe facilitete ekskluzive duke ju dhënë POTENCIALIN e nevojshëm për të prishur konkurrencën efektive. Vet Analiza e Tregut "ex-ante" nënkupton që masat merren duke hipotetizuar dhe vlerësuar nëse tregu ka aktorë të cilët në të ardhmen mund të abuzojnë me pozitën e tyre dhe edhe sikur tregu të jete në konkurrencë efektive këto masa nuk hiqen pasi i japin mundësi operatorëve që të abuzojnë. Neofone në komentet e dhena ka përfshirë dhe komentet që ka dërguar për Analizën e tregut celular 2012.

## **QËNDRIMI I AKEP**

Në lidhje me kundërshtimet e Vodafone për masën e mos-diskriminimit në thirrjet on-net/off-net, AKEP gjykon se kjo masë është ende e nevojshme pasi në mungesë të saj operatorët e medhenj kanë stimul për të rikthyer në diskriminim të tarifave on-net/off-net.

Në lidhje me komentet e Albtelecom për tarifën e thirrjeve hyrese ndërkombëtare drejt numrave të portuar, AKEP ka bërë vlerësimin dhe adresimin e problemit në këtë dokument final të analizës së tregut, duke vendosur për trajtim të njëjtë të këtyre thirrjeve si edhe terminimi i thirrjeve të tjera ndërkombëtare. AKEP ka dhënë sqarime të duhura në këtë version final të analizës së tregut për këtë çështje, e cila do të plotësohet dhe me rregullime përcaktëse në amendimin e Rregullores së portabilitetit të numrit.

Në lidhje me komentet e Neofone, AKEP ka dhënë sqarime në qëndrimin për komentet e pyetjeve të mëparshme 5-6 me siper.

- 8. A jeni dakort me propozimin e AKEP se masa rregulluese e mos-diskriminimit në tarifën on-net/off-net e vendosur në analizën e tregut 2014 duhet të vijojë të aplikohet edhe për statusin me FNT të propozuar me këtë analizë?**

## **TELEKOM ALBANIA**

Në analizën e tregut 2014 TA nuk ka qënë dakort për vendosjen e masave rregulluese të mos-diskriminimit në tarifën on-net/off-net pasi do të ishte një ndërhyrje e tepërt rregullatore në tregun me pakicë për shkak se ky treg është karakterizuar nga një nivel i lartë dhe efektiv i konkurrencës, sic është evidentuar dhe nga

treguesit e ndryshëm statistikor mbi ecurinë e tregut. Gjithashtu, u vu re dhe një ndryshim i dukshëm në strukturën e thirrjeve on-net/off-net përpara fillimit të aplikimit të detyrimit të mos-diskriminimit on-net/off-net për arsye të hedhjes së paketave në treg nga vetë operatorët, me sasi të përafërta minutash brenda dhe jashtë rrjetit dhe u vu re një rritje e peshës së trafikut drejt rrjeteve të tjera. Edhe nga informacionet e paraqitura nga AKEP në lidhje me strukturën e thirrjeve brenda dhe jashtë rrjetit gjate dy viteve të fundit është vënë re një rritje e konsiderueshme e peshës së trafikut off-net krahasuar me ate brenda rrjeteve. Ky trend i rritjes së peshës së thirrjeve drejt rrjeteve të tjera do të vazhdojë dhe në të ardhmen dhe kjo është pasqyruar dhe në ofertat ekzistuese apo ato të reja të hedhura në treg nga të gjithë operatorët e telefonisë celulare. Duke qënë se tashme të gjitha ofertat dhe paketat e operatorëve kanë të njëjtat tarifa dhe volume të njëjta minutash për thirrjet brenda dhe jashtë rrjetit, në respekt të detyrimeve rregullatore përkatëse, dhe duke parë trendin e strukturës së thirrjeve, TA gjykon se nuk rezulton me i nevojshem aplikimi i masës rregulluese të mos-diskriminimit midis tarifave on-net/off-net, pasi tashmë kushtet e tregut kanë ndryshuar dhe nuk janë me të ngjashme me periudhën në të cilën u propozua kjo masë nga AKEP, bazuar dhe në nenin 37, të Ligjit 9918, i ndryshuar. Gjithashtu masa e mos-diskriminimit midis tarifave on-net/off-net rezulton e tepërt, favorizon dhe përbën një subvencion të padrejtë për PLUS në kurriz të tre operatorëve të tjere, në kushtet e asimetrise së MTR të Plus për shkak të Vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit të datës 9.09.2016, i cili la në fuqi tarifën e terminimit 6.52 leke/min në rrjetin e Plus. Ndaj në konkluzionin e tij TA bazuar në argumentat të përmendura më sipër, kërkon që detyrimi i mos-diskriminimit në tarifën on-net/off-net të mos vazhdojë të aplikohet, pasi në rrethanat e reja të krijuara në treg nuk është më i justifikueshëm, proporcional dhe rezulton një barrë e tepërt për operatorët.

## **VODAFONE ALBANIA**

VA gjykon se AKEP duhet të heqë masën detyruese të barazimit të tarifave on-net/off-net; në fakt AKEP nuk duhet të marrë asnjë masë rregulluese në nivel pakice. në një treg konkurrues sic tregu me pakicë rezulton të jetë, ofertat në treg e nxisin konkurrencën dhe rrisin përfitueshmërinë e konsumatorëve. Duke adresuar problematikën vetëm në nivel shumice, VA mendon se AKEP ka përmbushur me rigorozitet dhe ligjshmëri detyrimin dhe objektivin e tij rregullator për nxitjen e konkurrencës efektive në tregun e telefonisë së levizshme. Në rast të kundërt, AKEP dhe operatorët do të ishin në kontradikte me vetveten kur pranojnë se tregu është konkurrues, por nga ana tjetër theksojnë nevojën për ndërhyrje të vazhduar rregullimi në nivel pakice.

Edhe pse diferencimi midis tarifave brenda dhe jashtë rrjetit nuk është me ekzistues në praktikën e cmimeve të operatorëve shqiptare, AKEP nuk duhet të jetë kundër diferencimit on-net/off net në parim pasi diferencimi gjen vend në precedentët e BE dhe mbështetet nga teoritë ekonomike gjerësisht.

Operatorët e telefonisë së levizshme thjesht i përgjigjen kësaj kërkesë/nevoje tregu duke ofruar paketa specifike me cmime më të ulëta për thirrjet on-net dhe/ose ofruar paketa thirrjesh që aplikojnë diferencime në çmimet on net/off net. Prandaj, diferencimi on-net/off-net është një qasje e natyrshme e industrise së telefonisë së levizshme dhe në përgjithësi kjo praktikë zbatohet nga të gjithë operatorët në të gjitha juridiksionet, pasi është në përfitim të konsumatorëve.

Ndaj VA sugjeron që në rastin me të pakët AKEP duhet të rishikojë pjesërisht qëndrimin e tij, duke lejuar operatorët që paralelisht paketave me tarifa të barazuara, të mund të ofrojnë dhe disa paketa alternative me minuta të diferencuara on/off-net – ku zgjedhja të jetë në duart e konsumatorit. AKEP paralelisht duhet të mbaje në vëmendje se vijimi i tarifave të barazuara brenda dhe jashtë rrjetit nuk mundet kurrsesi të bashkë-ekzistojë me tarifa asimetrike terminimi, pasi në të kundërt sjell dëme të parikuperueshme në konkurrence. Kujtojmë se përgjate analizes së tregut në vitin 2014, u diskutua dhe dakordua me palët e përfshira në proces që zbatimi i rregullimit on/off-net do të shoqërohej paralelisht me tarifën simetrike mes të gjithë operatorëve, pasi në të kundërt ndërhyrja e AKEP avantazhon qartazi dhe në mënyre arbitrare operatorin asimetrik Plus dhe çënon rëndë operatorët e tjerë.

Vodafone sugjeron qe: 1) nevojitet një analizë e plotë dhe shteruese përpara se AKEP të konfirmojë vazhdimësinë e zbatimit të barazimit on/off-net në tregun e pakicës dhe 2) AKEP duhet të lejoje operatorët përgjate kësaj periudhe të ndërmjetme që të promovojnë në treg ekzistencën e disa paketave alternative pa kufizime barazie, me qëllim për të plotësuar nevojat konsumatore për komunikim me rrethet e tyre sociale.

## **ALBTELECOM**

Duke iu referuar të dhënave të paraqitura nga AKEP në dokumentin e analizës, të tilla si: ndryshimi në strukturën e trafikut dalës; ndryshimi në raportin e thirrjeve on-net/off-net; kufizimi dhe minimizimi i sasisë së ofertave të operatorëve në treg; ritmi i ulët i rritjes së numrit të pajtimtarëve aktivë në treg; apo dhe ulja e numrit të pajtimtarëve sipas kartave SIM; etj, Albtelecom mund të gjykojë se masa rregulluese e mos-diskriminimit në tarifatat on-net/off-net e vendosur në analizën e tregut 2014, ka patur efekte pozitive në tregun celular dhe gjithashtu është vënë re se kanë filluar të korrigjohen një sërë problematikash të evidentuara në treg që sollën domosdoshmërinë për vendosjen e këtij rregulli. Nga ana tjetër, bazuar po në të dhënat e AKEP në analizë, vendosja e kësaj masë/detyrimi ka rritur përfitimet për abonentin celular qoftë përsa i takon MOU, qoftë lidhur me cmimin apo ARPM, për vitin 2015 e cila është reduktuar krahasimisht me ARPM e vitit 2014, duke bërë kështu të mundur përfitimin e më shumë shërbimeve nga abonentit celular kundrejt pagesave/shpenzimeve më të ulta. Përveç sa më sipër, vendosja dhe zbatimi i këtij detyrimi nga operatorët celularë, i ka siguruar abonentit zgjedhjen e operatorit nga i cili do të marrë shërbimet celulare me vullnetin e tij të lirë.

Në këto kushte, qoftë edhe diskutimi për heqjen e këtij detyrimi për dy operatorët më të mëdhenj të tregut Vodafone dhe Telekom Albania do t'i krijonte këtyre operatorëve dominant rrethanat e përshtatshme për t'iu rikthyer praktikave tarifore abuzive dhe të paprecedenta të diskriminimit të thirrjeve on-net/off-net dhe krijimit të "club-eve", me pasojën direkte të kycjes së abonentëve në rrjetet e tyre, dhe dëmtimin tashmë në mënyrë të parikuperueshme të operatorëve me bazë të vogël abonentësh, konkretisht Albtelecom. Ndërkohë, Albtelecom evidenton që ai apo operatori tjetër Plus edhe në mungesë të këtij rregulli, stimujt për angazhim në praktika të diskriminimit të thirrjeve on-net/off-net janë të pakta dhe pa ndonjë efikasitet. Kjo pasi, çdo abonent i Albtelecom apo Plus nën kushtet e diskriminimit në pamundësi të kryerjes lirisht të thirrjeve off-net (baza e pajtimtarëve TA dhe VA është mbi 80%), atëherë ai abonent mund të largohet tek një nga 2 operatorët e mëdhenj duke siguruar komunikim më të lirë si me abonentët brenda rrjetit ku shkon (VA apo TA), ashtu dhe kundrejt abonentëve të rrjetit prej të cilit largohet (EM apo PL). Ndaj Albtelecom gjykojnë që masa rregulluese e mos-diskriminimit në tarifatat on-net/off-net për operatorët e vegjël Albtelecom dhe Plus nuk është e nevojshme dhe nuk duhet t'iu takojë.

Në përfundim duke iu referuar komenteve me sipër, duke gjykuar raportet e trafikut on-net/off-net të operatorit Albtelecom (EM) që tashmë ka arritur në 30%:70% referuar trafikut Dhjetor 2016 (apo edhe të operatorit Plus) dhe për më tepër në kushtet e ndryshimeve jo të ndjeshme të pjesëve të tregut të operatorëve Vodafone dhe Telekom Albania (në disa tregues këta operatorë kanë rritur pjesën e tyre të tregut), Albtelecom mendon se, masa rregulluese e mos-diskriminimit në tarifatat on-net/off-net e vendosur në analizën e tregut 2014 është e domosdoshme të vijojë të aplikohet për statusin me FNT vetëm për 2 operatorët Telekom Albania dhe Vodafone, të cilët në mungesë të këtij detyrimi do të dëmtonin sërish konkurrencën e lirë, operatorët në tregun celular, dhe abonentët e tij.

## **PLUS COMMUNICATION**

PLUS shpreh dakordësinë e tij lidhur me propozimin e AKEP për vazhdimin e masave rregullatore të vendosura në Analizën e tregut 2014.

Këto masa rregullatore duhet të përfshijnë mosdiskriminimin e tarifave me pakicë të thirrjeve On-net/Off-net në mënyrë strikte dhe të monitoruar nga AKEP. Në përputhje me konkluzionet dhe përfundimet të AKEP në këtë Analizë, PLUS gjykon se vazhdimi i zbatimit të këtyre masave është i domosdoshëm; pavarësisht ndryshimeve të filluara në strukturën e thirrjeve (të evidentuara në këtë dokument), efekti për operatorët e vegjël është ende i pamjaftueshëm, pasi në rast të heqjes së tyre nga tregu operatorët e mëdhenj do të ktheheshin menjëherë në praktikat tarifore të mëparshme. Gjithashtu, vazhdimi i tyre është jetësor për operatorët e vegjël, që me gjithë ndryshimet e vogla në strukturën e thirrjeve, në pjesët e tjera të treguesve nuk kanë ndryshime të mëdha, por ndryshimet sapo kanë nisur dhe kërkohet patjetër një kohë e dytë që ato të marrin formë dhe të ndihet maturimi i tregut tek këta operatorë.

## **QËNDRIMI I AKEP**

Sic mund të vihet re komentet e operatorëve janë të ndryshme. Operatorët e mëdhenj, Vodafone dhe Telekom Albania nuk janë dakort që AKEP të vijojë të vendosë këtë masë detyrim, ndërsa Albtelecom kërkon që ajo të zbatohet vetëm për dy operatorët e mëdhenj. AKEP pas komenteve të ndryshme të operatoreve celulare i qendron propozimit për vijimin e zbatimit të masës së mosdiskriminimit në tarifën e thirrjeve on-net/off-net si një masë e nevojshme për tregun celular.

AKEP gjykon se vazhdimi i zbatimit të kësaj mase është i nevojshëm, pasi pavarësisht ndryshimeve të ndjeshme në strukturën e thirrjeve celulare, të evidentuara në këtë dokument, në mungesë të këtij detyrimi operatorët celulare do të kishin stimulim dhe rikthim në praktikën tarifore të mëparshme. Kjo theksohet akoma me shumë nga fakti se megjithë ndryshimet e vëna re në strukturën e thirrjeve dhe rritjen e ndjeshme të thirrjeve off-net, pjesët e tregut në treguesit kryesorë nuk kanë pesuar ndryshime të ndjeshme.

Ndërkohë, në ndryshim nga analiza në vitin 2014, dhe nga dokumenti në këshillim publik, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe ndryshimeve të ndodhura në treg gjatë kësaj periudhe (2014-2017), të evidentuara në këtë version final të analizës së tregut, AKEP vlerëson se ekzistojnë kushtet që zbatimi i masës rregulluese të mosdiskriminimit në tarifën me pakicë të thirrjeve on-net/off-net të përfshihet në një diskutim më të gjerë, për shkak të lidhjes indirekte të kësaj mase me detyrimet për FNT në tregun me pakicë celular, ku ky detyrim mund të vendoset vetëm për operatorët që kanë dominancë apo FNT edhe në tregun përkatës me pakicë celular. AKEP gjykon që tre operatorët të vijojnë zbatimin e kësaj mase, ndërsa rishikimi i proporcionalitetit të saj për secilin operator do të kryhet në kuadër të analizës së tregut me pakicë celular dhe tregjeve të tjera të justifikuar për ndërhyrje ex-ante që do kryejë AKEP me këshillim publik në muajt në vijim.

### **9. Cila do të ishte alternativa me e mire për adresimin e problematikes së tarifave tepër të larta të komunikimit (thirrje/SMS/Internet) pa aktivizuar paketat/ofertat e shërbimeve celulare?**

## **TELEKOM ALBANIA**

Per sa i përket tarifave të komunikimit (thirrje/SMS/Internet) pas mbarimit apo pa aktivizimin e ofertave, operatorët celulare ofrojnë disa opsione ndihmëse për abonentët e tyre: politikën tarifore FUP për shmangien e faturave të larta, oferta apo paketa me mundësi zgjedhje në varesi të tarifave, njësive të komunikimit të



përfshira, apo vazhdimi i internetit me shpejtësi të reduktuar deri në 128/256 kbps pas konsumit të sasisë së caktuar të internetit. Gjithashtu, abonentët kanë mundësinë për faturen e detajuar për të parë konsumin në kohe reale, apo programet për të krahasuar dhe zgjedhur midis tarifave dhe programeve të ndryshme të vëna në dispozicion për abonentët nga TA në faqjen e saj të internetit.

Pra, vetë operatorët iu kanë bërë të mundur abonentëve të masin në cdo kohë konsumin e shërbimeve, iu kanë dhënë opsione dhe mundësi për të zgjedhur sipas disa. Ndaj një ndërhyrje rregullatore për tarifën e komunikimit pa aktivizuar paketat/ofertat e shërbimeve celulare duke i inkuadruar ato si pjesë e SHU (Shërbimit Universal) me percaktim të cmimeve tavan, e gryojmë si një rregullim tjetër shtese, të tepërt dhe të panevojshëm në tregun me pakicë, i cili do të shkatërojë dhe demtojë konkurrencën e lire në treg midis operatorëve. Këto masa janë në kundërshtim dhe me trendin rregullator të direktivave të BE-se dhe të propozuara për rishikim në 2016, nepermejt të cilave synon drejt një derregullimi gjithnjë e më të madh të tregut të komunikimeve elektronike, në mënyrë që të nxitet konkurrenca e lirë.

Sic është shprehur TA edhe në komentet e dhëna në këshillimin publik për SHU, një inkuadrim i tarifave të komunikimit (thirrje/SMS/Internet) jashtë ofertave/paketave në kuadrin e SHU, ashtu si dhe për paketat dhe ofertat e propozuara si pjesë e SHU në këshillimin e zhvilluar në lidhje me këtë gjë, është jo i drejte, në shkelje të parimit të proporcionalitetit, duke qënë se tregu me pakicë në telefoninë e lëvizshme rezultoi i rregulluar nga ana e AKEP dhe kjo krijon kosto shtesë dhe të pajustificuar për operatorët, duke cuar gjithashtu dhe në një imponim të politikave të tyre tarifore retail dhe në cenim të financave të operatorëve. Gjithashtu në të gjitha vendet e BE dhe të rajonit tregjet retail janë jashtë sferës së rregullimit duke qënë në të njëjtën linjë me tendencën e kuadrit rregullator të de-rregullimit të tregjeve me pakicë të komunikimeve elektronike, ndërkohë që AKEP propozon masa që shkojnë në drejtim të kundërt me këtë linjë dhe me eksperiencat e vendeve të tjera të BE-se. Në asnjë nga vendet e BE-se shërbimet celulare nuk janë të përfshira në kuadrin e Shërbimit Universal duke qënë se nuk i plotësojnë kushtet për t'u inkuadruar si të tilla, bazuar në Direktiven e BE-se mbi SHU 2002/22/EC ndryshuar me Direktiven 2009/136/EC (Citizen rights' Directive). Nga këto vende, në rastin e Rumanisë, autoriteti rregullator ka vendosur detyrime për përfshirje të paketa shërbimesh dhe tarifash në kuadrin e Shërbimit Universal vetëm për kategoritë e përdoruesve fundorë me problem dëgjimi, shikimi apo të foluri, por jo përfshirje të tarifave të komunikimit (thirrje/SMS/Internet) në kuadrin e Shërbimit Universal për të gjitha kategoritë e përdoruesve fundorë sic propozohet nga AKEP në këtë dokument, propozim ky në kundërshtim me praktikën dhe eksperiencat e vendeve të BE-së dhe kuadrit rregullator përkates. TA është i mendimit që vetëm konkurrenca e lirë në treg midis operatorëve mbetet gjithnjë alternativa më e mire për të përmbushur nevojat dhe kërkesat e përdoruesve për përdorimin e shërbimeve celulare në përputhje me mundësitë e tyre financiare, evidentuar këto nga ulja e vazhdueshme e tarifave me pakicë për abonentët.

## **VODAFONE ALBANIA**

VA gjojon se kjo ceshtje është ezauruar tanimë pas shqyrtimit të hollësishëm që AKEP ka kryer përgjate analizes së Shërbimit Universal. Vodafone shprehet dakord me gjetjet e AKEP në atë dokument përsa i takon panevojshmerisë për ndërhyrje në tarifën jashtë paketave si të pajustificuara. VA shprehet se AKEP nuk duhet të ndihet i detyruar që medoemos të ndërhyje për të 'prekur' tarifën nominale (jashtë paketave), pasi kjo rezultoi e panevojshme dhe e pajustificuar, qoftë në aspektin ligjor/rregullator por edhe në atë ekonomik e praktik.

VA gjojon se tregu i pakicës është treg konkurrues dhe operatorët i janë përgjigjur nevojave të tij përgjate dizenjimit të produkteve dhe tarifave. Natyrshëm tregu i parapagesës ofron një larmi më të madhe produktesh, shërbimesh dhe cmime më konkurruese pasi dhe tregu shqiptar është i orientuar drejt konsumatorit parapagues për të gjithë operatorët celulare dhe konkurrenca në këtë pjesë të tregut është me e madhe. Qasja e shërbimeve sot në të gjithë Europën është drejt konsumit të paketave të integruara bundle dhe konsumatorët nuk përzgjedhin më produkte të vecuara (standalone).

Diferenca në cmim mes tarifave nominale dhe paketave të integruara është një qasje e natyrshme marketingu prezente në cdo vend të BE e me gjerë, e cila synon të nxisë pajtimtarët me parapagim që të blejnë dhe konsumojnë shërbime të integruara, ndërkohë që blerja e produkteve standalone ka kosto më të lartë për operatorët (e rrjedhimisht për pajtimtarët), veshtirëson planifikimin e buxheteve për investim dhe pamundëson planifikimin e rrjetit për nevoja utilizimi optimal nga gjithë baza e pajtimtarëve.

Megjithatë VA për të adresuar shqetësimin e AKEP dhe të AK angazhohet që këtë diferencë ta reduktojë gradualisht në muajt në vijim, duke filluar nga 1 Prill 2018.

## **ALBTELECOM**

Sa i takon adresimit të kësaj problematike, Altelecom mendon se propozimi i AKEP për rregullim të tarifave për njësi komunikimi (thirrje/sms kombëtare/internet) që janë jashtë paketave, duke përcaktuar cmime tavan maksimale si pjesë e shërbimit universal është i gabuar, pasi në vetvete implementimi i një skeme të shërbimit universal në kushtet e tregut celular në Shqipëri është absolutisht i panevojshëm (qëndrim i cili është shprehur në komentet për keshillim të dokumentit të SHU). Për të argumentuar këtë koment Altelecom ka renditur disa arsye: karakteristikat dhe treguesit e tregut nuk tregojnë për nevojën e imponimit të rregullimeve në nivel pakice me qëllimin që të jenë të përballueshme për të gjithë përdoruesit fundor, duke qënë se niveli i cmimeve të ofertave dhe paketave dhe përmbajtja e tyre është konkurrues dhe arrin arrin të përmbushë nga nevojat e pajtimtarëve me aftësi të vogël pagueuse. Niveli i mbulimit me sinjal në telefoninë e lëvizshme dhe mbulimi me rrjet në telefoninë fikse tregon se pothuajse e gjithë popullsia është e shërbyer nga shërbimet e komunikimeve elektronike. Për rrjedhojë, duke konsideruar dhe përdorimin e paket apo aspak të tarifave për njësi jashtë ofertave/paketave të operatorëve celularë në komunikimin e abonentëve, këto tarifa nuk përbëjnë rëndesë apo tarifim të tepërt të abonentit dhe për më tepër të abonentit me të ardhura të ulta, i cili mund të tarifohet për njësi vetëm pas përfundimit të ofertës së aktivizuar. Altelecom mendon se ndryshimi dhe ulja e këtyre tarifave duhet të jetë një proces dhe iniciativë e vet operatorëve të tregut, të cilët me gjasa në vijim të këtij procesi analize tregu do të ndërmarrin veprimet e duhura.

## QËNDRIMI I AKEP

Ne lidhje me problematiken e diferencave te medha ne tarifat per njesi komunikimi dhe paketave/ofertave, diferencave te pajustificuara ne tarifat me parapagim dhe paspagim dhe probleme te tjera te evidentuara ne dokumentin e analizës së nxjerrë në këshillim publik në Dhjetor 2016, AKEP vlereson si me te arsyeshme te kryeje nje process te vecante keshillimi public per te adresuar keto probleme.

Për të reflektuar zhvillimet ne treg gjate vitit 2017, si konsolidimi i tregut celular nga 4 në 3 operatorë, impakti i masave rregulluese dhe proporcinaliteti i tyre etj, AKEP me miratimimin e këtij dokumenti do të nisë dhe një proces të ri këshillimi publik:

- *“Analizë e tregut celular: tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit, tregjet me shumice te terminimit te thirrjeve nderkombetare dhe tregu me pakice i sherbimeve celulare-Keshillim Publik”.*

Ky dokument do të përfshijë ri-vlerësimin e AKEP për tregun me pakicë celulare dhe gjithë tregjet e tjera justifikueshme për ndërhyrje ex-ante pas ndryshimeve të strukturës së tregut celular dhe rekomandimeve të AK, përfshirë një diskutim më të gjerë për rishikimin ose jo të masës rregulluese të mos-diskriminimit në tarifat me pakicë on-net/of-net dhe terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare. Procesi i këshillimit publik do jetë 2 muaj sipas nenit 34 të ligjit 9918.